



**Tema: “Mbrojtja sociale në Republikën e Maqedonis së Veriut –
Politikat, të drejtat dhe shërbimet”**

Fakulteti: Administratë publike dhe Shkenca politike

Drejtimi: Shkenca politike

Kandidatja:

Gjilsime Rexhepi

Mentori:

Prof. Dr. Agron Rustemi

Tetovë, 2021

Përmbajtja

1	Kapitulli parë	6
1.1	Mbrojtja sociale në RM së Veriut	6
1.1.1	Ç'ka paretet mbrojtja sociale.....	6
1.1.2	Sistemi i mbrojtjes sociale mbulon këto rreziqe:	8
1.1.3	Fazat e reformave nga viti 2009.....	9
2	Kapitulli dytë.....	13
2.1	Kategoritë e programeve, projekteve të mbrojtjes sociale.....	13
2.1.1	Projektet në nxitjen e përfshirjes sociale të financuara nga IPA – Instrumenti për Ndhimë Paraaderuese.....	16
2.1.2	Projektet për fuqizimin e aktorëve përkatës në përfshirjen sociale.....	18
2.1.3	Projekti “Kuzhinat Kombëtare”.....	20
2.1.4	Politikat sociale në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe reformat në fushën sociale.....	21
2.1.5	Reformat në mbrojtjen sociale në vitin 2019.....	23
2.1.6	Politikat sociale aktuale dhe synuese për zbutjen dhe tejkalimin e nevojave sociale në vend.....	26
3	Kapitulli tretë	34
3.1	Të drejtat për ndihmë financiare nga mbrojtja sociale.....	34
3.1.1	a) Ndhimë minimale e garantuar.....	34
3.1.2	b) Kompensime për shak të pengesave.....	37

3.1.3	c) Ndhimë financiare për ndihmë dhe kujdes nga një person tjetër.....	38
3.1.4	ç) Kompensime në pagë për orar të shkurtuar të punës.....	39
3.1.5	d) Shtesa për banim.....	39
3.1.6	e) Kompensime të përhershme.....	39
3.1.7	f) Ndhimë e njëhershme financiare dhe ndihmë në naturë.....	40
3.2	E drejta e mbrojtjes shëndetësore.....	41
4	Kapitulli katërt.....	42
4.1	Fushat e shërbimeve sociale.....	42
4.1.1	Shërbimet sociale dhe papunësia (varfëria).....	46
4.1.2	Shërbimet sociale në familje.....	51
4.1.3	Shërbimet për të rinjtë dhe fëmijët	52
4.1.4	Shërbimet sociale për të moshuarit.....	55
4.1.5	Personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimet që iu ofrohen.....	56
5	Kapitulli pestë.....	63
5.1	Analizë e legjislacionit për shërbimet sociale.....	63
5.1.1	Dispozitat ligjore për shërbimet sociale: një kritik për përkufizimet e shërbimeve të mbrojtjes jo-institucionale.....	64
5.1.2	Dispozitat ligjore për shërbimet sociale: një kritik për përkufizimet e shërbimeve të mbrojtjes institucionale.....	67

5.1.3	Ofruesit e shërbimeve sociale në nivel shtetëror.....	70
6	Kapitulli gjashtë.....	78
6.1	Konkludime dhe Rekomandime.....	78
6.1.1	E ardhmja e procesit të decetralizimit të mbrojtjes sociale.....	78
6.1.2	Deinstitucionalizimi i shërbimeve sociale.....	85
6.1.3	Veçoritë elementare të procesit të deinstitucionalizimit.....	88
6.1.4	Synimet kryesore të deinstitucionalizimit.....	89
6.1.5	Shërbimet sociale në bashkësi: efektet dhe mungesat.....	91
6.1.6	Krijimi i mundësisë për shërbime të duhura dhe të rregullta dhe përfshirja sociale.....	98
6.1.7	Sigurimi i vendeve të banimit.....	99
6.1.8	Pjesëmarrje e përdoruesve dhe shërbimeve të udhëhequra nga përdoruesit.....	101
	Bibliografia.....	103

Lista e figurave

Figura 1	Paraqitja institucionale e shërbimeve sociale.....	44
Figura 2	Përdoruesit e shërbimeve sociale.....	60
Figura 3	61

Figura 4.....	62
Figura 5.....	71

Lista e tabelave

Tabela 1 Llojet e shërbimeve sociale në RM së Veriut, nëpër qytete dhe në ofruesit e shërbimeve.....	73
Tabela 2 Vlerësimi i numrit të personave me nevojë për mbështetje dhe shërbime.....	90
Tabela 3 Rreziqet dhe mundësitë për uljen e rrezikut ose dëmit.....	96

Hyrje

Nga një shoqëri më organizuese, productive, dhe të drejtë të gjithë përfitojmë, duke pasur mundësinë që shteti të investoj në mbrojtjen sociale të qytetarëve. Qëllimi i hulumtimit është për të parë se çfarë në të vërtet ofron shteti ynë për kategoritë e shumë njerëzve që janë në nevojë. Ku brenda punimit janë përshkruar disa nga reformat që janë bërë nga viti 2009 e deri më sot në fushën e mbrojtjes sociale, kështu duke bërë një përshkrim të projekt - programeve me rëndësi të veçantë në këtë sistem. Gjithashtu janë përshkruar edhe të drejtat dhe shërbimet që ofrohen nga

reforma e Ligjit për mbrojtje sociale e po këtij viti e të cilët realizohen nëpër Qendrat për punë sociale.

Nga fakti se tani po ndodhemi edhe në një krizë ekonomike dhe sociale, megjithatë vendi ynë për personat në nevojë, ka paraparë një tërësi të politikave sociale duke ofruar ndihma të ndryshme materiale dhe duke iu siguruar shërbime adekuate sociale qytetarëve në nevojë.

Pastaj në punim kam hulumtuar edhe për vetë institucionet të cilët ofrojnë shërbimet sociale, sa janë në numër, në cilin vend ndodhen dhe çfarë shërbimesh kanë mundësinë të ofrojnë dhe a janë adekuate për ato kategori për të cilët i ofrojnë dhe shumë e shumë vlerësime, kritika dhe rekomandime.

Gjithashtu është përshkruar edhe një pjesë e mirë e Ligjit për mbrojtje sociale të R.M së Veriut, duke dhënë vlerësimin tim por edhe duke marrë si shembull edhe vlerësimet dhe rekomandimet nga udhëheqës të ndryshëm të institucioneve sociale të vendit.

Gjithnjë e më shumë sa vjen e shtohen të mirat dhe dobitë në drejtim të këtij sistemi, e ardhur më e përsosur, e përmbushur me shumë politika, shërbime dhe të drejta që synojnë mbrojtjen, plotësimin dhe përmbushjen e nevojave të qytetarëve dhe në kë mënyrë duke mundësuar jetë sa më të lehtë dhe më të lirë për vetë shoqërinë e këtij vendi.

1 Kapitulli parë

1.1 Mbrojtja sociale në RM së Veriut

1.1.1 Ç'ka përqet mbrojtja sociale

Mbrojtja sociale përcaktohet si një veprimtari me interes publik.

Ajo definohet si një sistem masash, veprimtarish dhe politikash për parandalimin dhe tejkalimin e rreziqeve themelore sociale ndaj të cilave qytetari është i ekspozuar gjatë jetës, për të zvogëluar varfërinë dhe përjashtimin social dhe për të forcuar kapacitetin e saj për vetëmbrojtje.

Sistemi realizohet përmes punës profesionale në institucionet e mbrojtjes sociale, zbatimit të programeve zhvillimore, zhvillimit profesional të punëtorëve në varësi të nevojave të shfrytëzuesve dhe standardeve ndërkombëtare, monitorimin e dukurive dhe planifikimin e punës, mbajtjen e evidencës, si dhe përmes mbikëqyrjes dhe hulumtimit të punës kërkimore në këtë fushë.

Përveç masave për mbrojtjen sociale të qytetarëve, kujdesi i shtetit për parandalimin e rrezikut shoqëror realizohet përmes marrjes së masave në politikën tatimore, punësimin, politikën për dhënie të bursave, strehimin, mbrojtjen e familjes, shëndetin, edukimin dhe arsimin në përputhje me ligjin.

Institucioni qëndror që kryen politikëbërje, planifikim strategjik, menaxhim, si dhe mbikëqyrje të ligshmërisë, veçanërisht përmes inspektimit të zbatimit dhe zbatimit të ligjeve dhe rregulloreve të tjera në fushën e mbrojtjes sociale është Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

Me studimin e dukurive dhe problemeve shoqërore dhe promovimin e veprimtarive shoqërore meret Instituti për Aktivitete Sociale. Ku ky Institut ka në kompetencë: mbikëqyrjen e punës profesionale, mbi institucionet e mbrojtjes sociale si dhe mbi personat e tjerë juridikë dhe fizikë, që meren me veprimtari të caktuara në mbrojtjen sociale.¹

Për realizimin e sistemit të mbrojtjes sociale, themelohen institucionet e mbrojtjes sociale (qendrat për punë sociale dhe institucionet sociale për mbrojtje jo-institucionale dhe institucionale).²

Mbrojtja sociale, siç përcaktohet nga Instituti i Kërkimeve të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Social, merret me parandalimin, menaxhimin dhe tejkalimin e situatave që ndikojnë

¹ “Национална програма за развој на социјална заштита 2011-2021”, службеник весник на РМ, бр.121/201

² По ату, фае 3-4

negativisht në mirëqenien e njeriut. Për sa i përket mbrojtjes sociale themi se ajo kontribon në politika dhe programe të dizajnuara për të promovuar tregje efikase të punës, duke ulur varfërinë dhe duke forcuar kapacitetin e tyre për të menaxhuar rreziqet ekonomike dhe sociale, të tilla si papunësia, sëmundja, përjashtimi, aftësia e kufizuar dhe pleqëria.³

Llojet më të zakonshme të mbrojtjes sociale:

- Ndërhyrjet në tregun e punës - janë politika dhe programe të hartuara për të promovuar punësimin, efikasitetin e tregut të punës dhe mbrojtjen e punëtorëve.⁴
- Sigurimet shoqërore - zbutin rreziqet që lidhen me papunësinë, me sëmundjen, paaftësinë, dëmtimet e lidhura me punën dhe pleqërinë, siç janë sigurimi shëndetësor ose sigurimi i papunësisë.
- Ndihma sociale - është kur burimet, në të holla ose në natyrë, u transferohen individëve ose familjeve të cënueshme pa mjete të tjera të mbështetjes adekuate, duke përfshirë prindërit e vetëm, të pastrehët ose të paaftët fizikisht ose mendërisht.⁵

Shteti ushtron funksionin e tij shoqëror përmes rrjetit të institucioneve publike për mbrojtje sociale. Sistemi i mbrojtjes sociale përbëhet nga Qendra për punë sociale (30), të cilët kanë autoritet publik për të kryer punën në fushën e mbrojtjes sociale. Qendrat për punë sociale kanë autorizime publike, administrojnë dhe ofrojnë përfitime në të holla nga mbrojtja sociale dhe shërbime sociale.

Përmes vendosjes së një sistemi për shkëmbim zyrtar të informacionit me institucionet që mbajnë të dhënat e duhura për procedurat e realizimit, administrimi i të drejtave në të holla është lehtësuar plotësisht. Me hapjen e departamenteve të reja shpërndarëse në qendrat për punë

³ https://mk.wikipedia.org/wiki/Социјална_заштита#Историја

⁴ По ату

⁵ По ату

sociale, sigurimi i mbrojtjes sociale është edhe më i madh për të gjithë qytetarët, veçanërisht për ata që jetojnë në zonat rurale, të moshuarit dhe invalidët.⁶

Shumica e shpenzimeve të mbrojtjes sociale financohen nga kontributet e detyrueshme. Tatimet lejojnë të paguhen shpenzimet e rregjistruara në buxhetet e shtetit ose të qeverisjes vendore. Kuotat sociale të punëmarrësve dhe të punëdhënësve lejojnë të financohen shpenzimet e sigurimeve sociale. Organizatat private janë financuar prej ndihmave të veçanta dhe prej subvencioneve eventualisht të marra nga Shteti, nga qeverisja vendore ose edhe nga organizmat mbinacionale, për shembull (Bashkimi Evropian shpërndan subvencione në disa shoqata që merren me ndihmën ushqimore ose strehimin e të përjashtuarve).⁷

1.1.2 Sistemi i mbrojtjes sociale mbulon këto rreziqe:

- ***rreziqet që kanë të bëjnë me shëndetin*** – ku përfshihen sëmundjet, aksidentet në punë, invaliditetin dhe sëmundjet profesionale;
- ***rreziqet në familje*** - që integron pagesat familjare (alokimet familjare, ndihmat për fëmijët), shpërblimet ditore dhe pagesat ndaj nënave;
- ***rreziqet nga pleqëria dhe mbijetes*** - që përfshijnë kryesisht pensionet;⁸
- ***strehimi***, që përfshin kryesisht alokimet për banesën;
- ***punësimi***, që përmbledh disa dispozita që lidhen me kualifikim dhe rikualifikimin profesional si dhe pagesat e papunësisë;

⁶ “Како до подобар систем на социјалната заштита во Република Македонија”, Скопје, 2017, faqe 3

⁷ <https://shtetiweb.org/2013/10/07/mbrojtja-sociale/>

⁸ <https://shtetiweb.org/2013/10/07/mbrojtja-sociale/>

– **varfëria dhe përjashtimi social**, që grupon pagesa të ndryshme në favor të personave të mbetur pa të ardhura.⁹

Rreziku social është një gjendje që ka potencial të rëndojë ose të pengojë funksionimin shoqëror të individit, familjes ose një grupi të caktuar, i cili mund të jetë në një situatë që ka nevojë për ndihmë sociale. Ku në figurën 1,2 dhe 3 jepet një përshkrim i shfrytëzuesve të shërbimeve sociale, nga të cilat mund të definohen edhe riziqet sociale, si: mjete jo të mjaftueshme për jetë (varfëria), pleqëria, fëmijëria, dhuna, pengesa fizike dhe mentale, pamundësia për riintegrim social.¹⁰

Ku nga të gjithë këto sigurime, qofshin sigurimet shëndetësore, sigurimet e pleqërisë, pagesat e ndryshme familjare, sigurimet në raste të aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale, vijmë në përfundim se mbrojtja sociale këto sigurime I realizon dhe I plotëson nëpërmjet organizmave të ndryshëm dhe institucioneve të tjera plotësuese, siç janë: institucionet e ndihmës, regjimet në raste të papunësisë, regjimet në pensione, regjimet e sigurimit shëndetësorë etj. Por ky organizim është i ndryshëm nga vendi në vend.

Sistemi i mbrojtjes sociale luan një rol shumë të rëndësishëm në shpërndarjen dhe rishpërndarjen e të ardhurës nacionale në favor të shtresave me nivel më të ulët të ardhurash, duke ndihmuar kështu për një drejtësi më të madhe shoqërore dhe në zbutjen e kontradiktave ndërmjet shtresave të ndryshme.¹¹

1.1.3 Fazat e reformave nga viti 2009

Në qershor të vitit 2009, me miratimin e ligjit të ri të mbrojtjes sociale u ripërcaktua sistemi dhe oragnizimi i mbrojtjes sociale, u ripërcaktuan të drejtat sociale, financimi i tyre dhe procedurat për realizimin e atyre të drejtave.

⁹ Po aty.

¹⁰ “ Социјалните услуги во општините во Северна Македонија, Капацитет, Ризици, Потреби”, Скопје, Јуни, 2020

¹¹ <https://shtetiweb.org/2013/10/07/mbrojtja-sociale/>

Shuma e të drejtave të ndihmës financiare u përcaktua në shumën nominale dhe u harmonizua me rritjen e kostos/harxhimeve të jetesës për vitin paraprak, botuar nga Zyra shtetërore e statistikave, në janar të vitit aktual,¹² i cili prezantoi një sistem të ri korrigjimesh të shumave të të drejtave të ndihmës financiare nga mbrojtja sociale.

Në fushën e shërbimeve sociale, kjo rregullore parashikonte:

- zhvillimin e mëtejshëm të shërbimeve shoqërore jo-institucionale, duke prezantuar një të drejtë të re për jetë të pavarur me mbështetjen dhe krijimin e shtëpive të grupeve të vogla,
- Përmirësimin e punës profesionale duke kyçur një detyrim për të përgatitur një plan individual për të punuar me shfrytëzuesin, përveç shfrytëzuesve të të drejtave të ndihmës financiare nga mbrojtja sociale
- Prezantimin e licencimit dhe trajnimit e vazhdueshëm të profesionistëve
- Zgjerimin e pluralizmit duke u mundësuar organizatave fetare dhe grupeve fetare të angazhohen në ofrimin e shërbimeve të caktuara sociale
- Vazhdimin e procesit të decentralizimit duke u dhënë komunave mundësinë për të prezantuar të drejta të tjera nga mbrojtja sociale, si dhe lidhjen e programeve lokale me programin kombëtar për zhvillimin e mbrojtjes sociale
- Mundësia e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë të miratojë programe për masa për subvencionimin e konsumit të energjisë dhe shërbimeve të tjera komunale, kompensimet monetare të kushtëzuara dhe masa të tjera.

Ministria e Punës dhe Politikës sociale realizoi disa aktivitete që kishin një rëndësi të madhe për përmirësimin e përgjithshëm të sistemit të mbrojtjes sociale, më të rëndësishmet ishin projekti për transferimin e parave të kushtëzuara dhe projekti SPIL, si dhe aktivitetet në lidhje me kyçjen e licencimit në mbrojtjen sociale.¹³

¹² “Национална програма за развој на социјална заштита 2011-2021”, службеник весник на РМ, бр.121/2010
faqe 6-9

¹³ По ату.

Qëllimi i projektit për transferime të kushtëzuara të parave, përfundimi i të cilës ishte planifikuar për vitin 2014, ishte të përmirësonte efektivitetin dhe efikasitetin e rrjetit të mbrojtjes sociale në Maqedoni përmes monitorimit dhe vlerësimit të transferimeve sociale të parave.

a) Projekti për transferimin e parave të kushtëzuara, kishte këto komponenta:

përmirësimin e kapitalit njerëzor përmes ndihmës financiare - Ky komponent do ta financonte kompensimin financiar të familjeve, shfrytëzues të ndihmës financiare sociale, fëmijët e të cilëve do të vijojnë shkollën e mesme. Këto familje kishin të drejtë për ndihma shkollore nëse fëmijët e tyre ishin të regjistruar dhe ndiqnin të paktën 85 përqind të shkollës së mesme.

forcimi i administrimit të rrjetit të mbrojtjes sociale - qëllimi i këtij komponenti ishte forcimi i rrjetit të mbrojtjes sociale përmes: përmirësimit të sistemit të informacionit për administrimin e përfitimeve të parave të gatshme, vlerësimi i përfitimit dhe përshtatshmëria brenda rrjetit të mbrojtjes sociale si dhe promovimi i tyre, përmirësimi i sistemit të evidentimit të kompensimeve të ndryshme monetare me qëllim përmirësimin e administratës dhe rritjen e efikasitetit tregtar, zhvillimi i sistemit dhe i mekanizmave për mbikëqyrjen dhe kontrollin e zbatimit të shtesës shkollore dhe përfitimeve të tjera sociale,

analiza funksionale e QPS-së me qëllim të përmirësimit të administratës në QPS për sa i përket efikasitetit dhe efektivitetit të saj, forcimi i kapaciteteve të MPPS për menaxhimin e programeve, forcimi i kapaciteteve në nivelin lokal, përfshirë edhe QPS.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë miratoi një program për përfitime të kushtëzuara të parave për arsimin e mesëm për vitin akademik 2010-2011.

b) Projekti për zbatimin e mbrojtjes sociale - SPIL, i cili e kishte të finalizohet në vitin 2011, e që synonte të përmirësonte efektivitetin dhe efikasitetin e sistemit të pensioneve dhe sistemit të mbrojtjes sociale. Ky program përbëhej nga këto komponenta:

administrimi i sistemit të pensioneve - ky komponent mbështeste aktivitetet për të përmirësuar stabilitetin afatgjatë të sistemit të pensioneve.

mbështetja e programit të mbrojtjes sociale - krijimi i një sistemi të integruar informacioni dhe zhvillimi i lidhjeve të komunikimit midis MPPS, QPS dhe institucioneve të tjera brenda sistemit të mbrojtjes sociale, përmirësimi i administrimit të përfitimeve sociale dhe synimi i tyre më i mirë.

Si përfundim u përcaktuan shërbimet që do të ofrohen në programet e mbrojtjes sociale, si: ndihmat sociale, ndihmat në raste të papunësisë dhe mbrojtja e fëmijëve duke e përgaditur edhe mënyrën e realizimit të këtyre të drejtave dhe përfitimeve dhe duke e paraparë organizimin e programeve të mbrojtjes sociale, poashtu edhe lidhjen ndërmjet bartësve kryesorë në realizimin e përfitimeve.¹⁴

c) Licencimi - në vitin 2009 ligji për mbrojtjen sociale prezantoi një sistem licencimi, por zbatimi i tij ishte vetëm se në fillimet e tij. Procedura për dhënien dhe marrjen e licencave për punën e stafit profesional do të zhvilloheshte nga një Komision licencimi në Institutin e Aktiviteteve Sociale, bazuar në një akt të përgjithshëm të përgatitur nga Ministri.

Instituti për Aktivitete Sociale kishte përgatitur një program licencimi, një kod etik për punëtorët profesionistë, formatin e licencës dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit. Ku sod kjo formë e licencimit është e regullt dhe në cdo 5 vite punëtorët profesionistë duhet ta ripërtrijnë atë, si kusht për të vazhduar ushtrimin e punës profesionale.

d) Varfëria energjetike - me qëllim të zhvillimit të masave për uljen e varfërisë energjetike për kategoritë më të rrezikuara të qytetarëve, Qeveria e Republikës së Maqedonisë në korrik të vitit

¹⁴ Po aty.

2010, miratoi një Program për subvencionimin e konsumit të energjisë, i cili parashikon kompensim në të holla për të mbuluar një pjesë të kostove për energjinë e konsumuar për shfrytëzuesit e ndihmës financiare sociale dhe ndihmës financiare të përhershme.¹⁵

2 Kapitulli dytë

2.1 Kategoritë e programeve, projekteve të mbrojtjes sociale

Si program, që është më i njohuri në fushën sociale në RM së Veriut, është **Programi Nacional për Zhvillim të mbrojtjes sociale 2011-2021**, ku Qeveria e Republikës së Maqedonisë miratoi këtë program, i cili përcakton qëllimet, përparësitë dhe drejtimet e zhvillimit të mbrojtjes sociale të qytetarëve, me masa të politikës aktive shoqërore, në planin afatmesëm dhe afatgjatë.¹⁶

Që nga pavarësia e vet, shteti i Republikës së Maqedonisë që nga viti 1991 është marrur me shumë aktivitete për të krijuar një sistem të ri modern, të qëndrueshëm dhe me funksion të mirë në mbrojtjen sociale me qëllim që ky sistem i mbrojtjes sociale t'iu përgjigjet nevojave të përfituesve.

Sistemi i mbrojtjes sociale i trashëguar nga ish Jugosllavia është përshtatur me kontekstin e ri shoqëror dhe problemet sociale të krijuara dhe të imponuara nga periudha e tranzicionit.

Gjegjësisht, në atë periudhë, papunësia u rrit, standardet e jetesës u ulën, prodhimi i brendshëm bruto u ul dhe cenueshmëria sociale e një numri të madh të qytetarëve të cilët u prekën drejtpërdrejt nga transformimi i sistemit socio-ekonomik në procesin e privatizimit të kapitalit shoqëror dhe zhvillimet e tjera shoqërore u rritën.

¹⁵ “Национална програма за развој на социјална заштита 2011-2021”, службеник весник на РМ, бр.121/2010
faqe 6-9

¹⁶ “Национална програма за развој на социјална заштита 2011-2021”, службеник весник на РМ, бр.121/2010
faqe 1

Situatë kjo, e cila ka imponuar zbatimin e disa proceseve të reformave në fushën e mbrojtjes sociale, si dhe pranimin dhe realizimin e metodave dhe parimeve e rregullave të reja të punës.

Drejtimi themelor në zhvillimin e sistemit të mbrojtjes sociale në Republikën e Maqedonisë jepet nga dokumentet themelore ndërkombëtare, siç janë: Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit Racor, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj Grave, Konventa kundër torturës dhe trajtimeve ose ndëshkimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese, Konventa për të Drejtat e fëmijëve dhe Konventa për të Drejtat e Personave me aftësi të kufizuara.¹⁷

Si anëtare e Këshillit të Evropës, Republika e Maqedonisë zhvillon sërë përpjekjesh për të siguruar nivelin e duhur të mbrojtjes sociale, e posaçërisht për kategoritë më të prekshme të qytetarëve. Ku, zhvillimi i mbrojtjes sociale dhe realizimi i proceseve reformuese, kushtezohen nga standardet dhe detyrimet që i përmban Karta Sociale Evropiane dhe protokolet e saja. Pra, shteti i Republikës së Maqedonisë, duke i pasur parasysh dokumentet e lartpërmendura, është munduar për të vënë në fokus krijimin e normave të qëndrueshme me anë të realizimit kushtetues, me qëllim sigurimin e mbrojtjes së të drejtave sociale.

Meqenëse kjo është një fushë komplekse, në të cilën ndërthuren disa aspekte të politikës dhe nivele të ndryshme dhe aktorë të ofrimit të shërbimeve, legjislacioni i mbulon rregulloret e mëposhtme: Ligji për Mbrojtjen Sociale, Ligji për Familjen, Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve, Ligji për Drejtësinë për të miturit, Ligji për Mundësi të Barabarta për Burrat dhe Gratë, Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji për Institucionet, Ligji për Shoqatat dhe Fondacionet e qytetarëve, Ligji për Partneritet Publik-Privat dhe Koncesione, Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Ligji për Nëpunësit Publikë.

Për zhvillimin e mbrojtjes sociale, janë miratuar disa dokumente strategjike, të njejtat që kanë pasur ndikimin e tyre në përgaditjen e këtij programi, e siç janë: Plani nacional i veprimit

¹⁷ Po aty.

për barazinë gjinore, Strategjia nacionale për punësim 2010, Strategjia nacionale e mbrojtjes nga dhuna në familje 2008-2011, Strategjia për integrimin e refugjatëve dhe të huajve në Republikën e Maqedonisë 2008-2015, Strategjia nacionale për deinstitutionalizim 2008-2018, Programi për përfshirjen sociale, Planveprimi për parandalim dhe menaxhimi të abuzimit seksual të fëmijëve dhe pedofilisë, Strategjia Kombëtare e strehimit, Strategjia Kombëtare për uljen e varfërisë dhe përjashtimit social në Republikën e Maqedonisë dhe Strategjia Kombëtare për të Moshuarit.

Të gjitha këto dokumente imponojnë nevojën që sistemi i mbrojtjes sociale të forcohet dhe përmirësohet vazhdimisht, si dhe nevojën për planifikim strategjik të aktiviteteve të ardhshme në këtë fushë.¹⁸

Komuna, qyteti i Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit në përputhje me këtë program sjellin edhe programe të tjera për nevojat e qytetarëve nga fusha e mbrojtjes sociale.

Në përputhje me Ligjin për Mbrojtje Sociale, komunat bazuar në mundësitë e tyre materiale, me vendim unanim, kanë mundësinë të përcaktojnë dhe të realizojnë të drejta dhe shërbime e kushte më të favorshme, por edhe forma të tjera të mbrojtjes sociale dhe plotësime të nevojave të qytetarëve më të mëdha në numër sesa të drejtat dhe ndërhyrjet e që garantohen me Ligjin për Mbrojtje sociale. Shoqatat e qytetarëve të cilat janë pjesë e regjistrit e udhëhequr nga MPPS dhe personi fizik i cili ka leje pune nga Ministri i Punës dhe Politikës Sociale, gjithashtu mund të kryejnë veprimtari në fushën e mbrojtjes sociale, në kushte, mënyrë dhe procedurë të përcaktuar nga ligji për mbrojtje sociale.

Komunitetet fetare, grupet fetare dhe shoqatat që janë të regjistruara në Republikën e Maqedonisë gjithashtu mund të ndihmojnë qytetarët në nevojë kështu duke e plotësuar sistemin e mbrojtjes sociale të vet shtetit. Për të realizuar sistemin e mbrojtjes sociale, përveç institucioneve publike, themelohen institucione private për mbrojtje sociale.¹⁹

¹⁸ Po aty, faqe 2-3

¹⁹ <https://dejure.mk/zakon/nacionalna-programa-za-razvoj-na-socijalnata-zashtita-2011-2021>, faqe 4.

2.1.1 Projektet në nxitjen e përfshirjes sociale të financuara nga IPA – Instrumenti për ndihmë Paraaderuese

Në lidhje me projektet dhe iniciativat tjera në fushën sociale, me ndihmën dhe financimin e Bashkimit Evropian në kuadër të Instrumentit për Ndihmë Paraaderuese (IPA), janë publikuar një sërë projektesh për nxitjen e përfshirjes sociale. Përkrahje kjo, e cila synon të ndihmojë vendin që ti përfundojë reformat e planifikuara të nevojshme për të fituar edhe anëtarësimin në BE. Projekte të cilat kanë qëllimet dhe rezultatet e tyre të pritura, të cilat do të kontribuojnë në përmirësimin e përfshirjes sociale në vend. Projekte këto të cilat ofrojnë kushte të mira, productive, për secilin komunitet dhe shtresë të marginalizuar të shoqërisë.

Siç është përfshirja sociale e personave në nevojë në tregun e punës, ku të tilla projekte të publikuara janë: *“Vepra për konkurrencë më të mirë në tregun e punës”* – ku si **qëllim i përgjithshëm** është kontributi për rritjen e pjesëmarrjes së njerëzve të ekspozuar ndaj rrezikut social dhe personave të përjashtuar social nga tregu i punës për uljen e shkallës së papunësisë në vend. Ku si **aktivitete** janë marrë: bashkëpunimi midis Kryqit të Kuq, institucioneve qeveritare, vetëqeverisjeve lokale dhe sektorit civil e zejtarë me anë të takimeve fillestare me palët e interesuara lokale, tryezat e rumbullakëta publike, vizitat në artizanate, përzgjedhjet dhe trajnimet, diskutimet e punëtorit me anëtarët e Dhomës së zejtarëve, etj. Dhe **rezultati** i këtij projekti është se me ndihmën e punëtorëve social të Kryqit të Kuq, të interesuarit mund të kyçen në planin individual të karrierës me aktivitete, këshilla dhe informacione për të cilat do të ketë nevojë përfituesi/ i interesuari për punësim.²⁰

²⁰ Shih, “Projekte për Inkurajimin e Përfshirjes sociale”, Shkup, 2017, faqe 6 – 120.

“Iniciativa për punësim rural” – qëllimi është rritja e numrit të personave të pafavorizuar në qasje në tregun e punës dhe në vetëpunësim që në këtë mënyrë të lehtësohet integrimi i tyre social. **Aktivitetet** e ndërmarra si: thirrje për aplikime nëpërmjet portaleve rajonale dhe sociale në internet, trajnime për shofer me mjetet e transportit etj. **Rezultati** ka të bëjë me përmirësimin e strategjive komunale në zhvillimin ekonomik dhe me praktikën positive për eliminimin e paragjyqimeve ndaj njerëzve të pa favorizuar. “Krijimi i rrugëve për punësimin e të rinjëve rural”

“Arsimi dhe trajnimi profesional – qasje e re për përfshirje efektive sociale” – qëllimi i këtij projekti është krijimi i një mjedisi më të favorshëm për ri integrimin e shkelësve të ligjit në shoqëri dhe qëllimi tjetër është që të burgosurit të mësojnë aftësi tjera të reja nëpërmjet aktiviteteve të mbikëqyrura dhe në këtë mënyrë pas vuajtjes së dënimeve të mund të jenë konkures në tregun e punës. **Aktivitetet**: ofrimi i kushteve për realizimin e trajnimeve edukuese në disa burgje (Tetovës dhe Shtipit), ofrimi i paisjeve, programeve dhe mjeteve me anë të furnizimit të kompjuterëve, IKT paisje, karrige, tablete, etj. Si dhe programe të vecanta arsimore për nevojat e të burgosurve (shkrim – lexim bazik, gjuhë të huaja, aftësitë kompjuterike, etj). **Rezultatet**: programe edukative të përshtatura posaçërisht për nevojat e njerëzve që vuajnë dënimin me burg, si programi për njohuri themelore të shkrim – leximit, programi për gjuhën angleze dhe programi për aftësitë themelore kompjuterike. Ku disa persona do të furnizohen edhe me diploma për hortikulturë, disa me çartifikata për aftësitë kompjuterike, për njohuritë e gjuhës angleze, për njohuri për furrtari, për njohuri për floktari etj.

“Ngritje e përfshirjes sociale nëpërmjet zhvillimit të punësimit – “Dera e hapur-për rininë nga rinia”²¹- qëllimi: është që sa më shumë inkuadrim në tregun e punës i të rinjëve në nevojë, punësimi I tyre, mbështetja e tyre, inkurajimi, duke iu mundësuar integrim social të rinjëve dhe pjesëmarrje në tregun e punës. Ku si **target grupe apo përfitues** janë të rinjtë pa prindër dhe pa kujdes prindëror dhe të rinjtë me vështirësi arsimore dhe sociale, të papunësuarit të rinjë e që janë edhe përfitues të asistencës sociale të moshës 18-29 vjec.

“Kuzhina në rrota”-qëllimi: punësimi i personave me aftësi të kufizuara duke krijuar mundësi dhe kushte të veçanta për këtë kategori dhe mundësia për të siguruar shpërndarje të ushqimit më

²¹ Shih, “Projekte për Inkurajimin e Përfshirjes sociale”, Shkup, 2017, faqe 6 – 120.

cilësor dhe më të mirë për të moshuarit, njerëzit e sëmurë dhe grupet e tjera shoqërore të pa favorizuar në komunën e Makedonski Brod.

“Punësimi i personave me aftësi të kufizuara – model i qëndrueshëm” – qëllimi: promovimi i një modeli të punësimit të qëndrueshëm të personave me aftësi të kufizuara, bazuar në aftësitë e tyre, për të kontribuar si qytetarë të barabartë dhe aktivë.²²

“Programi i vetë – punësimit për nënat e vetme” – qëllimi: të sigurohen nënat vetë mbështetëse (sidomos ish viktimat e dhunës në familje) me kompetencë, besim dhe qasje për të hyrë në mundësi të qëndrueshme punësimi dhe vetëpunësimi. **Aktivitetet:** programe arsimore afatgjatë mbi aftësitë profesionale dhe sipërmarrëse (në Shkup, Shtip dhe Manastir), pjesëmarrja e nënave në trajnim të aftësive profesionale, takime mbështetëse psiko-sociale të mbajtura në mënyrë të regullt etj. **Rezultatet:** trajnimi i grave në fushën e biznesit si mentorë, mbajtja e seancave mbështetëse psiko-sociale, shërbime të kujdesit për fëmijët e target grupit etj.

2.1.2 Projektet për fuqizimin e aktorëve përkatës në përfshirjen sociale

Instrumenti i Bashkimit Evropian për Ndihmë Praaderuese – IPA, ka publikuar edhe disa projekte të tjera që kanë të bëjnë me arritjen e qëllimit dhe realizimin e projektit për nxitjen e përfshirjes sociale dhe fuqizimin e aktorëve përkatës në fushën e përfshirjes sociale, edhe atë: **“Promovimi i përfshirjes sociale nëpërmjet përdorimit efektiv të fondeve të BE-së” – qëllimi:** forcimi i rolit të Qendrës për Punë Sociale, Institutit për Aktivitete Shoqërore dhe roli i organizatave të shoqërisë civile për zhvillimin e programeve inovative të përfshirjes sociale dhe për përmirësimin e planit të përfshirjes sociale nëpërmjet shfrytëzimit më të mirë të fondeve të BE-së. Ku si target grupet apo përfituesit janë punonjësit social nga Qendrat për Punë Sociale, Institute për Aktivitete Shoqërore dhe OSHC-të që punojnë në fushën e përfshirjes dhe mbrojtjes sociale. **Aktivitetet:** hulumtim për QPS-të mbi kapacitetet, aktivitetet dhe planet ekzistuese të tyre, për përfshirje sociale, studim në shkallë të gjërë mbi kushtet e jetesës në Maqedoni dhe

²² Po aty

problemet që lidhen me përjashtimin social, trajnime të përbashkëta për profesionistët e QPS-ve dhe OSHC-ve për përgaditjen e projekteve të Be-së, përpilimin e aplikacioneve, menaxhimin e projekteve, zbatimin dhe raportimin etj. **Rezultatet:** kapacitet më i madhë i punonjësve social të QPS-ve dhe IASH-ve në lidhje me munësitë për të shfrytëzuar fondet e BE-së në mënyrë efektive, për zhvillimin e programeve të qëndrueshme të përfshirjes sociale, realizimi i 11 aplikimeve të projekteve, të hartuara nga QPS-të dhe OSHC-të, partneritete lokale në mes QPS-ve dhe OSHC-ve, përpilimi i një manual trajnimi për hartimin dhe menaxhimin e projekteve të BE-së²³ dhe moduli që përfshin materialin e trajnimit është tanimë vec se pjesë e planprogramit të IASH-së.

“Partneriteti lokal për përfshirje sociale” – qëllimi: fuqizimi i aktorëve lokal dhe i shoqërisë civile në zhvillimin e planeve lokale të veprimit, rritja e nivelit të bashkëpunimit dhe rritja e pjesëmarrjes së aktorëve kyç në aktivitetet lokale dhe në politikat e përfshirjes sociale. Ngritja e vetëdijës për të gjithë aktorët kryesorë në komunitetet lokale në lidhje me përparësitë e partneriteteve lokale dhe zhvillimit lokal pjesëmarrës. **Aktivitete:** trajnime për ngritjen e kapaciteteve për palët e interesuara lokale dhe krijimi i partneriteteve dhe mbështetja e vazhdueshme e planeve lokale të veprimit për përfshirje sociale. **Rezultate:** themelimi i partneriteteve lokale në fushën e përfshirjes sociale, për adresimin e përjashtimit social në nivel lokal janë kyçur edhe kompetencat institucionale, përgaditja e plan veprimeve për përfshirjen sociale që përfshihen edhe në regulloren komunale duke ofruar bazë për trajnimin e problemeve të identifikuara, etj.

“Platforma aktive maqedonase për përfshirje sociale – PAMPS” – qëllimi: forcimi i aktorëve relevant (njësitë e vetëqeverisjes lokale, institucionet qeveritare, organizatat joqeveritare dhe aktorët e tjerë) në zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e programeve të përfshirjes sociale me fokus të veçantë në ndërtimin e partneriteteve, rrjetëzimin dhe bashkëpunimin. Bashkëpunimi I të gjithë aktorëve vendor, për të krijuar dhe realizuar mundësi, kushte dhe qasje më të lehtë në tregun e punës, për personat e përjashtuar nga shoqëria ose për personat e marginalizuar, dhe për personat në rrezik social. **Aktivitete:** takime dhe krijimi i rrjetit koordinues të OSHC –ve në

²³ “Projekte për Inkurajimin e Përfshirjes sociale”, Shkup, 2017, faqe 6 – 120.

nivel lokal, trajnime për ngritjen e kapaciteteve për koordinimin dhe monitorimin e Platformës Aktive Lokale për përfshirjen sociale (dialogu social shumëpalësh në komunë), takime individuale me palët e interesuara në nivel lokal dhe krijimi i listave gjithëpërfshirëse të të gjithë aktorëve lokal të pranishëm në komunën e targetuar, 18 konferenca lokale gjithëpërfshirëse të koordinuara nga OSHC-të lokale, etj. **Rezultate:** Rritja e dialogut dhe ngritja e vetëdijës për rëndësinë e dialogut social të grave dhe të rinjëve, krijimi i 18 Platformave Lokale që paraqesin strategjitë dhe programet e realizuara, promovimi i programeve PAMPS në nivel lokal dhe platform e internetit mapsi.mk, etj.

“Të sigurtë dhe të barabartë: Mos-diskriminimi dhe menaxhimi i diversitetit në punësim” – qëllimi: promovimi i përfshirjes aktive të njerëzve në tregun e punës, duke krijuar mundësi të barabarta për të gjithë, në qasjen e tregut të punës (përqëndrimi në mos-diskriminimin e grupeve të cenuara në vendin e punës dhe menaxhimi i llojllojshmërisë në punësim). **Aktivitete:** përhapja e informacionit për mosdiskriminim në punësim, trajnime në fushën e përfshirjes në tregun e punës dhe luftën kundër diskriminimit në punë, fuqizimi dhe trajnimi i aktorëve lokal për kryerjen e monitorimit të situatës lokale dhe nevojave sociale, trajnime dhe seminare, diskutime në tryezë²⁴ të rrumbullakët “Roli i organizatave joqeveritare në promovimin e mundësive të barabarta dhe mos-diskriminimit në punësim, etj. **Rezultatet:** rritja e ndërgjegjësimit, vizibilitetit dhe interesimit të mediave, partnerëve social dhe palëve të interesit për llojllojshmërinë kulturore dhe mos-diskriminimin në çështjet e punësimit, zhvillimi i metodave të trajnimit dhe zbatimi i trajnimeve për trajnerët për punë të qëndrueshme me partnerët social mbi politikën e barazisë në punësim, rritja e dialogut ndërmjet OJQ-ve, krijuesve të politikave dhe partnerëve social mbi politikën e barazisë në punësim, etj.²⁵

2.1.3 Projekti “Kuzhinat Kombëtare”

²⁴ Po aty.

²⁵ “Projekte për Inkurajimin e Përfshirjes sociale”, Shkup, 2017, faqe 6 – 120.

Në mënyrë që të kenë mundësinë e duhur dhe plotësimin e nevojës bazë për ekzistencë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ka siguruar ushqim apo një vakt të nxehtë për personat e moshur dhe në nevojë, për personat me aftësi të kufizuar e të cilët kanë statusin material të dobët dhe janë në një gjendje të rëndë sociale, kjo politik e vendosur për zhvillim të mbrojtjes sociale.

Në mënyrë që të mbështes kategorinë më të ndjeshme të njerëzve, duke filluar nga viti 2007, Qeveria e RM së Veriut ka prezantuar dhe zbatuar vazhdimisht projektin "***Kuzhinat Kombëtare***".

Gjatë kësaj periudhe, në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut janë hapur mbi 50 kuzhina publike me më shumë se 60 pika të shpërndarjes së ushqimit, dhe rreth 3500 njerëz në muaj përdorin shërbimet e këtij projekti.²⁶

Është edhe: Instituti për të drejtat njerëzore Ludvig Boltzman - Decentralizimi i mbrojtjes sociale, Programi për zhvillim i Kombeve të Bashkuara – UNDP, Fondi për fëmijët i Kombeve të Bashkuara – UNICEF, etj.

2.1.4 Politikat sociale në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe reformat në fushën sociale

Politikat sociale përfshijnë të gjitha masat dhe rregulloret e dispozitat të cilat synojnë në menjanimin, lehtësimin dhe parandalimin e të gjitha situatave jo të këndëshme, problemet sociale të individit apo të ndonjë grupi të caktuar. Sipas [Thomas Humphrey Marchall](#), “politika sociale konsiston në përdorimin e pushtetit politik për të zëvendësuar, plotësuar ose ndryshuar

²⁶ <https://www.mtsp.gov.mk/proekti-od-oblasta-na-socijalnata-zashtita.nspix>

mekanizmat e sistemit ekonomik me synim për të arritur rezultate që sistemi vet nuk mund t'i arrinte”.

Sipas OECD, “Një politikë sociale efikase ndihmon individët të jetojnë pa ankthe dhe të përshtatshme me mundësitë e reja të rritjes ekonomike. Në të kundërtën, një politikë e keqe sociale është sinonim i mbetjes në varfëri ose i përjashtimit social”.

Në kuptimin e ngushtë, politika sociale përcakton masat që shërbejnë drejtpërdrejtë në luftën kundër varfërisë ose parandalimit të saj, në rradhë të parë sigurimet sociale dhe ndihma sociale, si dhe pagesa të tjera në varësi të burimeve të mundëshme.²⁷ Në kuptimin e gjërë, fusha të tjera përfshihen gjithashtu në politikën sociale, të tilla si politika e tregut të punës dhe e punësimit, politika e arsimimit, e shëndetit, e strehimit, ose edhe politika fiskale.²⁸

Thuhet se shteti social është një koncept i shtetit që funksionon nëpërmjet ndërhyrjeve të organizmave të saj dhe në këtë mënyrë rregullon dhe mirëmban fushat sociale dhe ekonomike. Mirëmbajtje kjo e cila manifestohet me anë të masave adekuate që kanë për qëllim rishpërndarjen e pasurive dhe marrjen përsipër të rreziqeve sociale të ndryshme siç janë: varfëria, punësimi, sëmundjet, pleqëria dhe familja.

Shteti Social bazohet mbi solidaritetin midis grupeve shoqërore të ndryshme dhe në kërkimin e drejtësisë sociale.²⁹ Si objektiva kryesore të politikës sociale, në një shtet social, janë:

- drejtësia sociale (paanësia, barazia e shanseve)
- sigurimi shoqëror (mbrojtje kundër rreziqeve të mëdha të ekzistencës)
- paqja sociale
- pjesëmarrja më e gjërë e përbashkët.

²⁷ <https://shtetiweb.org/politikat-sociale-2/>

²⁸ Po aty.

²⁹ <https://shtetiweb.org/politikat-sociale-2/>

Nëpërmjet politikës sociale realizohen edhe disa misione të rëndësishme:

– *misioni rishpërndarës*: është shteti-Social që duhet të garantoj solidaritetin midis qytetarëve të tij,³⁰

– *misioni i aftësisimit*: që shërben si instrumente përmes të cilave njëzërit menaxhojnë shanset e tyre (barazia e shanseve, shëndetësia, arësimi, etj)

– *misioni regullator*: që ka lidhje me vendosjen e rregullave, si të drejtën e punës,

– *misioni mbrojtës*: përfshinë mbrojtjen e dinjitetit dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut.

Si sfida kryesore të politikave sociale janë: mbrojtja sociale dhe sigurimi shëndetësor, arsimit, personat në nevojë, si për shembull të pastrehët, lypësit, punësimi dhe puna, profesionalizmi, personat e moshuar etj. Lufta kundër përjashtimit ka sjellë zhvillimin e politikave të ndihmës sociale (mbështetja është e detyrueshme nëse personat plotësojnë kriteret e fiksuara për një përfitues) dhe të veprimit social (mbështetja është fakultative). E drejta e sigurimit shoqëror plotësohet kështu prej së drejtës së ndihmës sociale.³¹

Republika e Maqedonisë, si shtete anëtare e Kombeve të Bashkuara - ka një detyrim që në planifikimin e politikave të udhëhiqet nga qëllimet mijëvjeçare dhe të marrë parasysh dokumentet e miratuara në konferencat e KB për të arritur qëllimet shoqërore të përgjithshme globale: Deklarata e Rio de Janeiro dhe Agjenda 21 e Konferencës së KB për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e KB, Deklarata e Kopenhagës dhe Plani i Veprimit i miratuar në samitin botëror për zhvillim social, Deklarata shekullore e KB që rezulton nga Samiti i shekullor i Asamblesë së Përgjithshme të KB, Deklarata e Johaneshburgut dhe Plani i zbatimit të samitit botëror për zhvillim të qëndrueshëm.³²

³⁰ Po aty.

³¹ Po aty

³² “Национална програма за развој на социјална заштита 2011-2021”, службеник весник на РМ, бр.121/2010
faqe 1

2.1.5 Reformat në mbrojtjen sociale në vitin 2019

Mirëpo që nga viti 2019, ndihma sociale në të holla u reformua dhe u azhurnua në ndihmë minimale të garantuar. Baza për ndihmë minimale të garantuar është rritur në 4,000 denarë, për dallim nga e drejta ekzistuese për ndihmë financiare sociale e cila ishte në 2,871 denarë. Përfituesit ekzistues afatgjatë të ndihmës financiare sociale që mirrnin një shumë të reduktuar prej 50% të bazës, me ndihmën minimale të garantuar morën shumën e plotë të kësaj të drejte.

Sistemi i reformuar i mbrojtjes sociale parashikon aktivizim më të zgjeruar të përfituesve të ndihmës së garantuar minimale në mënyrë që të gjithë anëtarët e familjes e që janë me aftësi të mira fizike të mund të përfshihen në aktivitetet dhe programe e trajnime të ndryshme të punësimit e deri te punësimi i tyre. Kjo nënkupton vijimin e detyrueshëm të vazhdueshëm të trajnimeve, si dhe pranimin e një oferte për punë. Në të njëjtën kohë, përfituesve do t'u ofrohet mbështetje rreth përfundimit të arsimit të tyre me qëllim të pjesëmarrjes së tyre në tregun e punës.

Të drejtat e ridizajnuara të ndihmës sociale mund të shihen vetëm si një paketë familjare e të drejtave në përputhje me nevojat e familjeve dhe qytetarëve. Për personat/familjet në rrezik për shkak të pasigurisë materiale, përveç që ju sigurohet ndihma e garantuar minimale, ju sigurohet edhe 1,000 denarë për shpenzimet e ngrohjes për 6 muajt e dimrit, duke filluar nga muaji tetorë e deri në muajin mars të vitit vijues. Reforma gjithashtu u bënë edhe në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, duke iu mundësuar përfituesve të ndihmës së garantuar minimale, shtesa për fëmijët dhe shtesa shkollore për fëmijët e rregullt në shkolla fillore dhe ato të mesme duke mundësuar në këtë mënyrë mundëson që për herë të parë përfituesit e ndihmës minimale të garantuar të jenë në gjendje të përdorin ndihmën për fëmijë dhe ndihmën arsimore për fëmijët që ndjekin rregullisht mësimet në shkollën fillore dhe të mesme për shkak të mbështetjes për prindërit në pagimin e shpenzimeve të shkollës, duke parandaluar kështu lënien e hershme të shkollës.

Duke pasur parasysh përfshirjen sociale më të madhe të personave më aftësi të kufizuara, ekziston edhe e drejta e kompensimit të përhershëm në para – e cila mundëson kompensim në

para për prindërit që kujdesen gjatë jetës së tyre për fëmijë me aftësi të kufizuara duke mos i vendosur fëmijët në institucion për përkujdesje dhe duke mos gëzuar të drejtën e ndonjë pensioni tjetër, kjo për grupmoshat e gjinis femërore në 62 vjeç dhe për gjininë mashkullore në moshën 65 vjeç. Në këtë drejtim, u realizua përdorimi i shërbimeve sociale, siç janë: ndihma në shtëpi, ndihma personale, ofrimi i ndihmës dhe mbështetjes dhe shërbime të tjera në qendrat për qëndrim të përditshëm dhe të përkohshëm.

Për të kapërcyer situatën e krijuar që shërbimet e mbrojtjes sociale nuk ndjeknin edhe aq nevojat individuale të përdoruesve social, ligji i ri promovoi edhe zhvillimin e shërbimeve sociale që do të ofrohen në shtëpi, në komunitet dhe jashtë familjes, si dhe shërbime sociale inovative dhe ndërhyrëse.

Lidhur me ofrimin e shërbimeve sociale, është propozuar të përfshihet vetëqeverisja lokale, si dhe shoqatat e qytetarëve, individëve dhe sektorit privat në sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve në komunitet. Në këtë drejtim, u fut një sistem i licencimit të ofruesve të shërbimeve sociale apo licencimi i punëtorëve profesional.

Në pjesën e ofrimit të shërbimeve sociale nga komunitat, është planifikuar të sigurohen fonde nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë Veriore të cilat do të alokohen sipas procedurës së kryer pas thirrjes publike. Procedura do të zbatohet bazuar në programet lokale të komunave, të rishikuara dhe aprovuara nga rajoni i planifikimit. Për ofrimin e shërbimeve të caktuara sociale, një konkurs publik për ofruesit e shërbimeve sociale do të shpallet nga shoqatat e licencuara.

Me mënyrën e licencimit të profesionistëve dhe metodën e re të punës profesionale përmes "menaxhimit të çështjeve", profesionistët në Qendrat e punës sociale do të mund të planifikojnë të punojnë me përdoruesit në mënyrë që të kapërcejnë rrezikun shoqëror dhe përfshirjen në shoqëri. Punonjësi social së bashku me një person përgjegjës nga Agjencia e Punësimit do të punojë me të gjithë anëtarët e aftë të familjes për të marrë dhe përmirësuar aftësitë dhe njohuritë e punës në përputhje me aftësitë dhe nevojat e tyre në tregun e punës, i cili do të mundësojë punësimin e tyre si mënyra më e mirë për të dalë nga varfëria.³³

³³ Shih, "Закон за социјална заштита на Република Северна Македонија", мај, 2019

Qeveria vendosi një rrjet funksional të institucioneve për mbrojtje sociale, të afërt me qytetarët dhe adekuat për nevojat e tyre, ku një pjesë e kompetencave iu transferua edhe organeve të vetëqeverisjes lokale, e cila është më e afërt me ta dhe më shpejtë përshtatet me nevojat e tyre.³⁴

Ky rrjet përfshiu shërbime sociale për përkrahje dhe kujdes të veçantë për personat e moshuar, qendra për kujdes dhe inkuadrim, qendra për personat me nevoja të veçanta, bashkësitë për strehimin e personave me nevoja të veçanta edhe pas moshës 26 vjeç, shërbime për mbrojtje nga dhuna në bazë gjinore, si dhe shërbime për mbrojtje të grupeve tjera të qytetarëve që kanë³⁵ nevojë, e që ballafaqohen me ndonjë rrezik social.

Gjithashtu nga ana e Qeverisë u vendosë edhe sistemi i 8 agjencive rajonale për të pasur qasje qytetarët për të marrë shërbimet e pagesave të të drejtave material nga sistemi i mbrojtjes sociale, edhe atë në: Likovë, Studeniçan, Pehçevë, Berovë, Negotinë, Radovish, Konçe dhe Çashka. Aktorët më relevant në nivel lokal u bashkuan dhe krijuan strategji lokale për mbrojtje sociale dhe përfshirje sociale në bazë të nevojave reale të detektuar të grupeve të marginalizuara.³⁶

2.1.6 Politikat sociale aktuale dhe synuese për zbutjen dhe tejkalimin e nevojave sociale në vend

Qeveria solli ndryshime ligjore me qëllim të vendosjes të së drejtës për shfrytëzim, e jo për pronësi, të banesave sociale. Banesat sociale do të rriten në bashkësi kolektive banesore që do të menaxhohen nga vetëqeverisja lokale. Këtë të drejtë e gezojnë qytetarët me të hyra më të ulëta,

³⁴ <https://vlada.mk/node/18231?ln=sq>

³⁵ Po aty.

³⁶ Po aty.

përfituesit e ndonjë të drejtë të sistemit të mbrojtjes sociale, çiftet dhe të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara të cilët nuk kanë ndonjë pronë tjetër nga e cila mund të ripërbahen.

Sigurimi i ushqimit nëpërmjet hapjes së punkteve të ndryshme, duke bashkëpunuar me shoqatat locale dhe nacionale të komunave në nevojë.

Te ***sistemi pensional***, Qeveria garanton pagesën e rregullt të pensioneve duke synuar stabilizimin e Fondit për Sigurim Pensional dhe invalidor.

Politika sociale për të moshuarit – Ligji për sigurim social për personat e moshur u miratua në maj të vitit 2019, i cili ligj u siguroa në përputhje me parimet e humanizmit, solidaritetit dhe drejtësisë sociale. Këtë të drejtë e gezon personi i cili i ka mbushur 65 vjeç, kusht kryesorë ky. Përdoruesi ka të drejtë në një përfitim parash për të mbuluar një pjesë të kostove për konsumin e energjisë elektrike, për 6 muaj edhe atë nga muaji tetor deri në muajin mars. Përfituesit të kësaj të drejte i mundësohet edhe e drejta e sigurimit shëndetësor, në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret në fushën e sigurimeve shëndetësore, vetëm nëse këtë sigurim nuk mund ta realizojë në ndonjë mënyrë tjetër.³⁷

Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore si dhe ato për përkujdesjen e personave të moshuar dhe të sëmurë, në drejtim të përmirësimit të qasjes së tyre, në pajtim me kërkesat dhe nevojat e tyre konkrete si për gratë ashtu edhe për burrat. Do të vendosen subvencione të strehimit në azilet e pleqve për pensionistët me të hyra të vogla pa përkrahje të familjes si dhe ata pa ndonjë pronë.³⁸

³⁷ “Закон за социјална сигурност за старите лица”, мај, 2019, faqe 1-3

³⁸ <https://vlada.mk/node/18231?ln=sq>

Inicimi i krijimit të bashkësive të pensionistëve, duke bërë një strehim të organizuar të personave të moshuar, në lagje ku banimi do të sigurohet me çmime më të volitshme, me shërbime mjekësore në dispozicion, me oferta të volitshme të prodhimeve ushqimore.³⁹

Përkrahja e familjeve me nga një prind duke mundësuar orar fleksibil të punës për prindin si dhe lirim nga një pjesë e obligimeve publike (taksë, transport publik, kompensim për çerdhe) të familjeve me nga një prind, që kanë pagë më të ulët se paga mesatare. Do të krijohet Fond shtetëror për pagesën e kujdesit ligjor për fëmijët. Në rast se prindi nuk e paguan kujdesin në kohë, Fondi do të paguaj mjetet të cilat më pas do t'i inkasojë nga mospaguesi. Me këtë, do të garantohet pagesë në kohë e të gjithë kujdesit ligjor nga ana e prindërve ndaj fëmijëve të tyre. Në mënyrë shtesë, ofrohen shërbime falas për familjet me nga një prind me të hyra nën mesataren, në nivel lokal për përkrahjen gjatë funksionimit të përditshëm të këtyre qytetarëve.⁴⁰

Promovimi i shtëpive rajonale grupore, për fëmijët që nuk lejojnë familje për përkujdesje dhe që janë në rrezik social, duke iu mundësuar fëmijëve trajnime të ndryshme sociale me qëllim të ndërtimit të kapaciteteve dhe relacioneve sociale për të pasur qasje në përfshirje sociale të sërishme.

Politika sociale për personat me aftësi të kufizuara – duke iu mundësuar kompenzim në para për shkak të aftësisë apo pengesës që kanë, e cila e drejtë realizohet në bazë të mendimit konziliar të komisionit së shkallës së parë i cili komision është i përbërë nga tre mjekë specialist e që veprojnë në një institucion shëndetësor terciar përkatës. Gjithashtu ligji i mbrojtjes sociale i ri duke pasur parasysh mbrojtjen dhe reformën në këtë politikë miratoi edhe dy shërbime të reja për këtë kategori të personave, edhe atë Kujdesi në shtëpi dhe Ndihma personale për personat me aftësi të kufizuara.

Reforma që u bënë në mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut , e që nënkuptojnë:

³⁹ <https://vlada.mk/node/18231?ln=sq>

⁴⁰ Po aty.

- Rritje të dukshme të shumës së mjeteve për personat me nevoja të veçanta për mbrojtjen e të drejtave të tyre për 50% gjatë vitit 2018 deri në 2020.
- Me automatizëm e drejta për shtesa të veçanta që është përfitur deri në moshën 26 vjeç të kalojë në të drejtën për kujdes nga ndonjë person tjetër, e cila e drejtë nga viti 2019 me automatizëm po realizohet, edhe pse gjithmonë është paraparë me Ligjin konkret por asnjëherë nuk është vënë në praktik.
- Personat që shfrytëzojnë asistencë të veçantë financiare pas arritjes së moshës 18 vjeçare do të fitojnë mundësinë që të realizojnë edhe të drejtën për ndihmë të përhershme financiare.

Politika sociale për kujdestarin– kompenzime të përhershme në para për personin që gjatë jetës së tij, më së paku 15 vite, në familjen e tij, është kujdesur për një person me aftësi të kufizuara dhe prindi që deri sa ka mbushur fëmija e tij me aftësi të kufizuara moshën 26 vjeç, është kujdesur vetë prindi duke mos e vendosur fëmijën e tij për fëmijën e tij në ndonjë institucion për përkujdesje.

Riorganizimi i qendrave ditore për personat me pengesa – duke përpiluar dhe ridefinuar norma, dhe regulla të qarta për të dalluar kategoritë e përfshirjes, sipas madhësisë së grupeve apo numrit në grup, moshës, gjinisë e tj. Do të miratohen edhe plane dhe programe të veçanta për aktivitetet e grupeve në Qendrat ditore, sipas kategorive dhe sferave të përpunimit të programeve. Gjithashtu kjo politik parshih edhe krijimin e disa normave për të pasur edhe kuadër adekuat profesional që do të punojnë e do të shërbjenë në Qendrat ditore, duke mos I lënë anash edhe përmbyshjet e nevojshme të resurseve teknike në Qendrat ditore.

Me ligj do të garantohet përfshirja **edukatorit special në çdo çerdhe dhe shkollë** ku ka fëmijë me aftësi të veçanta, me qëllim të përkrahjes adekuate të fëmijëve dhe familjeve.⁴¹

Refundim në kohë i kontributeve për sigurim pensional dhe shëndetësor në bazë të punësimit të shoqatave për mbrojtje.

⁴¹ <https://vlada.mk/node/18231?ln=sq>

Respektimi i kuotave për punësimin e personave me nevoja të veçanta në administratën publike, duke vlerësuar mendimet personale të dhëna nga qendrat për punë sociale, për prioritet gjatë punësimit. Komisioni mjekësor do të vizitojë në shtëpi personat të cilëve duhet t'u sigurohet ***shtesë për mobilitet, verbëri dhe shurdhim***, e që veç më kanë diagnozë të konstatuar.⁴²

Sigurimi i së drejtës për asistencë financiare edhe për personat me vështirësi më të mëdha intelektuale. Krijimi i një sistemi për vlerësimin e nevojave specifike (kategorizim) i fëmijëve me pengesa në bazë të Klasifikimit ndërkombëtar të funksionimit. Modeli ka për qëllim që në aspekt funksional të përcaktojë karakteristikat specifike të fëmijëve me nevoja të veçanta, por jo sipas asaj që nuk mundën ta bëjnë, por sipas aftësive të tyre të tjera, respektivisht sipas asaj që ata mund ta bëjnë (vlerësim funksional).

Hapja e qendrave për zhvillim të hershëm të fëmijëve të cilat do t'i përfshijnë fëmijët e moshës së hershme, menjëherë pas lindjes, që si funksion themelor do ta kenë zhvillimin e aftësive të fëmijëve me ndonjë lloj vështirësi të veçantë (paralizë cerebrale, autizëm, etj.).

Financim do të kenë edhe ***punktet dhe bujtinat e ushqimit për personat e pastrehë***, ku do të hapen në komunat ku do të ketë më shumë nevojë, duke bashkëpunuar me shoqatat e ndryshme locale dhe nacionale. Do të përpilohet një ligj, sipas modelit të Francës, i cili do të mundësojë dhurimin e ushqimit nga ana e supermarketëve, restoranteve, prodhuesve dhe distributorëve.⁴³

Politikat sociale për përfshirje të **personave të papunë në aktivitete dhe programe të punësimit dhe të përkrahjes socio ekonomike, duke mundësuar edhe uljen e varfërisë** – nëpërmjet programeve, planeve dhe strategjive të ndryshme në këtë aspekt. Ku *Plani Operacional për programet aktive dhe masat për punësimin dhe shërbimet në tregun e punës për vitin 2021* përcakton programet, masat dhe shërbimet për punësim që do të sigurojnë krijimin e vendeve të punës, mbështetjen për krijimin e vendeve të punës dhe rritjen e punësimit të personave të papunë, veçanërisht të rinjëve, të papunët afatgjatë dhe përfituesit e të drejtës minimale të garantuar nga mbrojtja sociale), si dhe mbështetje për personat e papunë ku

⁴² Po aty.

⁴³ Po aty.

ndërprerja e mardhënies së punës u regjistrua gjatë krizës së shkaktuar nga Coronavirus COVID 19 (nga 11.03.2020).

Theks të veçantë ve Plani Operacional i vitit 2021, për personat e papunë e që i përkasin moshës deri më 29 vjeç, përfituesit e ndihmë së garantuar minimale dhe për personat që janë kohë të jata të papunë. Si bartës i këtij plani është Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, dhe si agjencion i cili merret me zbatimin e këtij plani është Agjencia e Punësimit të Republikës së Maqedonisë Veriore, në bashkëpunim me institucionet e tjera përgjegjëse. Dhe secili institucion përkatës, ompetent do të japë e sigurojë të dhëna në lidhje me zbatimin e Planit Operacional.

Ku në këtë planë përfshihen edhe: **Programi i vetëpunësimit** që është një mbështetje e krijuar për të papunët për të filluar biznesin e tyre, *subvencionimi i pagave* - mbështetje për punësimin e njerëzve të papunë që e kanë më të vështirë të hyjnë në tregun e punës, *punësimi dhe rritja e subjekteve juridikë* - mbështetje në krijimin e vendeve të reja të punës në ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, ndërmarrjet sociale dhe organizatat e shoqërisë civile, *mbështetje për punësimin e personave me aftësi të kufizuara* - të rritet punësimi dhe mundësitë e punësimit të personave të papunë të regjistruar me aftësi të kufizuara, trajnime të ndryshme dhe trajnim on-line i aftësive me kërkesë të punëdhënësve, punët publike etj.⁴⁴

Nëpërmjet planeve individuale që përgaditen ndërmjet Qendrës për Punë Sociale dhe Agjencionit për punësim për përfituesit e së drejtës së ndihmës së garantuar minimale, iu jepet mundësia në pjesëmarrje aktive në masat e punësimit që në të ardhmen të mund edhe të vijë deri te punësimi i tyre.

E rëndësishme është të ceket edhe *situata e pandemisë COVID-19, ku Qeveria e Republikës së Maqedonisë Veriore miratoi një Dekret me fuqi juridike për ndryshimin e Dekretit me fuqi ligjore për zbatimin e ligjit për mbrojtjen sociale gjatë një gjendje të jashtëzakonshme*, i cili dokumenton në ndërhyrjen e të drejtës së ndihmës minimale të garantuar për përdoruesit, puna e

⁴⁴ “Оперативниот план за програмите и активните мерки за вработување и услугите во пазарот на труд за 2021”, Скопје, март, 2021

të cilave u ndërpre gjatë pandemisë u lehtësua nga Prilli deri në Dhjetor 2020, pra ju mundësua të jenë shfrytëzues së ndihmës minimale të garantuar, kështu që gjatë kësaj periudhe 5,500 familje, këtë të drejtë e fituan.⁴⁵

Në të njëjtën kohë, ky akt mundësoi që suplementi monetar të mbulojë një pjesë të kostove për konsumin e energjisë elektrike, në familje të sigurohet vazhdimisht dhe pandërprerje gjatë tërë vitit 2020.

Për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive sistemit të mbrojtjes sociale, në mënyrë që të sigurohet qasje më e lehtë për të drejtën e ndihmës minimale të garantuar për familjet që do të mbeten pa mjetet e tyre të jetesës në kohë emergjence (ekzistenca e përcaktuar e krizës, e shpallur epidemi, dmth pandemi, zjarre, përmbytje ose katastrofa të tjera të mëdha natyrore), u miratua Ligji për Ndryshimet në Ligjin për Mbrojtjen Sociale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Veriore" nr. 302/20).

Kjo rregullore u zbatua nga 1 janari 2021, me qëllim të sigurimit për të pasur qasje në përfitimin e të drejtës së garantuar minimale deri sa të jetë aktuale edhe gjendja e pandemisë. Miratimi i ndryshimeve në Ligjin për Mbrojtjen Sociale do të lejojë që shërbimi i ndihmës personale të përdoret nga fëmijët mbi moshën gjashtë vjeç.

Promovimi dhe zhvillimi i shërbimeve sociale që do të ofrohen në shtëpinë e përdoruesit, në komunitet dhe jashtë familjes, si dhe përfshirja e komunave dhe ofruesve të shërbimeve sociale do të vazhdojë gjatë vitit 2021, përmes programeve, projekteve, strategjive, aktiviteteve etj.⁴⁶

Politika sociale për fëmijët në shkollë – politikë e cila u prezantua dhe u miratua që na viti 2009, funksionoi si e drejtë për fëmijët që ndjekin shkollimin e mesëm, të rregullt, e që i përkasin familjeve përfitues të ndihmave sociale, u mundësua kompenzim në të holla për të mbuluar harxhimet e shkollore të fëmijëve, mirëpo me miratimin e ligjit të ri të mbrojtjes sociale e

⁴⁵ Shih, "Програмот за остварување на социјалната заштита за 2021 година", службен весник на РСМ, бр. 3/2021, faqe 1

⁴⁶ По ату.

gjegjesisht me miratimin e ligjit për mbrojtjen e fëmijëve, që nga viti 2019, u realizua edhe e drejta për shtesa shkollore për arsimin fillor edhe atë të mesëm.

Shtesa për shkollim mbulon një pjesë të vogël të harxhimeve shkollore për fëmijët e familjeve që janë në nevojë dhe të pasiguruar materialisht. E drejta për ndihmë arsimore i takon një familje me fëmijë i cili rregullisht ndjek arsimin fillor ose të mesëm në shkollat në Republikën e Maqedonisë së Veriut të verifikuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe të regjistruara në regjistrin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ku të ardhurat mesatare totale mujore të realizuara në tre muajt e fundit para dorëzimit të aplikimit dhe gjatë përdorimit të së drejtës për të gjithë anëtarët e familjes të jenë deri në⁴⁷ pragun e të hyrave që i garanton e drejta e ndihmës për arsim, e cila përcaktohet në 6,800 denarë, e cila rritet për secilin anëtar të familjes me një koeficient të shkallës ekuivalente, deri në tetë anëtarë të familjes, edhe atë:

anëtari i dytë për koeficient për 0,5

anëtari i tretë për koeficient për 0,4

anëtari i katërt për koeficient për 0,4

anëtari i pestë për koeficient për 0,2

anëtari i gjashtë për koeficient për 0,1

anëtari i shtatë për koeficient për 0,1 dhe

anëtari i tetë për koeficient për 0,1.⁴⁸

Politikat sociale për familjet materialisht të pasiguruara, përveç ndihmës minimale të garantuara edhe shtesave për fëmijët, që nga viti 2009 u shtua edhe një e drejtë e re, shtesë prindërore për fëmijë, apo siç njihet ndryshe si e drejta e fëmijës së tretë, e cila u realizua për të gjithë familjet të cilët lindën fëmijën e tretë, kurse më vonë që nga viti 2019, këtë të drejtë e gëzojnë familjet që lindin fëmijën e tretë, dhe realizohet nëse të ardhurat e familjes së nënës së fëmijës, në tre muajt e fundit para se të aplikojë për këtë të drejtë por edhe gjatë realizimit të kësaj të drejte të jenë më të ulëta se rroga minimale që ka qenë në vitin e kaluar.

⁴⁷ “Закон за заштита на деца”, 2019, член 39-b

⁴⁸ По ату.

Politikat e procesit të decentralizimit, mund ta quajë deri diku? - ku më lartë është cekur se Qeveria ka vendosur sistemin e tetë agjencive rajonale, proces ky, i cili u përkrahë nga Instituti për të drejtat njerëzore “Lludvig Boltzman”. Ku është konstatuar se nga rrjeti ekzistues i institucioneve për mbrojtje institucionale dhe jashtinstitucionale nuk mund që ky rrjet ekzistues në mënyrë adekuate t’u përgjigjet nevojave të identifikuara të qytetarëve. Sic janë grupet më të prekshme: fëmijët dhe personat e moshuar, mospasja e çerdheve fëmijërore të mjaftueshme dhe shtëpijë të pleqëve, gjegjësisht ato që tanimë ekzistojnë nuk mund t’i përmbushin nevojat e popullatës lokale. Një ndër parakushtet e domosdoshëm përmes të cilit mund të intenzivohet procesi i decentralizimit është: Nxitja e bashkëpunimit multisektorial.

Kapitulli tretë

3.1 Të drejtat për ndihmë financiare nga mbrojtja sociale

Nga muaji maj i vitit 2019 Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi dhe solli Ligjin e ri për mbrojtje sociale, ligj i cili rregullon sistemin dhe organizimin e mbrojtjes sociale, procedurat për realizimin e të drejtave dhe përdorimin e shërbimeve, të drejtat e asistencës sociale ,shërbimet sociale, kryerjen e veprimtarisë së mbrojtjes sociale, financimin,kuadrot , mbikëqyrjen në realizimin e mbrojtjes sociale dhe çështje të tjera të rëndësishme për kryerjen e veprimtarisë së mbrojtjes sociale.

Të drejtat për ndihmë financiare nga mbrojtja sociale janë:

3.1.1 a) Ndihmë minimale e garantuar

Të drejtën e ndihmës minimale të garantuar e gëzon ç' do familje e cila nuk ka në pronësi ndonjë pronë ose ndonjë të drejtë pronësore nga e cila mund të ripërmbahet dhe të jetojë dhe të cilët familje janë materialisht të pasiguruar. Si familje e pasiguruar materialisht konstatohet një amvisëri, shuma e përgjithshme mesatare e të gjitha të hyrave të anëtarëve të amvisërisë nga të gjitha aspektet, gjatë tre muajve të fundit para parashtrimit të kërkesës për realizimin e të drejtës edhe gjatë shfrytëzimit të së drejtës, është më e ulët se shuma e ndihmës së përcaktuar dhe të garantuar minimale, në pajtim me ligjin. (Neni 28)

Baza e shumës të së drejtës për ndihmë të garantuar minimale është 4.000 denarë në muaj, e përlllogaritur si bazë për një anëtarë të familjes, e rritur për koeficientin e shkallës ekuivalente për çdo anëtarë tjetër të familjes, e më së shumti deri në pesë anëtarë në një familje, edhe atë:

- Anëtarin e dytë për koeficient prej 0.5 (+ 2000den)
- Anëtarin e tretë për koeficient prej 0.4 (+ 1600den)
- Anëtarin e katërt për koeficient prej 0.4 (+ 1600den)
- Anëtarin e pestë për koeficient prej 0.2. (+800 den)

Për fëmijët e amvisërisë, baza rritet për koeficientin prej 0.1. (+ 400den)

Për çdo nënë të vetë mbajtur, gjatë shtatzanisë shkalla ekuivalente rritet për koeficient prej 0.5 deri një muaj para lindjes dhe për prind të vetëm deri sa fëmija të filloj arsimin fillor e më së

voni deri në moshën shtatëvjeçare, edhe atë deri te fëmija i tretë. Shkalla ekuivalente gjithashtu rritet edhe për personat me aftësi të kufizuara, për shkak të pengesave të tyre trupore, sëmundjeve shpirtërore, pengesave intelektuale, e më së shumti deri në tre anëtarë në një familje edhe atë për anëtarin e parë për koeficient prej 0.5, për anëtarin e dytë dhe të tretë për koeficient prej 0.2 .

Paaftësia për punë e këtyre personave, konstatohet me raport, vlerësim dhe mendim nga komisioni profesional për konstatimin e paaftësisë për punë, e formuar pranë Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në pajtim me Ligjin për sigurimin pensional dhe invalidor. (Neni 29)

Ndihma e garantuar minimale paguhet në lartësinë e dallimit të shumë së konstatuar të ndihmës së garantuar minimale dhe të hyrave të përgjithshme mesatare mujore nga të gjitha burimet në familje, të realizuara gjatë tre muajve të fundit. Shuma e ndihmës së garantuar minimale përshtatet sipas rritjes së shpenzimeve të jetesës për vitin e kaluar, të publikuara nga Enti shtetëror i statistikës në janar të vitit vijues.⁴⁹ Në rast kur nuk ka rritje të shpenzimeve të jetesës për vitin e kaluar, nuk bëhet përshtatje e shumës së ndihmës së garantuar minimale. (Neni 31)

Këtë të drejtë nuk mund ta gëzojnë familjet të cilat munden të:

- Të rimbahen vetvetiu, të punojnë dhe në këtë mënyrë të sigurojnë të ardhura mujore,
- duke siguruar të ardhura nga shitja e ndonje prone ose dhënia e pronës me qira,
- nëse ka bërë kontratë për kujdes të përhershëm dhe nna ana tjetër ajo kontratë figuron ende active dhe nuk është ngritur procedur për prishjen e të njejtës.
- Mund të sigurojë përkujdesje në baza tjera,
- Nuk është evidentuar si i papunë në Agjensionin e punësimit ose edhe është fshirë nga mos paraqitja e rregullt në mënyrë active si persona i papunë deri të Agjensionin për punësim,
- Personit që i ka përfunduar kontrata e punës me anë të marrëveshjes në mes punëtorit dhe punëdhënësit, me vetëkërkesë nga punëtori ose edhe me përjashtim nga puna nga ana e punëdhënësit, për shkak të shkeljes së rregullave që kanë të bëjnë me kontratën e punës, kjo e

⁴⁹ “Закон за социјална заштита на Република Северна Македонија, мај, 2019, faqe 16-17

cila vlen për 12 muajt e fundit para se të bëhet aplikimi për këtë të drejtë. E drejta e ndihmës së garantuar minimale nuk mund të realizohet nga një amvisëri e cila nuk është e ekspozuar në rreziqe sociale, që konstatohet në bazë të një kontrolli të drejtpërdrejtë dhe dokumentacionit zyrtar nga punëtori i autorizuar i qendrës për punë sociale. (Neni 33)

Pjesëtarët e familjes të cilët janë të papunë, dhe njëkohësisht janë edhe shfrytëzues të ndihmës minimale të garantuar, obligohen detyrimisht të evidentohen si kërkues të punës në Agjensionin për punësim në pajtueshmëri me Ligjin për sigurim dhe punësim. Nga dita e pranimit të vendimit për realizimin e të drejtës për ndihmën minimale të garantuar. Qendra për punë sociale e obligon shfrytëzuesin që të evidentohet si i papunë në Agjensionin e punësimit në afat prej 30 ditëve.

Nëse shfrytëzuesi nuk paraqitet në qendrën kompetente të punësimit në afatin e përcaktuar, i njëjti me detyrë zyrtare, menjëherë ndërsa më së voni tre ditë nga dita e skadimit të afatit, e njofton qendrën kompetente për punë sociale. (Neni 34)

Qendra për punë sociale harton dhe përpilon një plan individual për secilin pjesëtarë të familjes e që janë shfrytëzues të ndihmës minimale të garantuar, të aftë për punë dhe që janë të evidentuar në Agjensionin për punësim.

Qendra për punësim dhe Qendra për punë sociale , bashkëpunojnë në mes vete për realizimin e planit individual, duke i përfshirë shfrytëzuesit e ndihmës minimale të garantuar në masat aktive të punësimit dhe duke i punësuar ato.

Mënyra e bashkëpunimit për përfshirjen e shfrytëzuesit në masat aktive të punësimit, si dhe forma e formularit të planit individual nga neni 35 paragrafi 1 i këtij ligji, përcaktohen nga ana e ministrit të Punës dhe Politikës Sociale (në tekstin e mëtejme: ministri). (Neni 37)

Ky si obligim i cili do të theksohet se nuk është i detyrueshëm për personat:

- në shkollim të rregullt
- të paaftë për punë
- grua gjatë shtatzënisë e deri në një muaj para se të lind dhe për prindin e vetëm i cili duhet të kujdeset për fëmijën e posalindur deri në nëntë muaj,

- personi që është në moshën mbi 60 vjeçare, përveç nëse dëshiron vetë të marrë pjesë në aktivitetet e punësimit,
- në marrëdhënie pune,
- realizues i veprimtarisë bujqësore, blegtorale ose ndonjë forme tjetër dhe
- realizues i veprimtarisë së zejtarisë, respektivisht veprimtarie profesionale. (neni 38)

Personat shfrytëzues të ndihmës minimale të garantuar mund të kryejnë punë publike, në mënyrë të angazhuar me qëllim të sigurimit në raste të papounësisë e që janë në pajtim me rregullat e punësimit.

Nëse shfrytëzuesi i ndihmës së garantuar minimale, e refuzon pa arsye angazhimin e punës, konsiderohet si anëtar i amvisërisë gjatë përlllogaritjes së të hyrave të përgjithshme të amvisërisë, ndërsa përjashtohet nga shfrytëzimi i së drejtës për ndihmë të garantuar minimale gjatë 12 muajve të ardhshëm, llogaritur nga dita e miratimit të vendimit. (Neni 39)

Familja që shfrytëzon ndihmë të garantuar minimale, realizon gjithashtu edhe shtesën për energji elektrike, kështu duke mundësuar lehtësim për ato familje, edhe atë duke filluar nga muaji tetorë I vitit praparak, të tanishëm e deri në muajin mars të vitit vijues. Shuma mujore e shtesës është 1.000 denarë, e përshtatur me rritjen e shpenzimeve të jetesës për vitin e kaluar, që janë publikuar nga Enti Shtetëror i Statistikës, në janar për vitin vijues. (Neni 42)

Amvisëritë me fëmijë që shfrytëzojnë ndihmë të garantuar minimale, realizojnë edhe të drejtat për mbrojtjen e fëmijëve, në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve, si shtesa femijërore por edhe shtesa për shkollim. (Neni 43)

3.1.2 b) Kompensime për shkak të pengesave

Kompensim për shkak të pengesës sigurohet me qëllim për te nxitur përfshirjen sociale dhe për të mundësuar barazi për personat që janë:

- me pengesë të thellë intelektuale,
- me formë të pengesës më të rëndë

- person plotësisht i verbër dhe

- person plotësisht i shurdhër.

Kompensimi për shkak të pengesave realizohet për persona të moshës 26 vjeçare deri në moshën 65 vjeçare, e që shfrytëzohet pa dallim të moshës së shfrytëzuesit.

Kompensimi për shkak të pengesave nuk mund të realizohet nga një person i cili e shfrytëzon të drejtën e invaliditetit civil ose ushtarak. (Neni 44)

Kjo e drejtë e kompensimit realizohet në bazë të përcaktimit konziliar të komisionit të shkallës së parë, i cili përbëhet nga tre mjekë specialist nga një institucion shëndetësor përkatës.

Personat me pengesa të rënda ose të thella intelektuale, realizojnë të drejtën e kompensimit për shkak të pengesës, në bazë të një konstatimi permanent, vlerësim dhe mendim lidhur me llojin dhe shkallën e pengesës, të lëshuar nga një organ profesional, në procedurë në pajtim me aktin e përgjithshëm dhe mënyrën e konstatimit të llojit dhe shkallës së pengesës, përcaktohen nga ministri, në pajtim me ministrin e Arsimit dhe Shkencës dhe ministrin e Shëndetësisë, si dhe vendimit nga Qendra për punë sociale. (Neni 46)

3.1.3 c) Ndihmë financiare për ndihmë dhe kujdes nga një person tjetër

Të drejtë për kompensim për ndihmë dhe përkujdesje nga një person tjetër ka çdo person që ka mbushur 26 vite moshë, me pengesë të matur, të rëndë ose të thellë intelektuale, person me pengesa të rënda dhe më të rëndë trupore, person plotësisht i verbër, si dhe person me ndryshme të përhershme të gjendjes shëndetësore, i cili ka nevojë të domosdoshme për ndihmë dhe përkujdesje nga një person tjetër, sepse ai vetë nuk mund të kryej aktivitetet bazë nga jeta e përditshme, nëse këtë të drejtë nuk mund ta realizojë në bazë të rregullave tjera. (Neni 48)

Shuma e kompensimit për kujdesje dhe ndihmë nga një person tjetër, përcaktohet mvarësisht nga nevoja për kujdesje dhe ndihmë nga një person tjetër.

Nevoja për kujdesje dhe ndihmë nga një person tjetër në masë të madhe ka një person me pengesë të thellë intelektuale, person me pengesa të rënda trupore, person i verbër plotësisht, si dhe person me ndryshme të gjendjes shëndetësore të përhershme, duke mos mundur që të përmbushin aktivitetet themelore nga jeta e përditshme, nuk mund që as me ndihmën e pajisjeve

ortopedike të lëviz brenda ose jashtë banesës, nuk mund që vet të ushqehet, vishet, të mirëmbajë higjienën personale, e as që të kryej nevojat themelore fiziologjike.

Gjatë konstatimit të shkallës së nevojës për ndihmë dhe përkujdesje nga një person tjetër merret parasysh edhe indeksi i Barellit (Bartelloviot indeks), i cili është pjesë përbërëse e mendimit të lëshuar nga mjeku amë i parashtruesit të kërkesës. (Neni 49)

Nevojën për ndihmë dhe përkujdesje nga një person tjetër përmes një konstatimi, vlerësimi dhe mendimi e përcaktojnë komisionet profesionale të formuara në institucionet publike shëndetësore në përbërje me nga tre doktorë specialist ose subspecialist të këtyre sferave: mjekësisë interne, neurologjisë, psikiatrisë, mjekësisë fizikale dhe rehabilitimit, ortopedisë ose oftalmologjisë. (Neni 51)

3.1.4 ç) Kompensim në pagë për orar të shkurtuar të punës - për shkak të përkujdesjes së fëmijës me pengesa trupore ose mentale në zhvillim. (Neni 55)

3.1.5 d) Shtesa për banim – iu mundësohet personave materialisht të pasiguruar në banim edhe atë:

- shfrytëzues të ndihmës minimale të garantuar

- personi i cili deri në moshën 18 vjeçare ka pasur statusin e fëmijës pa prindër dhe pa kujdes prindëror, e vecanërisht pas ndërprerjes së kujdestarisë, por jo shumë se 26 vjeç. (Neni 57)

3.1.6 e) Kompensime të përhershme – kjo e drejtë i mundësohet kujdestarit i cili është kujdesur për një person me aftësi të kufizuara në familjen e tij dhe prindi i cili është kujdesur për fëmijën me aftësi të kufizuara.⁵⁰ (Neni 58)

Të drejtën për kompensim të përhershëm e realizon kujdestari i cili është kujdesur për një person në familjen e tij / saj për të paktën pesëmbëdhjetë vjet, pasi ka arritur 62 vjet jetë për një

⁵⁰ “Закон за социјална заштита на Република Северна Македонија, мај, 2019, faqe 16-17

grua, dmth 64 vjet jetë për një burrë, i cili është i papunë dhe nuk e gëzon të drejtën për pension. (Neni 59)

E drejta për kompensim të përhershëm ushtrohet nga një prind që është kujdesur për një fëmijë deri në moshën 26 vjeç, duke mos e përdorur shërbimin e kujdesit jashtë-familjes të mbrojtjes sociale, i cili është i papunë dhe nuk përdor të drejtën e pensionit, pasi të ketë mbushur 62 vjeç për një grua, domethënë 64 vjet jetë për një burrë. (Neni 60)

3.1.7 f) Ndhimë e njëhershme financiare dhe ndihmë në naturë

Ndhimja e njëhershme në para ose ndihmë në naturë i ofrohet një personi ose një familjeje e cila ballafaqohet me rreziqe sociale, gjithashtu për shkak të ndonjë fatkeqësie ose epidemie, si dhe në raste të mjekimit më të gjatë të ndonjë anëtari të familjes në një institucion shëndetësor.

Ndhimë në nature i ofrohet një personi ose familje duke iu siguruar ushqim ,veshje, dhe mjete të tjera për të cilat qendra për punë sociale konstaton se janë të domosdoshme duke iu mundësuar një ekzistencë minimale të qytetarit dhe familjes.

Me përjashtim, shtetasit e Republikës së Maqedonisë së Veriut të cilët nuk kanë vendbanim të përhershëm, si dhe të huajt me qëndrim të përkohshëm,ndihmën në naturë mund ta shfrytëzojnë në rastet e fatkeqësive, sëmundjeve akute që kërkojnë trajtime spitalore dhe të ngjashme, në pajtim me ligjin.

Në Buxhetin e Republikës sigurohen mjete për të dhënë ndihmë të njëhershme në para në rastet e rrezikimit të jashtëzakonshëm të popullsisë në përmasa më të mëdha.(Neni 61)

- në raste te fatkeqsisë natyrore (zjarrit,vërshimit,tërmetit),epidemisë dhe vdekja e një anëtari të familjes,duke u gjendur në pozitë të rrezikut social, e që mund të mbeten pasoja të përhershme, - person që ka nevojë për shërim më të gjatë në një institucion shëndetësor jashtë vendit ose ndërhyrje operative

- person që është i paaftë për punë dhe nuk ka të siguruar çështjen banesore e që shfrytëzon ndihmën e garantuar minimale, si një ndihmë për të siguruar akomodimin e domosdoshëm.
- familje ose person që gjendet në pozitë të rrezikut social në rast të shërimit më të gjatë në institucione shëndetësore,
- viktimë të dhunës në familje, për të realizuar të drejtën e mbrojtjes shëndetësore dhe trajtimeve mjekësore.⁵¹ (Neni 62)

Ndihmë e njëhershme financiare dhe ndihma në natyrë realizohet duke parashtruar kërkesë deri te Qendra për punë sociale , duke marrë parasysh rregulloren përkatëse si dhe kushtet e parapara sipas Ligjit për mbrojtje sociale.

3.2 E drejta e mbrojtjes shëndetësore

Të drejtën e mbrojtjes shëndetësore kanë:

- përfituesit , e ndihmës së minimale të garantuar,
- ,përfituesit e kompensimit për personat me pengesa,
- përfituesit e kompensimit për përkujdesje dhe ndihmë nga tjetër person,
- persona të cilët kanë status të pranuar të refugjatit dhe person në mbrojtje subsidiare,
- shfrytëzuesit e mbrojtjes jashtë-familjare,
- personat të cilët janë viktimë e dhunës në familje , duke marrë masa për mbrojtje në pajtim me rregullat e parandalimit, pengimit dhe mbrojtjes nga dhuna
- personat – viktimë të tregtisë me njerëz

Shfrytëzuesit nga paragrafi 1 i këtij neni, realizojnë të drejtën e mbrojtjes sociale, vetëm nëse nuk mund të fitojnë ndonjë sigurim në mënyrë tjetër. ⁵² (Neni 66)

⁵¹ Po aty, faqe 17-19

⁵² Po aty, faqe 19.

4 Kapitulli katërt

4.1 Fushat e shërbimeve sociale

Ligji për Mbrojtje Sociale rregullon shërbimet sociale përmes dy formave të mbrojtjes:

Mbrojtja jo/jashtë-institucionale - përfshin të drejtën për:

- a. shërbimin e parë për përfituesit e mbrojtjes sociale;
- b. ndihmën për një individ;
- c. ndihmën për familjen;
- d. kujdesin dhe ndihmën në shtëpi për një individ dhe familje;
- e. pranimin dhe kujdesin si ndihmë individuale dhe familjare, përkohësisht dhe çdo ditore;
- f. akomodimin/vendosjen në një familje kujdestare;
- g. akomodimin/vendosjen e një grupi të oragnizuar në një shtëpi.

Mbrojtja jo-institucionale realizohet nga këto institucione: qendra për punë sociale, qendra ditore dhe klubet për të moshuarit dhe të rriturit, qendra ditore për fëmijët e rrugës, qendra ditore

për personat që përdorin ose abuzojnë me drogë dhe substanca të tjera narkotike, qendra ditore për njerëzit që keqpërdorin alkoolin ose trajtohen për varësi nga alkooli, qendra për të pastrehët, qendra për personat - viktimat të dhunës në familje, qendra për persona - viktimat të trafikimit njerëzor, qendra ditore për personat me aftësi të kufizuara mendore ose fizike, qendra për dhënie ndihmë në shtëpi, qendra për rehabilitim social⁵³ për personave të cilët përdorin ose abuzojnë me barna dhe substanca të tjera, shtëpi e grupeve të vogla dhe qendër këshillimi.


Mbrojtja institucionale përfshin të drejtën për:

- a. trajnim për veprimtari të prodhim-punës dhe
- b. të drejtën e akomodimit në një nga institucionet e lartpërmendura.

Mbrojtja institucionale realizohet nga këto institucione: institucioni për akomodimin e foshnjave dhe fëmijëve të vegjël pa prindër dhe pa kujdes prindëror deri në moshën tre vjeç, institucioni për akomodim të fëmijëve pa prindër dhe pa kujdes prindëror mbi moshën tre vjeç dhe për të rinjtë, institucioni për akomodimin e fëmijëve dhe të rinjve me probleme arsimore dhe sociale, institucioni për akomodimin e fëmijëve dhe të rinjve me sjellje të çrregullt, institucioni për akomodimin e fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike, institucioni për akomodimin e të moshuarve, institucioni për akomodimin e të rriturve me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike, dhe institucioni për akomodimin e azilkërkuesve.⁵⁴

⁵³ “Социјалната заштита во Македонија: Регулатива и практика”, Скопје, 2019, faqe102

⁵⁴ “Социјалната заштита во Македонија: Регулатива и практика”, Скопје, 2019, faqe102






Figura 1. Paraqitja institucionale e shërbimeve sociale

Ligji për mbrojtje sociale siguron këto shërbime:

- ***Informimin dhe udhëzimin*** – duke bërë vlerësimin fillestar, duke I informuar qytetarët, për të drejtat dhe shërbimet që mund të sigurohen nga mbrojtja sociale dhe duke I referuar qytetarët në ndonjë institucion tjetër mvarësisht nga kërkesat e tyre.
- ***Ofrimi I ndihmës dhe përkrahjes profesionale – përkrahje dhe mbështetje për menjanimin dhe tejkalimin e problemeve individuale dhe familjare duke ofruar ndihmë përmes, ndërhyrjeve, vlerësimit, planifikimit dhe duke monitoruar gjendjen.***
- ***shërbimet e këshillimit*** -punë këshilluese me qëllim parandalimin dhe lehtësimin e problemeve sociale të individëve dhe familjes, si më poshtë:
 - përgatitja për martesë, për jetë familjare, planifikim familjar, këshillim martesor;
 - këshillimi në divorc, ndërmjetësim familjar në marrëdhëniet e prishura familjare;
 - mbështetje dhe trajnime psiko-sociale, për viktimat dhe ushtruesit e dhunës familjare.
- ***shërbimet në shtëpi*** -shërbime për ofrimin e ndihmës dhe kujdesit në shtëpinë e një personi me kapacitet të reduktuar funksional të përkohshëm ose të përhershëm,⁵⁵ siç janë:

⁵⁵ “Закон за социјална заштита на Република Северна Македонија”, мај, 2019, faqe 20

- kujdes dhe ndihmë në shtëpi dhe
- ndihma personale.
- *shërbimet në komunitet* -parandalimi, kujdesi, mbrojtja, risocializimi, rehabilitimi ose riintegrimi i shfrytëzuesve, në mënyrë që të vazhdojnë të jetojnë në shtëpitë/komunitetin e tyre dhe parandalimi i mbrojtjes jashtë familjes:
 - shërbime të kujdesit ditor,
 - shërbimet e qëndrimit të përkohshëm.
- *shërbimet për mbrojtje jashtë familjare* -sigurohet mbrojtje themelore për akomodim, ndihmë dhe mbështetje nga profesionistët, përkujdesje, ushqim, veshmbathje, mbrojtje shëndetësore, për personat që nuk kanë kushte për të jetë në familjet e tyre,⁵⁶ si më poshtë:
 - të jetuarit me mbështetje,
 - përkujdesje në një familje tjetër,
 - akomodim në një institucion.⁵⁷

4.1.1 Shërbimet sociale dhe papunësia (varfëria)

Sipas të dhënave të Entit shtetëror të statistikës, të vitit 2020, popullsia aktive të cilët kërkojnë punë dhe janë të regjistruar në Entin e punësimit si të papunë, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, numëron 950 858, prej të cilëve të punësuar janë 794 909, ndërsa të

⁵⁶ По ату.

⁵⁷ “Закон за социјална заштита на Република Северна Македонија”, мај, 2019, фаце 20

papunë janë 155 949 persona.⁵⁸ Pra, shkalla e aktivitetit në këtë periudhë është 56.4, shkalla e punësimit 47.2, ndërsa shkalla e papunësisë është 16.4.⁵⁹

Meqenëse ndodhemi në një krizë të madhe ekonomike dhe shoqërore, janë marrë shumë aktivitete dhe hapa të rëndësishëm dhe me vlerë vetëm e vetëm të ulët shkalla e varfërisë, duke i siguruar të papunëve ndihmë të garantuar minimale, por edhe duke i aktivizuar në masat aktive të punësimit dhe duke i dhënë mbështetje me anë të dhënies së kompenzimeve në para për punëtorët të cilët ngelën pa punë për këto dy vitet e fundit, hapa këto të ndërmarra nga ana e shtetit, vetëm e vetëm për t'i siguruar në njëfarë mënyre qytetarët.

Për personat e papunë, përvec që Ligji për mbrojtje sociale iu garanton ndihmën minimale, në anën tjetër bashkëpunimet e institucioneve përkatëse përgadisnin edhe përfshirjen e këtyre personave në aktivitete pune dhe deri në punësimin adekuat të tyre.

Shërbimet e punësimit - Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë Veriore (AP) me qendrat e saj të punësimit (QP) zhvillon dhe zbaton shërbime për të rritur konkurrencën e forcës së punës dhe për të përmbushur nevojat e tregut të punës,⁶⁰ duke aplikuar një qasje individuale me një orientim kah të papunët dhe kah punëdhënësit. AP gjithashtu zbaton aktivitete për promovimin dhe informimin e punëdhënësve për masat dhe shërbimet në dispozicion të tyre.

Në bashkëpunim me punëdhënësit, qendrat e punësimit ndërmjetësojnë në punësimin e punës në përputhje me kërkesat e punëdhënësit, përfshirjen e tyre në programe të caktuara aktive të punësimit, raportimin e vazhdueshëm dhe informacionin mbi të gjitha aktivitetet aktuale dhe programet dhe masat aktive të punësimit, etj. Ftesa dhe informimi që iu bëhet personave të

⁵⁸ https://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstenie_al.aspx?rbtxt=98

⁵⁹ По ату.

⁶⁰ “Оперативниот план за програмите и активните мерки за вработување и услугите во пазарот на труд за 2021”, Скопје, март, 2021

papunë për të marrë pjesë në aktivitetet e punësimit iu bëhet në këtë mënyrë: përmes kontakteve telefonike, me gojë, me shkrim, informimi nëpërmjet ëeb faqeve të Agjencionit të punësimit etj.

Pjesëmarrësit do të përfshihen në shërbimin në Qendrën e Punësimit, bazuar në nevojat dhe interesat e shprehura, këshillimet dhe rekomandimet nga Plani Individual i Punësimit i personit.

Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë Veriore ofron shërbimet e mëposhtme:

Ndihmë për punë - ky shërbim ka të bëjë me përgatitjen e planit individual të punësimit, duke pasur qasje në sigurimin e informacionit për programet dhe aktivitetet aktive të punësimit, për kushtet dhe kërkesat e tregut të punës, vendet ëe lira të punës, masat, këshillat për punësim, dhe shërbimet e siguruara nga AP.

Për më tepër, qendrat e punësimit ofrojnë ndihmë për personat e papunë në përgatitjen e CV-ve, forcimin e aftësive për prezantim të suksesshëm para punëdhënësve në intervistën për punë, përmes informacionit dhe këshillimit, duke marrë edukim për përdorimin e shërbimeve on-line të AP përmes ëeb-portalit të AP, si dhe organizimi i takimeve informuese për të rinjtë dhe të papunët.

Trajnime motivuese - organizohen si trajnime një ditore në qendrat e punësimit, të cilat synojnë informacion më të madh, si dhe motivim për përfshirje në programe aktive dhe masa punësimi. Motivimi i të papunëve për të kërkuar në mënyrë aktive punë do të realizohet përmes një qasje individuale, nëse të papunët shprehin nevojën për mbështetje dhe këshillim shtesë.

Këshilla për orientim profesional dhe karrierë - Shërbimi përfshin aktivitete të ndryshme për informim, këshillim në karrierë për grupe dhe për individ. Personat e papunë mund të përfshihen në disa aktivitete brenda shërbimit, në përputhje me interesat dhe nevojat e tyre.

Udhëzimi profesional dhe këshillimi për karrierë u mundësojnë të papunëve të zhvillojnë kërkimin e punës dhe aftësitë e planifikimit dhe të menaxhojnë zhvillimin e tyre të karrierës, të ndihmojnë në zgjedhjen e një profesioni, trajnimit ose punësimit, si dhe mbështetje shtesë në

vlerësimin e potencialit të tyre të punësimit dhe përafrimin e tyre me nevojat reale të tregut të punës.⁶¹

Këshillimi dhe motivimi për shfrytëzuesit e ndihmës së garantuar minimale – personat që e gëzojnë të drejtën e ndihmës minimale të grantuar do të kenë mundësinë që para se të aktivizohen në aktivitetet e punësimit të mund të gëzojnë të drejtën e Shërbimit të motivimit dhe Këshillimit, duke iu dhënë përkrahje psiko-sociale mbështetje mentoriale për ata persona të cilët veç më janë të përfshirë në trajnime dhe aktivitetet tjera të punësimit, shërbim ky i cili do t’iu ndihmojë që të integrohen në tregun e punës dhe çështjen e punësimit ta marrin më lehtë. Ky shërbim është plotësues i programeve dhe shërbimeve të punësimit, dhe ofron këshillim, mbështetje dhe motivim, si dhe ndjekje të vazhdueshme të përfituesit të ndihmës minimale të garantuar përmes procesit të aktivizimit.

Aktivizimi i përfituesve të Ndhmës së garantuar minimale - Sistemi i reformuar i mbrojtjes sociale parashikon aktivizimin e zgjeruar të përfituesve të ndihmës minimale të garantuar në mënyrë që anëtarët e familjes me aftësi për punë të përfshihen në programet aktive të punësimit dhe masat për të përmirësuar punësimin e tyre.⁶² Kjo nënkupton pjesëmarrjen e detyrueshme të vazhdueshme në trajnime, si dhe pranimin e një oferte për punë. Ndër të tjera, lidhur me këtë drejtim, përfituesit do të kenë mundësinë që të jenë më konkurrense në tregun e punës dhe të përmirësojnë aftësitë e tyre.

Realizimi i aktivizimit të përdoruesve të ndihmës minimale të garantuar kërkon bashkëpunim midis personit të aftë për punë dhe profesionistëve të tjerë nga qendrat për punë sociale si dhe profesionistëve nga qendrat e punësimit të ngarkuara për zbatimin e shërbimeve të punësimit (trajnim motivues, udhëzime në karrierë dhe orientim profesional).

Përmes një qasjeje të integruar për punë, për 1,200 përfitues të NMG, do të përgatiten plane individuale të punësimit me të cilat plane do të aktivizohen dhe përfshihen në masat e punësimit, në shërbimet dhe aktivitetet e punësimit të ofruara nga Plani Operacional për 2021. Sistemi i ri i

⁶¹ Po aty.

⁶² Po aty.

aktivizimit të përdoruesve të NMG do të ofrojë mbështetje intensive psiko-sociale dhe mentoruese dhe trajnime, nga 3 në 12 muaj për të kapërcyer pengesat që parandalojnë pjesëmarrjen e tyre në tregun e punës.⁶³

Ku në këtë aspekt, siç u cek edhe më sipër se ky Plan për vitin 2021 përcakton masat, shërbimet, aktivitetet që kanë të bëjnë me sigurimin e vendeve të reja të punës, dhe në këtë mënyrë edhe rritjen e numrit të papunëve. Pra, kjo vlen për personat të cilët janë të aftë për punë, të rinjtë, personat e papunë në afat të gjatë dhe përfituesit e ndihmës minimale të garantuar nga mbrojtja sociale, si dhe mbështetja për personat e papunë ku ndërprerja e punës së tyre erdhi si rezultat i krizës së shkaktuar nga Coronavirus 19 (nga 11.03.2020).

Ekzistojnë disa programe të cilat ndihmojnë dhe përkrahin të papunët, edhe atë:

- *Programi i vetëpunësimit* - është një mbështetje e krijuar për të papunët për të filluar biznesin e tyre.

Subvencionimi i pagave - Mbështetje për punësimin e personave të cilët vështirë e kanë të punësohen dhe të kyçen në tregun e punës.

Personat e papunë të regjistruar në APRMV (Agjensioni për Punësim i Republikë së Maqedonisë së Veriut), të cilët e kanë më të vështirë të hyjnë në tregun e punës, të tilë si: persona të papunë afatgjatë (mbi 12 muaj të regjistruar, me një avantazh të personave të papunë mbi 5 vjet), të rinj deri në 29 vjeç dhe jo më të vjetër se 50 vjet, persona të papunë puna e të cilëve u ndërpre gjatë Coronavirus COVID -19, persona përfitues të ndihmës minimale të garantuar, persona përfitues të përfitimeve të papunësisë, persona të cilët kishin statusin e jetimëve dhe të pakujdesit prindëror, viktimat e dhunës në familje, persona me aftësi të kufizuar, prindër të vetëm, prindër të 3 ose më shumë fëmijëve, prindër të fëmijëve të rrugës, etj.

- *Punësimi dhe rritja e personave juridikë* - mbështetje në krijimin e vendeve të reja të punës në ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, ndërmarrjet sociale dhe organizatat e shoqërisë civile.⁶⁴

⁶³ Po aty.

⁶⁴ Po aty.

- *Trajnimet* - Trajnim gjatë punës për një punëdhënës të njohur dhe të suksesshëm - Qëllimi është marrja e aftësive të personave të papunë për të kryer detyra pune në përputhje me nevojat e punëdhënësit.

Personat që do të marrin pjesë në trajnim do të marrin një ndihmë mujore në vlerë prej 9,000 denarë, për 3 muaj aq edhe sa zgjat koha e trajnimit, duke përfshirë sigurimin për paaftësi dhe lëndime trupore të shkaktuara nga dëmtimi në punë dhe sëmundjet. Kompensimi për të papunët do të paguhet nga AP. Punëdhënësve do t'iu ndahen ndihmë njëherit prej 15,000 denarë për person të trajnuar pas trajnimit.

- *Trajnim për kualifikime profesionale me kërkesë të punëdhënësve - Trajnim on-line i aftësive me kërkesë të punëdhënësve* - Trajnimi realizohet në bashkëpunim të ngushtë me sektorin privat dhe trajnerët. Njerëzit të cilët do të ndjekin trajnimet on-line lidhur me aftësitë e tyre në lidhje me kërkesat e tjera të reja të tregut të punës, do të kenë qasje edhe në trajnime tjera on-line.
- *Trajnime për shoferë për kategorinë C dhe D* - rritja e punësimit të personave të papunë të regjistruar duke fituar aftësi, në përputhje me kërkesat në profesionin e trafikut dhe nevojat e shprehura për fuqi punëtore në këtë industri dhe punësimin e tyre.
- *Puna praktike* - blerja e njohurive praktike të punës dhe aftësive të nevojshme për të kryer detyra pune në punë të caktuara. Personat që do të përfshihen në praktikë do të marrin ndihmë mujore në vlerë prej 9,000 denarë në muaj (përfshirë sigurimin e aftësisë së kufizuar dhe dëmtimin trupor të shkaktuar nga dëmtimi i punës dhe sëmundja profesionale dhe tatimi mbi të ardhurat personale) për një periudhë deri në 3 muaj.
- *Puna për përfitime komunale* - rritja e punësimit përmes punësimit të personave të papunë, që synojnë ofrimin e shërbimeve sociale dhe shëndetësore në nivel lokal.⁶⁵

⁶⁵ “Оперативниот план за програмите и активните мерки за вработување и услугите во пазарот на труд за 2021”, Скопје, март, 2021.

4.1.2 Shërbimet sociale në familje

Shërbimet e ndihmës profesionale dhe përkrahjes së individit dhe familjes përfshijnë ndihmën dhe përkrahjen për tejkalimin e problemeve individuale dhe familjare përmes vlerësimit, planifikimit, intervenimeve për mbrojtje dhe evakuim, si dhe përcjelljen e gjendjes pas përfundimit të intervenimeve, me qëllim të forcimit të shfrytëzuesve, promovimit të zhvillimit të lirë të tyre,⁶⁶ sigurimit dhe ruajtjen e mirëqenies dhe pavarësisë dhe aftësimin e tyre afatgjatë për tejkalimin e pavarur të problemeve sociale.

Shërbimet e këshillimit përfshijnë punë këshilluese, respektivisht punë në këshillimore, me qëllim të parandalimit, zbutjes dhe tejkalimit të pasojave nga problemet sociale të shkaktuara te individi dhe familja, edhe atë për: përgatitjen për martesë, jetë në familje, prindëri, planifikim të familjes, këshillime martesore/partnere për partnerët me marrëdhënie të përkeqësuar, këshillime gjatë divorcit të martesës, meditacion familjar për familjet me marrëdhënie të përkeqësuar, përkrahje psikosociale për viktimat e dhunës në familje, trajtim psikosocial i kryerësve të dhunës në familje si dhe lloje tjera të specializuara të këshillimeve.⁶⁷

4.1.3 Shërbimet për të rinjtë dhe fëmijët

Shërbimet për fëmijët e rrezikuar në pajtim me ligjin për drejtësi të fëmijëve, sigurohen në qendrat adekuate për fëmijët e rrezikuar për fëmijë.

Shërbimi për qëndrim të përkohshëm iu siguron ndihmë adekuate dhe mbrojtje profesionale, personave që janë në krizë, duke iu mundësuar menjanimin dhe tejkalimin e asaj gjendjeje dhe në këtë mënyrë duke i përkrahur në mbështetje sociale. Pra, *fëmijët të cilët bredhin rrugëve dhe janë pa prindër dhe pa kujdes prindëror, fëmijët viktimat të dhunës familjare, të dhunës mbi bazë gjinie, të keqpërdorimit, të tregëtisë me njerëz, të pastrehët etj.* Ky shërbim fillimisht sigurohet

⁶⁶ “Закон за социјална заштита на Република Северна Македонија”, мај, 2019, faqe 20

⁶⁷ Po aty.

për një periudhë për 3 muaj, por nëse ka raste pak më të rënda dhe të vështira atëherë shërbimi ofrohet edhe për 3 muaj të tjera, e me mundësinë që I njëjti shërbim të zgjasë deri në 1 vit është kur rastet janë të jashtëzakonshme dhe gjendja nuk është përmirësuar dhe tejkaluar

Të jetuarit me mbështetje dhe përkrahje sigurohet me jetesë banesore me përkrahjen e personave profesional ose me ndihmën e tyre duke realizuar aktivitete të përditëshme jetësore. Mbështetja dhe përkrahja është e pjesëshme apo e kohëpaskohëshme, 24 orëshe dhe me ditë (ditore), varësisht nga nevojat e përfituesit. *Këtu përfshihen, fëmijët mbi moshën 14 vjeçare pa prindër dhe pa kujdes prindëror, e deri në përfundim të shkollës së mesme, duke iu dhënë mundësinë e aftësimin për një jetë të pavarur dhe të integruar në shoqëri, personat me aftësi të kufizuara, etj. Në njësitë banesore për jetesë mund të akomodohen më së shumti pesë persona, respektivisht shtatë fëmijë pa prind dhe pa kujdes prindëror.*

Shërbimi i akomodimit të fëmijëve që kanë shkelur rregullat ligjore përfshin edukim dhe arsimim themelorë, ri integrim dhe shërbime për ri socializimin e fëmijëve, nga moshën 14 deri në moshën 18 vjeçare, të cilët referohen dhe organizohen në një institucion përkatës edukativ dhe arsimor, me qëllim të organizimit dhe kalimit të kohës së lirë me shërbime interesante dhe educative në dobi të vet fëmijëve, që i përkasin rregullave të sanksioneve dhe çuarjes apo dërgimit në një institucion adekuat të mbrojtjes themelore, për sa i përket Ligjit për drejtësinë e fëmijëve.

Përkujdesja intervenuese është shërbim i kujdesit afatshkurtër për personat si (fëmijët pa prindër dhe pa kujdes prindëror, viktimat të dhunës në familje, të tregëtisë me njerëz etj), kujdes ky afatshkurtër në familje, i cili kujdes kërkon mbrojtje urgjente, përkrahje dhe nevojë për gjetjen e formave për përkujdesje dhe ndihmë në afat prej jo më shumë se 30 ditëve.

Kujdesi familjar përfshin kujdesin e anëtarëve të tjerë të familjes si për shembull përkujdesje në familjen e gjyshërve, dajës, vëllait, axhës, motrës, tezes ndaj fëmijëve pa prindër apo jetimë dhe pa kujdes prindëror.

Vendosja apo akomodimi në institucione përfshinë përkrahje dhe ndihmë nga persona profesional për 24 orë, përkujdesje, ushqim, sigurim shëndetësor, veshëmbathje, duke i pasur parasysh nevojat e shfrytëzuesit, i cili ka pasur nevojë për mbrojtje jashtëfamiljare duke mos pasur kushte themelore për jetë në familjen e tij . Pra, në këto institucione fëmijëve ju sigurohet edhe qasje deri te arsimimi.

Përkujdesje e specializuar është shërbimi përmes të cilit fëmijëve viktimë të dhunës në familje, fëmijëve që kanë shkelje të ligjit ju sigurohet një përkujdesje e përgjithshme dhe përkrahje deri në tejkalim të problemeve sociale, e cila sigurohet nga ana e përkujdesjeve të cilët kanë kaluar nëpër trajnime të specializuara.⁶⁸

Familja për përkujdesje të përkohëshme apo të kohëpaskohshme siguron përkujdesje të fëmijës në një familje tjetër i cili prind/kujdestarë për shkak të një gjendje adekuate dhe të pamundëshme për tu kujdesur për fëmijën e dërgon atë në një familje për përkujdesje të kohëpaskohëshme. Pas përfundimit të nevojës për përkujdesje të kohëpaskohshme, familja/prindi e vazhdonë kujdesin për fëmijën e tij.

Shërbimet ndaj të rinjëve që i garanton Ligji për mbrojtje sociale janë:

- *Shërbimi për risocializim* sigurohet përmes punës këshilluese, terapisë individuale, familjare dhe grupore, përkrahjes arsimore, shoqërimit, edukimit për zhvillim të aftësive, sportit, rekreacionit, krijimtarisë, përkrahjes për të fituar aftësi për punë dhe aftësi për punësim si dhe shërbime tjera të risocializimit, varësisht nga nevojat e shfrytëzuesve.⁶⁹
- *Jetesa me përkrahje në një shtëpi* e cila siguron përkrahje, ndihmë dhe mbështetje e përgaditje për personat të cilët nuk kanë shtëpitë e tyre ose nuk kanë kushte në shtëpitë e tyre ose kanë qenë në mbrojtje jashtë familjare, duke iu mundësuar jetesë të pavarur dhe riintegrim dhe risocializim, të cilët pas moshës 18 vjeçare pas lëshimit të institucioneve edkuese dhe arsimore jetojnë në shtëpi me përkrahje nga persona adekuat dhe me persona

⁶⁸ “Закон за социјална заштита на Република Северна Македонија”, мај, 2019, nga faqe 20-26

⁶⁹ По ату.

me probleme sociale specifike që kanë nevojë për ndihmë dhe mbështetje për të jetuar në mënyrë të pavarur dhe të lirë.

- ***Shërbimet për mbrojtje jashtë familjare*** sigurohet mbrojtje themelore e cila përfshinë: akomodimin, ndihmën dhe përkrahjen e personave profesional, përkujdesja, ushqimi, veshja, mbrojta shëndetësore, si dhe shërbime tjera varësisht nga lloji i shfrytëzuesve, të cilët nuk kanë kushte për jetë në familjet e tyre ose për arsye tjera ju nevojitet mbrojtje jashtë-familjare.⁷⁰ Në këto shërbime bëjnë pjesë: përkujdesja nga një familje tjetër, vendosja dhe përkujdesja në një institucion për përkujdesje dhe përkrahje dhe të jetuarit me përkrahje.

Megjithatë Plani operacional për kategorinë e të rinjëve, në masat aktive dhe programet e punësimit për vitin 2021 parasheh edhe këto trajnime dhe programe e shërbime në tregun e punës:

- ***Programi i vetëpunësimit*** - është një mbështetje e krijuar për të papunët për të filluar biznesin e tyre. Përfituesit – personat e papunë që i përkasin grupmoshës 29 vjeçare, personat tjerë të papunë të cilët duan biznesin etyre ta zyrtarizojnë, të rinjët të cilët ngelën të papunë për shkak të virusit etj.
- ***Programi “përgaditja për punësim dhe punë”*** – program ky i cili përfshinë disa module atë hyrës, zhvillimor, komunikues, dukja në vendin e punës dhe sjellja e përshtatshme aty ku punon, siguria, puna ekipore dhe menaxhimi, përgjegjësitë dhe të drejtat në vendin e punës dhe njohuritë dhe shkathtësitë financiare. Përfitues do të jenë të rinjtë deri në moshën 29 vjeçare, të cilët janë të papunë që do të fitojnë shërbimin e trajnimit sipas moduleve të lartpërmendura. Ato do të realizohen përmes punëtorive duke përdorur metoda që janë afër të rinjve dhe janë efektive për arsimimin dhe përvetësimin e aftësive të reja në një mënyrë interaktive.
- ***Garancia për të rinjtë*** - në vitin 2021 zbatimi i këtij programi do të vazhdojë të realizohet në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me theks të veçantë te të rinjtë (personat që janë të papunë, të pa përfshirë në arsim ose trajnime). Mbulimi i

⁷⁰ Po aty.

planifikuar i pjesëmarrësve në Garancinë për të rinjtë në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë Veriore është rreth 10,000 të rinj. I suksesshëm programi do të konsiderohet vetëm nëse për një periudh prej 4 muajve, personat që do të përfshihen në këtë program të paktën 30% prej tyre, do të mund të punësohen, të përfshihen dhe të marrin pjesë në proceset arsimore dhe do të integrohen në programe aktive dhe masa punësimi. Garancia për të rinjtë ofron shërbime, punësime, arsimim të vazhdueshëm dhe praktikim të profesioneve të ndryshme.

- **Trajnim i përparuar i aftësive IT** – kjo masë e punësimit synon t'i rishpërblejë aftësitë e të rinjve të papunë deri në 34 vjeç në fushën e teknologjive të informacionit në mënyrë që të rritet aftësia e tyre e konkurrencës dhe integrimi më i shpejtë në tregun e punës.⁷¹ Dhe për këto trajnime kompenzimi që është më i favorshëm do ta marrin trajnerët për punën e tyre. Dhe për këtë trajnim si kompenzimin më të favorshëm do ta marrin trajnerët për punën e tyre.

4.1.4 Shërbimet sociale për të moshuarit

Shërbimi për ofrimin e kujdesit familjar - siguron përkujdesje afatshkurtër për anëtarët e pamundur fizikisht të familjes për shkak të mungesës, pushimit dhe plotësimit të nevojave personale dhe profesionale të anëtarëve tjerë të familjes që kujdesen për ta, e që mund të sigurohet edhe në shtëpinë e shfrytëzuesit.⁷² Përfitues të këtij shërbimi janë familjarët e personit të moshuar dhe të sëmurë e të pamundur për të kryer aktivitetet nga jeta e përditshme pa ndihmën e dikujt tjetër. Qendra për punë sociale është ajo e cila siguron kompenzime për këtë shërbim të kujdesit familjar, për një periudhë prej 15 ditëve për gjatë 1 viti.

Përkujdesja në familje - përfshinë mbrojtje themelore dhe kujdes 24 orësh për personat e moshuar të cilët nuk kanë familje të tyre dhe nuk kanë kushte të jetesës në familjet e tyre.⁷³ Ky

⁷¹ “Оперативниот план за програмите и активните мерки за вработување и услугите во пазарот на труд за 2021”, Скопје, март, 2021

⁷² “Закон за социјална заштита на Република Северна Македонија”, мај, 2019

⁷³ По ату.

lloj i kujdesit mund të jetë 4 lloje, edhe atë: kujdes intervenues, i kohëpaskohëshëm, i përgjithëshëm dhe i specializuar.

Përkujdesja për personat e moshuar, e përgjithshme – ju mundëson përmbushje të nevojave elementare nga jeta e përditshme, edukim, zhvillim, kujdes dhe siguri shëndetësore, e varësisht nga nevojat e duhura të personit të moshuar e i cili është i akomoduar. Përveç mbrojtjes themelore, në këtë shërbim përfshihen edhe ndihmat e specializuara profesionale dhe ndihmat e përkrahjes sociale, ku këtu duhet ta cekim edhe të drejtën e sigurimit social për personat e moshuar – ligj ky i cili hyri në fuqi në maj të vitit 2019, e që u garanton personave të moshuar ndihmë në të holla mujore në 6000 denarë dhe përveç kësaj edhe ndihmë shtesë nga 1000 denarë për 6 muajt e vitit, për mbulim të harxhimeve të ngrohjes.

Shërbimi i akomodimit në institucione për personat e moshur- ku në këto institucione, të moshuarve ju sigurohet: rehabilitim profesional, aktivitete sociale, kulturore dhe rekreative, varësisht nga nevojat e shfrytëzuesve të shërbimeve.⁷⁴

4.1.5 Personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimet që iu ofrohen

Shërbimi i kujdesit dhe ndihmës në shtëpi – iu bëhet personave të cilët nuk janë të aftë të kujdesen për veten e tyre dhe kanë kapacitet të ulët të funksionimit, shërbim ky i cili iu bëhet për një periudhë prej 80 orëve gjatë 1 muaji, duke iu siguruar kujdes dhe ndihmë gjatë aktiviteteve të përditshme, përkrahje me qëllim që përfituesi dalëngadalë të aktivizohet, aftësohet, për vetëkujdesje dhe vetë mirëmbajtje, që në të ardhmen të mund të jetojë i pavarur në shtëpinë e tij ose brenda komunitetit. *Pra këtë shërbim mund ta shfrytëzojnë: personat e verbër që janë plotësisht të verbër, personat me pengesa të rënda dhe pengesa të kombinuara, personat që janë të moshuar dhe që nuk mundën të kujdesen për veten e tyre e që kanë nevojë për kujdes dhe ndihmë nga person tjetër.*

⁷⁴ Po aty.

Shërbime e ofruara në shtëpi - janë shërbime që I ofrohen dhe sigurohen personit që është me kapacitet të ulët të zhvillimit funksional duke I ofruar ndihmë të përkohëshme ose të përherëshme, duke e menjanuar nevojën e mbrojtjes jashtëfamiljare dhe në këtë mënyrë duke ia mundësuar jetesën në shtëpinë e tij.

Shërbimi i asistencës personale - përfshinë ndihmën dhe përkrahjen individuale për personat nga mosha 18 deri në 65 vjeçare, me kapacitet të zvogëluar funksional, me qëllim që të mundësohet një jetë e pavarur, me pjesëmarrje aktive dhe të barabartë në komunitet, si dhe kryerjen e aktiviteteve të përditshme, të cilat një person pa pengesa i kryen zakonisht pa ndonjë përkrahje.⁷⁵ *Ky shërbim përfshinë: mbështetje dhe ndihmë për periudh rreth 80 orë për 1 muaj duke dhënë ndihmë në kryerjen e aktiviteteve të jetës së përditshme, përkrahje në institucionet arsimore, në komunitete tjera, në vendet e punës, në qendrat e rehabilitimit. Shfrytëzuesit e shërbimit janë personat me pengesa më të rënda trupore si dhe personat me verbërim të përhershëm.*

Shërbimet ditore - janë shërbime që kanë të bëjnë me kujdesin ditorë, aktivitete sociale, rekreative, individuale dhe kulturore me qëllim që të fitojnë aftësi punuese, krijuese dhe jetësore. *Si përfitues të këtij shërbimi janë: fëmijët në rrezik, personat e marginalizuar, me pengesa, të moshuarit dhe personat me probleme sociale të posaçme.*

Shërbimi i rehabilitimit dhe riintegrit - të personave që ballafaqohen me probleme sociale dhe shëndetësore, sigurohet përmes përkrahjes psikosociale, punës me terapi, terapisë punuese-okupuese, përkrahjes për të fituar aftësi të punës dhe aftësi për punësim, riintegrim dhe jetë të pavarur.⁷⁶

Shërbimi i akomodimit të personave me pengesa - krahas mbrojtjes themelore, këtyre personave ju sigurohet edhe trajtim dhe rehabilitim, terapi për preokupim me punë, përkrahje për të fituar aftësi të punës si dhe aftësi të punësimit, riintegrim dhe jetë të pavarur, varësisht nga nevojat e shfrytëzuesit.⁷⁷

⁷⁵ Po aty.

⁷⁶ Po aty.

⁷⁷ Shih, “Закон за социјална заштита на Република Северна Македонија”, мај, 2019, nga faqe 20-26

Por, Plani për masat dhe programet aktive të punësimit dhe shërbimet në tregun e punës për vitin 2021, i parasheh edhe këto qëllime:

- ***Përkrahjen e punësimit për personat me aftësi të kufizuara*** – me qëllim të kyçjes në tregun e punës dhe pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara në shërbimet e Planit operacional të punësimit, parashihet që të regjistruarit me aftësi të kufizuara si të papunë, të rritet punësimi i tyre, të kenë mundësinë e të paturit asistent pune, përshtatje në vendin e punës ku edhe ndahen fonde, mundësi për trajnime të ndryshme në punë dhe trajnime për të papunët me aftësi të kufizuara.
- ***Rehabilitimi dhe përfshirja profesionale e personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës*** – ky sistem i shërbimeve do t'iu mundësojë personave me aftësi të kufizuara mbështetje individuale dhe përkrahje maksimale për qëllim të kyçjes së tyre në tregun e punës. Ky program implementohet në kuadër të Projektit të UNDP, MPPS dhe AP. Rehabilitimi profesional si model do të vendoset dhe realizohet në qendrat e ashtuquajtura Qendrat REHA – në qytetin e Shkupit dhe atë të Strumicës, të cilat qendra mundësojnë mbështetje në punësimin dhe rehabilitimin profesional për personat me aftësi të kufizuara. Shërbimet sipas këtij modeli ofrohen në komunitetin e përfituesve, pra në nivel lokal. Modeli mundëson zbatimin e një qasje të orientuar drejt klientit që përqendrohet në potencialet e tij individuale dhe zbatohet brenda një rrjeti lokal të ofruesve të shërbimeve, si: qendrat Reha, qendrat rajonale të AP, organizatat e shoqërisë civile, qendrat e trajnimit, institucionet arsimore, punëdhënësit, etj.

Qendra për Punë Sociale - Menaxhimi i çështjeve në bashkëpunim me AP, sigurimi i mbështetjes në aksesimin e shërbimeve sociale plotësuese (ndihma personale, shërbimet e qendrës ditore, etj.)

Shërbimet e AP (Agjencionit për punësim) - inicimi i një procedure për ofrimin e shërbimeve për rehabilitim profesional për personat me aftësi të kufizuara, miratimi i një plani individual për rehabilitim profesional të përgatitur në qendrën REHA, referim për rehabilitim

profesional në qendrën REHA,⁷⁸ grumbullimi i të dhënave nga ofruesit e shërbimeve të rehabilitimit për kategorinë e këtyre personave.

Shërbimet e qendrave REHA - vlerësimi fillestar funksional i aftësive të punës të personave me aftësi të kufizuara, zhvillimi i një plani individual për rehabilitim profesional, këshillim në karrierë, mbështetje psikosociale dhe mentorim social, përcaktimi i nevojës për ndihmë në punë, mbështetje për aktivitete në arsimin përfshirje në mjedisin e punës dhe në tregun e lirë të punës, vlerësimin e efikasitetit të punës në vendin e punës, sigurimin e trajnimit profesional.⁷⁹

⁷⁸ “Оперативниот план за програма за вклучување и услугите во пазарот на труд за 2021”, Скопје, март, 2021

⁷⁹ По ату.




Figura 2. Përdoruesit e shërbimeve sociale




Figura 3.




Figura 4.

5 Kapitulli pestë

5.1 Analizë e legjislacionit për shërbimet sociale

Në kapitullin e katërt cekta se shërbimet sociale ndahen në dy forma: edhe atë mbrojtja jo-institucionale dhe mbrojtja institucionale, mirëpo që të dyja format nuk janë të definuara aq sa duhet dhe aq sa të kuptohen edhe më mirë, pra kanë nevojë për përshkrim më të detajuar për sa i përket thelbit, natyrës dhe qëllimeve të shërbimeve që i ofrojnë si formë në vete.

Nga ana tjetër, ndarja e shërbimeve sociale në shërbime për mbrojtje jo-institucionale dhe institucionale dhe *klasifikimi i brendëshëm i shërbimeve sociale* në këto dy grupe, ngre pikëpyetje për përshtatshmërinë e përfshirjes së shërbimeve të caktuara sociale në ç’do njëjërën prej këtyre grupeve.

Gjegjësisht, është i diskutueshëm trajtimi i shërbimeve që bazohen në akomodim/strehim afatgjatë si forma jo-institucionale të mbrojtjes (shtëpi në grup të vogël, jetesë e organizuar me mbështetje) sepse bëhet fjalë për shërbime të bazuara në qëndrim 24-orësh të përdoruesit në mjedisin e jashtëm nga familja e tij biologjike.

Për shembull, *e drejta për të jetuar në shtëpi me një grup të vogël ose e drejta e të jetuarit në grup* në LMS përcaktohet për një person i cili nuk ka kushte të përshtatshme jetese në familjen e tij, që nuk ka familje ose për arsye të tjera ka nevojë për strehim në një shtëpi me grupe të vogla,⁸⁰ dhe megjithatë është renditur si një shërbim jo-institucional, ku baza për përdorim është identike me atë të së drejtës për akomodim në një institucion të mbrojtjes institucionale.

Për këto arsye, duke i ikur grupimit të parregullsisive në ndarjen e formave të mbrojtjes sociale në atë institucionale dhe jo institucionale, duke e pasur parasysh edhe përmbajtjen e shërbimeve

⁸⁰ Shih, “Социјалната заштита во Македонија: Регулатива и практика”, Скопје, 2019, faqe 102

që i ofrojnë këto dy forma të mbrojtjes të cilat gjithnjë e më tepër bëjnë pjesë në të dyja format e mbrojtjes sociale, psh përkujdesje prej 24 orëve ofron një shtëpi për të moshuarit, që i përket formës së mbrojtjes institucionale, por edhe pothuajse i njejtë shërbim, pra kujdesi në shtëpi e që i përket formës së mbrojtjes joinstitucionale, megjithatë që të modelet e shërbimeve janë të ngjajshme dhe kanë të njëjtin kuptim, pra përkujdesjen e personave që kanë nevojë.

Dallim ky nga vendet e zhvilluara sepse, atje ndarja apo klasifikimi i shërbimeve sociale nuk bëhet sipas formës së mbrojtjes institucionale dhe jo institucionale, por bëhet sipas, përmbajtjes, natyrës, nevojës dhe llojit të shërbimit.

Më poshtë është një përmbledhje kritike e përkufizimeve për secilin shërbim social në vencanti, sipas klasifikimit të tyre aktual në LMS, domethënë shërbime për mbrojtje jashtëinstitucionale dhe institucionale.

5.1.1 Dispozitat ligjore për shërbimet sociale: një kritik për përkufizimet e shërbimeve të mbrojtjes jo-institucionale

Në ligjin për mbrojtje sociale *e drejta për shërbimin e parë social* përcaktohet si e drejtë e përfituesve të mbrojtjes sociale që përfshin perceptimin e problemit që del nga një gjendje e rrezikut social, duke i mundësuar zgjidhje shfrytëzuesit, shërbime dhe masa të tjera për mbrojtjen e tij, dhe njohuri për rrjetin e institucioneve përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve sociale.⁸¹

Ndihma për një individ nënkupton zbatimin e formave profesionale, këshilluese ose punë këshilluese që i mundëson shfrytëzuesit të fitojë informacion të nevojshëm, trajnim për vendimmarrje të pavarur, ruajtje dhe zhvillim të potencialeve sociale.

E drejta për ndihmë familjare përfshin ndihmë profesionale për anëtarët e familjes që ta tejkalojnë krizën familjare në marrëdhëniet martesore, dhe veçanërisht në marrëdhëniet prind-fëmijë, si dhe fuqizimin e asaj familje për të kryer funksionet e saja në jetën e përditshme.

⁸¹ Po aty.

Që të tre të drejtat ushtrohen në QPS brenda kornizës së profesionalizmit të përditshëm me përdoruesit. Megjithëse secila e drejtë përcaktohet në veçanti si një shërbim, ato janë një tërësi që fragmentohen pa nevojë, e sidomos ndihma për një individ dhe ndihma familjare. Prandaj, shkrirja e këtyre shërbimeve është e nevojshme dhe në këtë mënyrë të përkufizohet në një shërbim të vetëm duke i dhënë përparësi planifikimit, vlerësimit, monitorimit, evaluimit dhe punës profesionale të cilat nuk janë të dukshem në dispozitat ligjore të tanishme. Në të njëjtën kohë, lidhja e shërbimeve: shërbimi i parë social, ndihma për individin dhe ndihmapër familjen, është e papërshtatshme vetëm me format e mbrojtjes jo-institucionale, për arsye se të njëjtat mund të jepen edhe në korniz të formave të mbrojtjes institucionale.

E drejta e ndihmës dhe kujdesit në shtëpi iu mundësohet dhe iu ofrohet personave me aftësi të kufizuara, personave me kapacitet funksional të dobët, personave të moshuar, personave me pengesa të thella, të cilët nuk janë në gjendje të kujdesen për veten e tyre dhe kanë nevojë për ndihmë dhe kujdes për të lehtësuar mënyrën e jetës së tyre edhe kur jetojnë me familjet e tyre.

Pra, shërbimi i ndihmës dhe kujdesit në shtëpi është e kufizuar vetëm për një kategori të caktuar të përfituesve edhe atë vetëm për personat e moshuar dhe ato me aftësi të kufizuara, kjo sipas dispozitave ligjore aktuale. Sipas kësaj them se dispozitat ligjore aktuale nuk janë të mjaftueshme për të përfshirë dhe për të mbuluar edhe një numër më të madh të përfituesve tjerë të mundëshëm, pra mendoj se duhen të jenë më të gjëra me qëllim që për një kohë të caktuar gjatë jetës së tyre duke i pasur prasysh sëmundjet e rënda, të pashërueshme dhe për shkak të rehabilitimit të mund ta gëzojnë shërbimin e ndihmës dhe të kujdesit në shtëpi.

Përkujdesja e përkohëshme dhe përkujdesja ditore si e drejtë sipas Ligjit për mbrojtje sociale kjo formë e ndihmës për individ ose edhe për familje përmbledh në vete dy të drejta të ndryshme, edhe atë: *përkujdesin ditore si e drejtë në qendrat ditore*, që i siguron dhe i mbron personat të cilët nuk kanë aftësi për tu kujdesur për vetën e tyre, si personat me aftësi fizike dhe mendore të kufizuara, personat e moshuar, personat që përdorin drogë dhe keqepërdorin drogën dhe substanca të tjera narkotike, personat që keqepërdorin edhe me alkoolin ose janë në trajtim nga varësia e alkoolit, fëmijët e rrugës, fëmijët me aftësi të kufizuara dhe atë formën tjetër, *të drejtën e përkujdesjes së përkohëshme në qendra ditore*, e cila e drejtë i siguron dhe i mbron këto

kategori të njerëzve: personat që përdorin drogë ose që e keqpërdorin drogën dhe substancat e tjera narkotike, viktimat e dhunës në familje, të pastrehët, dhe viktimat e trafikimit të njerëzve.

Pavarësisht, dallimin midis përkujdesit ditorë dhe të përkohshëm, të dy kategoritë e të drejtave duhet të ridefinohen për t'iu shmangur ngajshmërisë. Për shembull, sipas përkufizimeve aktuale në dispozitat ligjore, e drejta e përkujdesit ditor në qendrën ditore me të njejtën shprehje nënkupton edhe të drejtën për përkujdes ditor dhe për përkujdes të përkohshëm.

Kjo formë e mbrojtjes, sipas dispozitave ligjore për përkujdesje të përkohshme dhe përkujdesje ditore, përmes një liste të mbyllur e kufizon të drejtën e kategorive të përfituesve, njëkohësisht duke e kufizuar edhe mundësinë e zhvillimit që ky shërbim të mund të jetë i kapshëm edhe për kategori të tjera të përfituesve, për të cilët do të ishte e drejtë dhe shërbim shumë i përshtatshëm dhe i nevojshëm.

Sipas dispozitave të LMS, *të jetuarit me grupe të vogla në një shtëpi* si e drejtë e gëzojnë fëmijët me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike, fëmijët pa prindër dhe pa kujdes prindëror, fëmijët me probleme sociale dhe edukative, personat të cilat për shkak se nuk kanë kushte jetese të nevojshme në familjet e tyre ose nuk kanë fare familje dhe ndoshta edhe për ndonjë arsye tjetër iu paraqitet nevoja për akomodim për jetesë me grupe të vogla në një shtëpi, personat me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike, etj.

Lidhur me përkufizimin ligjor të këtij shërbimi, është e nevojshme përsosja, precizimi i shërbimit, sepse nuk tregon se për çfarë shërbimi bëhet fjalë. Në këtë kontekst, forma e mbrojtjes së të jetuarit në një shtëpi me grupe të vogla nuk përcaktohet si lloji i shërbimit në përgjithësi, por vetëm duke numëruar kategoritë e përdoruesve të cilët kanë të drejtë për këtë formë të mbrojtjes. Renditja shtruese për të gjitha llojet e përdoruesve të cilët mund të shfrytëzojnë kujdesin nga ndonjë formë e mbrojtjes ndonjëherë është të papërshtatshme.

Ligjërisht, kjo qasje e shërbimeve në vetëpërcaktimin e saj ofron inicim dhe pjesëmarrje të një kategorie të caktuar të përfituesve si formë e mbrojtjes dhe si mënyrë e garantuar e së drejtës, por në disa raste numërimi i detajuar i të gjitha kategorive të përdoruesve të një të drejte mbart rrezikun e mosveprimit të ndonjë kategorie për të cilën ajo formë e mbrojtjes do të ishte e

përshtatshme, si dhe rrezikun e kufizimit ligjor të mundësive për tu përfshirë ndonjë kategori e re e qytetarëve,⁸² për të cilën do të ketë nevojë për përkujdes përmes kësaj forme të mbrojtjes.

Të jetuarit e organizuar me mbështetje është përcaktuar në Ligjin për mbrojtje sociale si jetesë e pavarur dhe e organizuar në një njësi të strehimit me ndihmë të përhershme ose të përkohshme nga profesionistë, në fakt paraqet një formë të mbrojtjes që është një kombinim i formave të veçanta dhe të ndryshme të mbrojtjes sociale: forma e strehimit të mbrojtur e cila zbatohet kur përdoruesi mund të jetojë i pavarur në një njësi strehimi (kur ka banesën e vet, por ndan një hapësirë të përbashkët në banes me një akses mbrojtës), me ndonjë ndihmë (të rastit) dhe mbështetje nga një mbikëqyrës (i cili mundet të jetojë në banesë ose në afërsi të afërt) dhe nëse është e nevojshme mbështetje shtesë nga profesionistët, dhe forma e jetesës me asistencë e cila zbatohet kur përdoruesi nuk mund të jetojë i pavarur⁸³ (duke pasur një dhomë me kuzhinë dhe tualet, por duke ndarë një hapësirë të përbashkët si dhomën ditore, dhe kuzhinën), ku për të cilin ka nevojë për ndihmë më intensive dhe më të organizuar dhe mbështetje nga profesionistët, madje edhe kujdes në raste të përkeqësimit të situatave.

Në të dy format e mbrojtjes të cilat janë nënloje të një kategorie më të gjerë të shërbimeve sociale të njohura si strehim me mbështetje (supported housing), përdoruesi nuk jeton në shtëpinë e tij, por në një mjedis/objekt i ndërtuar në të cilin jetojnë përdorues që kanë një situatë të ngjashme problematike. Në të njëjtën kohë, është e nevojshme të ridefinohen kategoritë e përdoruesve për të cilat është e përshtatshme kjo formë e mbrojtjes.

5.1.2 Dispozitat ligjore për shërbimet sociale: një kritik për përkufizimet e shërbimeve të mbrojtjes institucionale

Mbrojtja institucionale sipas LMS përfshin të drejtën e trajnimit për veprimtarinë e prodhimit të punës dhe të drejtën e akomodimit/strehimit në një institucion për mbrojtje sociale.

⁸² Shih, “Социјалната заштита во Македонија: Регулатива и практика”, Скопје, 2019, faqe 102-108

⁸³ По ату.

Mbrojtja institucionale sipas kësaj dispozite përfshin vetëm **dy qëllime kryesore**: trajnimin për veprimtarinë e prodhimit të punës dhe akomodimin në një institucion. Qëllimet e tjera që arrihen përmes mbrojtjes institucionale nuk shprehen në dispozitat ligjore, siç janë: risocializimi, riintegrimi, rehabilitimi, evaluimi, trajtimi, etj.

Të drejtën e trajnimit për veprimtarinë e prodhimit të punës, e drejtë e cila përfshinë të referuarit në ndonjë person juridik adekuat ose në ndonjë institucion tjetër të mbrojtjes sociale duke patur mundësinë për plotësimin e nevojave të përditshme, edhe atë riplotësimin e ushqimit dhe akomodimit, riplotësimin e kostove për trajnimet e prodhimit të punës dhe në fundt riplotësimin e kostove për transporte. Si përfitues i kësaj të drejtë janë personat me aftësi të kufizuara nga më të rëndat (mendore dhe fizike).

Si e drejtë kjo kërkon një definim më të gjërë dhe më të arsyeshëm nga aspekti i përfituesve, sepse siç është e definuar vetëm për personat me aftësi të kufizuara të rënda mendore, pra të mund ta përfitojnë edhe kategoritë e tjera të personave në nevojë.

Të drejtën e akomodimit në një institucion të mbrojtjes sociale, përfitues i kësaj të drejtë janë: fëmijët pa prindër apo jetimë dhe pa kujdes prindëror derisa ata të mund vetë të krijojnë mundësi për jetë të pavarur e më së shumti deri në përfundim të shkollës së mesme, fëmijët problematik dhe me sjellje jo normale, të papërshtatshme me rrethin ku jetojnë, fëmijët me probleme sociale dhe arsimore, jo të rregullt dhe të vonuar, fëmijët viktime të dhunës në familje, të pasigurt materialisht, dhe të abuzuar, personat me aftësi të kufizuara fizike që kanë nevojë për përkujdes të përhershëm, personat e moshuar, grua shtatëzënë një muaj para lindjes, prind i vetëm me fëmijë deri në 3 muaj, azil kërkuesit, personat me pengesa të thella mendore që nuk janë në gjendje që vet të kujdesen për veten e tyre dhe për shkak të gjendjes familjare nuk i mundësohet mbrojtje në mënyrë tjetër. Pra këto persona pasiqë nuk kanë kushte të mjaftueshme dhe adekuate për jetesë në familjet e tyre dhe në anën tjetër kanë nevojë për akomodim në institucion përkatës të mbrojtjes sociale, pasiqë ndonjë formë tjetër të mbrojtjes sociale nuk mund të realizojnë.

Në këtë pjesë të dispozitave ligjore nevojiten më shumë ndërhyrje. Ekziston një përsëritje e shpeshtë e emërimit për disa kategori të përfituesve që lidhen me personat me aftësi të

kufizuara, ku në ndonjë vend përdoret terminologjia persona me pengesa e në ndonjë vend tjetër përdoret terminologjia persona me aftësi të kufizuara, renditje kjo e kategorive të përfituesve që e kanë të drejtën e akomodimit dhe të strehimit në institucion të mbrojtjes sociale. Në të njëjtën kohë, akomodimi/strehimi i një gruaje shtatzënë një muaj para lindjes dhe akomodimi i një prindi të vetëm me një fëmijë deri në moshën tre muaj, në një institucion të mbrojtjes sociale, për sa i përket kohëzgjatjes së kujdesit, kjo formë më shumë i përshtatet formës së përkujdesit të përkohshëm (që është formë e mbrojtjes jashtëinstitucionale) sesa mbrojtjes institucionale. Gjithashtu, më shumë njerëz renditen në të njëjtën kategori, të tilla si është rasti me kategorinë: fëmijë me probleme arsimore dhe sociale, të lënë pas dore, të abuzuar dhe materialisht të pasigurt, fëmijë viktimë e dhunës në familje.⁸⁴ Për më tepër, është e paqëndrueshme kategoria e fëmijëve materialisht të pasigurt që të trajtohet si kategori e fëmijëve për të cilët mbrojtja institucionale është formë e përshtatshme.

Gjithashtu i referohet edhe kategorisë së fëmijëve të lënë pas dore, të cilët konsiderohen si fëmijë me pengesa të vogla në plotësimin e nevojave nga prindërit/kujdestarët e tyre, e të cilët mund të mbrohen edhe me masa të tjera mbrojtëse.

Sipas Ligjit për Mbrojtje Sociale, mbrojtja institucionale kryhet nga 10 lloje të mjediseve/institucioneve të strehimit apo të akomodimit: për foshnjat dhe fëmijët e vegjël pa prindër dhe pa kujdes prindëror deri në moshën tre vjeç, fëmijët pa prindër dhe pa kujdes prindëror mbi moshën tre vjeç dhe për të rinjtë, fëmijët dhe të rinjtë me probleme arsimore dhe sociale, fëmijë dhe adoleshentë me vetëvlerësim të ulët, fëmijë dhe të rinjtë me pengesa të rëndë të zhvillimit mendorë, fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara fizike, të moshuarit; të rriturit me aftësi të kufizuara fizike,⁸⁵ personat e rritur me aftësi të kufizuara mendore, dhe azilkërkuesit.

Dispozitat e LMS në lidhje me mbrojtjen institucionale duhet të rishikohen plotësisht nga disa aspekte:

⁸⁴ Shih, “Социјалната заштита во Македонија: Регулатива и практика”, Скопје, 2019, faqe 102-108

⁸⁵ По аty.

- Institucionet e mbrojtjes institucionale përcaktohen më tepër në bazë të kategorisë së përdoruesve që shërbehen, sesa në bazë të llojit, natyrës dhe përmbajtjes së shërbimit që ato ofrojnë.
- Në sqarimin e përmbajtjes së shërbimit nga institucioni dominon përkujdesi dhe kënaqësia bazë e nevojave ekzistenciale të përdoruesve, kurse jo mjaftueshëm janë përmendur elementet e shërbimit që lidhen me punën profesionale, dhe me qëllimin kyç e cila duhet të arrihet nga përdoruesit, ku për të cilin kryehet akomodimi në një institucion (për shembull, terapia, trajtimi, risocializimi, rehabilitimi, riintegrimi, trajnimi për veprimtarinë e prodhimit të punës, etj.)
- Edhe pse shumica e institucioneve kur bëhet fjalë për përcaktimin e shërbimeve të mbrojtjes institucionale në njëfarë mënyurë ofrojnë dispozita të integritit social duke renditur nga: (institucionet e akomodimit apo të strehimit për fëmijët e vegjël, pra foshnjat deri në moshën 3 vjeçare pa prindër dhe pa kujdes prindëror, institucioni për të rinjtë me aftësi të kufizuara fizike, mendore dhe më të rënda, institucioni strehimues për të moshuarit, institucioni për më të rriturit me aftësi të kufizuara fizike), megjithatë këto institucione nuk janë të gjithëanëshme dhe gjithëpërfshirëse, pra kanë nevojën e plotësimit duke mundësuar një qasje optimale, pra gjithëpërfshirëse me qëllim të ofrimit të shërbimeve sociale.

Lidhur me institucionet për mbrojtjen institucionale, LMS përmban dispozita duke lejuar përkujdesin edhe për fëmijët edhe për të rriturit në të njëjtën kohë, në të njëjtin institucion, gjë që është e papranueshme. I tillë është edhe rasti me institucionin për akomodimin e fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara fizike brenda kornizave të të cilit mund të organizohet një Shërbim për të rriturit me aftësi të kufizuara fizike, si dhe me institucionin për akomodimin e fëmijëve dhe të rinjve me paaftësi të rënda mendore, brenda të cilave LMS lejon të rriturit me paaftësi të rënda mendore që në të njëjtin institucion të mund të organizohet qëndrim ditor dhe gjysmë ditor, përkujdesje, veprimtari të prodhimit të punës dhe terapi të punës.⁸⁶

⁸⁶ Po aty.

Ekzistojnë mospërputhje në dispozitat ligjore për përkujdesin e kategorive të ndryshme të përdoruesve, që përballen me situata të ndryshme të jetës, brenda një institucioni. I tillë është rasti me institucionin për akomodimin e të moshuarve në të cilin LMS lejon pranimin dhe strehimin e përkohshëm të të rriturve dhe të moshuarve të cilët për shkak të rrethanave të ndryshme gjenden jashtë vendbanimit, pa kushte jetese ose pa strehim të përhershëm.⁸⁷

5.1.3 Ofruesit e shërbimeve sociale në nivel shtetëror

Në Republikën e Maqedonisë nuk ka asnjë bazë të dhënash të vetme në të cilën evidentohen të gjitha shërbimet sociale që realizohen në territorin e shtetit, pavarësisht nëse shteti, sektori privat, organizatat joqeveritare, individët ose bashkitë, shfaqen si ofrues të shërbimit. Rrjeti i ofruesve të shërbimeve sociale nuk është i zhvilluar mjaftueshëm. Në këtë analizë janë identifikuar gjithsej 370 ofrues të shërbimeve sociale, siç janë: qendrat e këshillimit (34), qendrat e kujdesit ditor (69), kuzhinat popullore (27), institucionet publike për mbrojtje sociale (11), familje për përkujdesje (177), qendra strehimi (7), komunitetet rezidenciale për jetesë të organizuar me mbështetje (4), shtëpi për të moshuarit (29), qendra të ndihmës në shtëpi (2), qendra për shërbime sociale (8) dhe persona fizik (2). (Grafiku nr.3).⁸⁸

⁸⁷ Shih, “Социјалната заштита во Македонија: Регулатива и практика”, Скопје, 2019, faqe 102-108

⁸⁸ Po aty, faqe 109




Figura 5.

Nga gjithsej 370 shërbime sociale, 67 (18.1%) janë të përqendruara në qytetin e Shkupit ndërsa në qytete të tjera të vendit, posaçërisht në qytetet më të vogla, ka një mungesë serioze të shërbimeve sociale. Në të njëjtën kohë, shumica e shërbimeve ekzistuese sociale ofrohen nga sektori shtetëror (286 ose 77.3%), pastaj sektori joqeveritarë (42 ose 11.4%) dhe sektori privat (27 ose 7.3%), dhe shumë pak është pjesëmarrja e komunave (3.5%) dhe personat fizikë (0,5%) si ofrues të shërbimeve sociale. Komunat financojnë plotësisht vetëm një Qendër të Kujdesit Ditor për invalidët (personat me nevoja të veçanta, Valandovë), ku me juridiksionin e të cilit me procesin e decentralizimit u shuan edhe tri shtëpi pleqësh (Kumanovë, Prilep dhe Manastir). Për më tepër, vetëm komuna e Berovës me vetëiniciativë ka hapur Shtëpi pleqësh.

Mbështetja për ofrim të shërbimeve sociale nga komunat vërehet në 8 komuna ku OJQ-GIS ka krijuar qendra për shërbime sociale (të përqendruara kryesisht në informim, referim dhe ndihmë në arritjen e qasjes në të drejtat e mbrojtjes sociale), si dhe në disa komuna të tjera ku

përmes projekteve të UNDP-së me bashkëpunimin komunal është siguruar punësimi i asistentëve arsimorë dhe kujdestarëve në shtëpi.⁸⁹

Pra, mbështetja financiare nga ofruesit e shërbimeve sociale, në mënyrën më të qartë, parasegjithash shoqatat qytetare, vihet re nga qyteti i Shkupit (tabela numër 1).

Tabela 1. Llojet e shërbimeve sociale në RM së Veriut, nëpër qytete dhe në ofruesit e shërbimeve

QPS	Sektori Shtetërorë					Privat	
	K	QD	KP	IMS	FK	QD	SHP
Shkup	1	QDPNV-5 QDFR-2 QVDHF-1	1	6	50	QDPM-1	22

⁸⁹ Shih, “Социјалната заштита во Македонија: Регулатива и практика”, Скопје, 2019, faqe 109-111

		QDP-1					
Kumanovë	1	QDFNV-1	1	/	6	/	/
Kratovë	1	QDPNV-1	1	/	1	/	/
K.Pallankë	1	QDFNV-1	1	/	3	/	/
Shtip	1	QDPNV-1 QDPA-1	1	/	/	/	/
Koçan	1	QVDHF-1	1	/	4	/	/
Vinicë	1	QDPNV-1 QDPM-1	1	/	/	/	/
Dellçevë	1	QDPNV-1	1	/	1	/	/
Berovë	1	QDPNV-1	1	1	/	/	/
Probishtip	1	QDPNV-1	1	/	1	/	/
Strumicë	1	QDPNV-1	1	1	/	/	/
Radovish	1	/	1	/	/	/	1
Gjevgjeli	1	QDPNV-1	1	/	/	/	/
Vallandovë	1	/	1	/	/	/	/
Veles	1	QDPNV-1 QDPM-2	1	/	11	/	/
Sv.Nikollë	1	QDPNV-1 QVDHF-1	1	/	/	/	/
Kavadarc	1	QDPNV-1	1	1	2	QTVD-1	/
Negotinë	1	/	1	1	/	/	1
Manastir	1	QDPNV-1 QVDHF-1	1	1	5	/	1
Prilep	1	QDFNV-1	1	/	20	/	/
Krushevë	1	QDFNV-1 QDPM-1	1	/	26	/	/
D.Hisar	1	/	/	/	/	/	/
Resnjë	1	QDPNV-1	/	/	/	/	/
Ohër	1	/	1	/	3	/	/
Strugë	1	QDPM-1	1	/	/	/	/
Kërçovë	1	QDPNV-1	1	/	7	/	/
Dibër	1	QDPNV-1	1	/	/	/	/
M.Brod	1	QDPNV-1 QDPM-1	1	/	36	/	/
Tetovë	1	QDPNV-1	1	/	/	/	/
Gostivar	1	QDPNV-1	/	/	1	/	/
GJITHSEJ:	30	41	27	11	177	2	25

Spektori joqeveritare	P. fizi k	Komunat
-----------------------	-----------------	---------

QS	QD/KM	JO	K	NSH		QDPNV	SHP	QSHS
QSVDHF-2 QSVTNJ-1	QDFRR-1 QDPNV/A-6 QD/SHNSH-4 QDP-1 QDVD-1 QDPS-1	JOMFP-2 JOMP NV-1	3	2	/	/	/	/
/	QDPPM-1	/	/	/	/	/	1	2
/	/	/	/	/	/	/	/	/
/	KM-1	/	/	/	/	/	/	/
/	/	/	/	/	1	/	/	1
/	/	/	/	/	/	/	/	1
/	/	/	/	/	/	/	/	/
/	/	/	/	/	/	/	/	/
/	/	/	/	/	/	/	1	/
/	/	/	/	/	/	/	/	1
/	QTV D-1 KPPM-1	/	/	/	/	/	/	/
/	QDPPM-1	/	/	/	/	/	/	/
/	QDPNV-1	/	/	/	/	/	/	/
/	/	/	/	/	/	QDPNV-1	/	/
/	KM-1	/	/	/	/	/	/	/
/	/	/	/	/	/	/	/	/
/	/	/	/	/	/	/	/	/
/	QDPPM-1 KM-1	FKPNV-1	/	/	/	/	/	1
/	QDPA-1 KPNV-1	/	/	/	1	/	1	/
/	KPNV-1 KM-1	/	/	/	/	/	1	/
/	/	/	/	/	/	/	/	/
/	/	/	/	/	/	/	/	/
/	/	/	/	/	/	/	/	/
/	QDPPM-1	/	1	/	/	/	/	/
/	QDPPM-1	/	/	/	/	/	/	/
/	/	/	/	/	/	/	/	/
/	/	/	/	/	/	/	/	1
/	/	/	/	/	/	/	/	/
/	/	/	/	/	/	/	/	1
/	/	/	/	/	/	/	/	/
3	29	4	4	2	2	1	4	8

K– Këshilltore QD - Qendër ditore

KP – Kuzhina populloreIMS – Institucion për mbrojtje sociale

FK – Familje kujdestare

SHP – Shtëpi pleqësh

KPM – Klub për persona të moshuar

QS – Qendër strehimore

JO – Jetesë e organizuar

NSH – Ndhmë në shtëpi

QSHS – Qendër për shërbime sociale

QDPNV – Qendër ditore për persona me nevoja të veçanta

QDFNV – Qendër ditore për fëmijë me nevoja të veçanta

QDPPM – Qendër ditore për persona me pengesa mendore

QDPA – Qendër ditore për persona me autizëm

QDPM – Qendër ditore për persona të moshuar

QDFRR – Qendër ditore për fëmijët e rrugës

QDP – Qendër ditore për të pastrehët

QDPS – Qendër ditore për punëtorët seksual

QDVD – Qendër ditore për të mvarurit nga droga

QVTNJ – Qendër për viktimat e tregëtisë me njerëz

QVDHF – Qendër për viktimat e dhunës në familje

KPNV – Klub për persona me nevoja të veçanta

QTMD – Qendër trajtimi për të mvarurit nga droga

KPPM – Klub për persona me pengesa mendore

JOMFP – Jetesë e organizuar me mbështetje për fëmijët pa prindër dhe pa kujdes prindëror

JOMPNOV – Jetesë e organizuar me mbështetje për personat me nevoja të veçanta

QSVTNJ – Qendër strehimore për viktimat e tregtisë me njerëz

QSVDFH – Qendër strehimore për viktimat e dhunës në familje

6 Kapitulli gjashtë

6.1 Konkludime dhe Rekomandime

6.1.1 E ardhmja e procesit të decentralizimit të mbrojtjes sociale

Mbrojtja sociale është një fushë që kërkon përshtatje të vazhdueshme, si për nevojat e përdoruesve ashtu edhe për mundësitë reale të sistemit dhe shtetit. Duke mbështetur dhe përkrahur ndryshimet që rezultojnë pozitivisht dhe ngjallin pluralitet në iniciativat sociale, atëherë themi se kemi të bëjmë me një qeverisje të mirë dhe të shëndetëshme. Politika koherente dhe bashkëpunimi ndër-institucional do të jenë të nevojshëm në të gjithë sektorët përkatës të Qeverisë së shtetit.

Sistemi i mbrojtjes sociale në Republikën e Maqedonisë së Veriut përkundër reformës së tij në periudhën e kaluar, përballet me pengesa dhe dobësi të caktuara që reflektojnë në cilësinë e mbrojtjes. Në krahasim me periudhën e kaluar, Republika e Maqedonisë së Veriut, në fushën e mbrojtjes sociale, kapacitetet e politikbërjes dukshëm i ka forcuar dhe zhvilluar. Proceset e reformave që janë intensifikuar në vitet e fundit dhe të cilat u theksuan më sipër, janë një tregues

i progresit në këtë fushë. Sidoqoftë, ekziston ende nevoja për të rritur kapacitetin politikëbërës për një planifikim efikas, efektiv, të qëndrueshëm dhe transparent.

Nga të gjitha shërbimet dhe politikat që u shtjelluan në këtë temë, si politikë që ishte e përmendur më pak dhe me më pak zhvillim dhe jo shumë përfshirëse ishte politika e decentralizimit, që kishte shumë mangësi në sistemin e mbrojtjes sociale të RM së Veriut. Pra, në nivel kombëtar, Ministria e punës dhe politikës sociale në bashkëpunim me agjencitë e tjera ndërkombëtare financiare dhe zhvillimore ose edhe në mënyrë të pavarur, punon në avancimin e procesit të decentralizimit. Aktivitetet të cilat i ndërmerr Ministria për punë dhe politikë sociale janë të numërta. Bëhet fjalë për projekte të mëdha të cilat në një të ardhme të afërt do të zbatohen ose vetëm se kanë filluar të realizohen nga Ministria e punës dhe politikës sociale me anë të shumë aktiviteteve të cilët lehtësojnë realizimin e procesit të decentralizimit dhe do të menjanojnë problemet lidhur me këtë drejtim.

Nga aspekti i decentralizimit e cekur më sipër u zbatua edhe ***Programi nacional 2011-2021 për zhvillim të mbrojtjes sociale***, dokument me rëndësi të madhe dhe me qëndrim të veçant në përparimin e sistemit të mbrojtjes sociale dhe politikave të cilat Ministria në mënyrë të drejtëpërdrejtë i zbaton, si që është procesi i deinstitutionalizimit, përfshirjes sociale, uljes së varfërisë, punësimi dhe përfshirja në aktivitetet e tregut të punës, etj.

Program ky i cili i ka renditur edhe dobësitë e politikave jo mirë të zbatuara e sidomos me theks të veçantë në institucionin e cili bartë rolin kryesorë në dhënien e shërbimeve profesionale, edhe atë Qendra për punë sociale në punën e vet që bënë, atë të realizimit të së drejtave të ndihmave në para dhe neglizhenca e shërbimeve sociale. Kjo për faktin se shumica e kohës dhe veprimtarive të punëtorëve profesionistë të QPS-së kufizohet nga realizimi i të drejtave për ndihmë financiare, e cila është e ngarkuar me detyra të shumta, kryesisht administrative. Procedurat administrative për ushtrimin e të drejtave janë komplekse, nuk sigurojnë transparencë dhe pjesëmarrje të mjaftueshme të përdoruesve.

Si sfida të rëndësishme dhe kryesore në fushën e mbrojtjes sociale janë më të nevojshme: ndërlidhja dhe forcimi i ndërveprimit ndërmjet institucioneve duke krijuar kështu një rrjet ndërveprimi midis veti, gjithashtu duke krijuar edhe forma moderne dhe të reja të mbrojtjes

institucionale dhe në të njëjtën mënyrë edhe duke i transformuar format e vjetra të shërbimeve ekzistuese, dhe përmirësimi i punës profesionale dhe i cilësisë së shërbimeve të mbrojtjes institucionale. si sfida të rëndësishme në fushën e mbrojtjes sociale.

Ndryshe nga mbrojtja institucionale, mbrojtjes jashtë-institucionale i kushtohet më shumë vëmendje në procesin e reformës së sistemit. Për disa kategori të përfituesve si psh, për personat me aftësi të kufizuara dhe për fëmijët janë prezantuar një numër i shërbimeve të përkujdesit të përkohshëm dhe përkujdesit ditorë.

Shërbimet ekzistuese për këto kategori të qytetarëve nuk janë të mjaftueshme, nga e cila vijnë në përfundim se është nevoja e plotësimit dhe e zhvillimit të më shumë formave të reja të shërbimeve jo institucionale. Për shkak të kësaj, është e nevojshme të punohet në zhvillimin e rrjetit të shërbimeve sociale në nivelin lokal, përmes bashkëpunimit të zgjeruar midis institucioneve përkatëse lokale dhe organizatave, si dhe bazuar në një vlerësim real dhe objektiv të nevojave të popullatës lokale. OJQ-të, organizatat fetare, si dhe sektori privat, duhet të formojnë një rrjet lokal të shërbimeve sociale në përputhje me nevojat e qytetarëve. Në këtë drejtim, partneriteti midis shtetit dhe sektorit privat (fitimprurës dhe jofitimprurës), duhet të zgjerohet më tej dhe të forcohet për ofrimin e shërbimeve të duhura dhe në kohë.

Është e nevojshme të kompletohet zhvillimi i normave, të përmirësohen definicionet për shërbimet sociale prej të cilave kemi përsëritje të tepruar në legjislativ, ku për të njëjtin shërbim dhe për përdoruesit e njëjtë bëhet ofrimi i shërbimeve edhe në formën e mbrojtjes institucionale por edhe në formën e mbrojtjes jashtëinstitucionale, të analizohet legjislacioni dhe shërbimet të ofrohen aty ku duhet. Bashkëpunim më të madh midis sistemit të mbrojtjes dhe arsimit dhe sistemit shëndetësorë, bashkëpunim midis sektorëve të punësimit dhe mbrojtjes sociale me qëllim të përfshirjes së përdoruesve në tregun e punës dhe në punësimin e tyre dhe ç'kyçjen nga pasivizmi si përfitues afatgjatë i përdorimit të së drejtës për ndihmë financiare sociale.⁹⁰ Në këtë

⁹⁰ “Decentralizimi i mbrojtjes sociale në Republikën e Maqedonisë” - gjendja faktike, sfidat dhe mundësitë në nivel lokal – Shkup: Instituti për të drejtat njezore Llundvig Bolltman, 2012, faqe 35-36

mënyrë duke iu mundësuar aktivitetet dhe interes më të madh drejt shërbimeve që ofrohen nëpër shkolla, spitale dhe institucione tjera.

Ministria në bashkëpunim me UNDP-në në vitin 2012 bëri një analizë të hollësishme të kapaciteteve në nivel lokal për ndërmarrjen e shërbimeve sociale. Edhe pse aktivitetet e tilla u zbatuan edhe në suazat e projektit Ljudvig Bolltman - të Institutit për të drejtat njerëzore, por edhe në projektet të tjera, është e nevojshme të thuhet se mungojnë një sërë komponentash ose më mirë të themi se mungon një analizë më e hollësishme e vlerësimit të aktorëve lokal, të komunave, qendrave për punë sociale, të shkollave, biznesi privat, të sektorit shëndetësorë, sektorit joqeveritarë etj. *Ku nëpërmjet kësaj analize të hollësishme siç u përmend edhe më lartë, duke filluar nga komunat – nëpërmjet grupeve punuese dhe sipas ndonjë modeli tjetër të shkruar në formë të ndonjë doracakut, të mundohen që në nivel lokal t'i përcaktojnë grupet e prekshme, dhe t'i informojnë se si mund të arrijnë deri te mbrojtja dhe ndihma që u garantohet me ligj, në cilët institucione mund të trokasin dhe mund të gjejnë përkrahje dhe mbrojtje, cili institucion mund të ju japë zgjidhje për problematikën e krijuar, cilët shërbime ju garantohen dhe mund t'i përfitojnë, etj. Gjegjesisht, do t'i japë mundësi komunës përmes një doracakut të definojë modele për zhvillimin e shërbimeve sociale.* Pra bëhet fjalë për projekt i cili ka rëndësi të madhe për bashkëpunimin e ndërsjelltë të ofruesve të shërbimeve e sidomos të komunave.

Programi kombëtar për zhvillim nga ana tjetër është fokusuar në zbatimin e më shumë formave, aktiviteteve dhe të cilat sollën model të ndarjes së kompenzimeve në para nga Qendra për punë sociale me menaxhim, ofrim dhe ndërlidhje me sistemin e punësimit (Agjensionet për punësim) ku ofrohen modele aktive të punës me vetë shfrytëzuesin në aspekt të përfshirjes së tyre më të madhe në tregun e punës dhe ndarje të shërbimeve sociale ose si që thuhet servise në qendrat për punë sociale, dhe ndërlidhshmëri më e madhe të tyre me vetë komunat dhe me të gjithë aktorët në nivel lokal.⁹¹

Vetë strategjia për zbatimin e këtij procesi, parasheh formimin e Këshillit për parandalim, në të cilin do të marrin pjesë të gjithë aktorët relevant në nivel lokal. Si i dytë do të jetë Këshilli për

⁹¹ “Decentralizimi i mbrojtjes sociale në Republikën e Maqedonisë” - gjendja faktike, sfidat dhe mundësitë në nivel lokal – Shkup: Instituti për të drejtat njerëzore Ljudvig Bolltman, 2012, faqe 35-36

shërbime sociale i cili do të merret me zhvillimin e mëtutjeshëm të shërbimeve sociale, dhe këshilli i tretë do të jetë Këshilli për punësim.⁹²

Për sa u përket Qendrave për punë sociale dhe kapacitetet e tyre aktuale, është e nevojshme zgjedhja e një shtëpie këshilluese e cila do të bëjë një analizë funksionale të të punësuarve në qendrat për punë sociale, me qëllim që të ofrohet një model i ri i organizimit të tyre dhe të njejtit të vendosen në funksion të nevojave të dhënies së shërbimeve sociale, por edhe nga aspekti i zbatimit të të gjitha politikave strategjike të ministrisë.⁹³ Gjithashtu, realizohet edhe procesi i licencimit të cilin programi nacional për zhvillim e aprovoi në vitin 2009 ku i njejtë është në vazhdimësi në aspekt të edukimit të planifikuar të personave profesional, me mungesë të vetme në trajnime edhe më të shumta për këtë fushë për profesionistët apo punonjësit në Qendrat për punë sociale.

Shërbimet sociale, janë forma të krijuara nga ana e Ministrisë në bazë të hulumtimeve për nevojat e qytetarëve. Në këtë mënyrë është krijuar sistemi i jetesës së pavarur për përkrahjen e personave me invaliditet apo me nevoja të veçanta. Janë krijuar të drejta të reja siqë është e drejta e shtesës për personat me aftësi të kufizuara (2019), është rritur shuma e ndihmës, është miratuar ligji për gjuhën e shenjave, përfshirja e personave të shurdhër në të gjitha proceset shoqërore, por edhe përfshirja e personave me nevoja të veçanta në masat aktive të tregut të punës, shtëpitë e vogla grupore etj. Gjithashtu për këtë kategori të përdoruesve për shërbimin në shtëpi, për herë të parë u bashkangjiten edhe dy shërbime tjera: ajo e ndihmës dhe kujdesit në shtëpi dhe asistimit personal.

E rëndësishme është të theksohet se Ministria ka ndijesi për nevojat e qytetarëve, mirëpo e njejtë varet shumë nga mundësitë e saj. (Spasovska, ndihmës udhëheqës i Sektorit për mbrojtje sociale në MPPS). Znj. Todorovska, udhëheqëse e Sektorit për përfshirje sociale në MPPS e theksoi rëndësinë e zbatimit të programit për punë patronike sociale, i cili jep rezultate të mëdha në nivel lokal në tre pilot komuna në Shkup, dhe atë në komunën Qendër, Gazi Babë dhe Gjorçe Petrov. Në program u ofrohet ndihmë e drejtëpërdrejtë kategorive të prekshme në rrugë.⁹⁴ Me anë

⁹² Po aty.

⁹³ Po aty, faqe 37

⁹⁴ Po aty, faqe 38

të së cilit program, puna profesionale dhe shërbimet sociale që do t'i ofrojnë punonjësit social do të jenë më të lehta dhe më të dukshme për këtë kategori të personave dhe në të njëjtën kohë e mundësojnë pjesëmarrjen e tyre në sistemin e mbrojtjes sociale. Në këtë mënyrë programi mundëson që të arrihet parandalimi përmes qasjes multidimensionale e cila krijohet përmes bashkëpunimit vertikal dhe horizontal. Ekzistojnë edhe masa aktive të punësimit në nivel komunal (UNDP së bashku me Ministrinë me anë të së cilit u punësuan një numër i vogël i personave të cilët iu sigurojnë shërbime kategorive të prekshme.

Llogaritet se është e domosdoshme që të bëhet bashkëpunimi multisektorial në procesin e decentralizimit dhe rrjetëzimi dhe inkurajimi i të gjithë aktorëve në nivel lokal. Pra, e domosdoshme është përfshirja e të gjitha faktorëve në nivel të njësisive të vetëqeverisjes lokale ashtu edhe faktorëve në nivel kombëtarë, për tu arritur realizimi i këtij procesi.

Proçesi i decentralizimit të mbrojtjes sociale mvaret edhe nga kapacitetet e komunave që janë të ndryshme, ekzistojnë komuna të ndryshme për nga kapaciteti dhe fuqia në lidhje me ofrimin e ndonjë ndihme ose shërbimi të mirë për vetë qytetarët e atij vendi, pra bëhet fjalë për komunat të cilat nuk kanë infrastrukturë adekuate për ofrim të mjeteve komunale për të qenë në shërbim të qytetarëve. Dhe, për këtë arsye për përcaktim të detyrueshëm të mjeteve për mbrojtje sociale duhet të vihet në funksionim një mekanizëm në kornizat e buxheteve. Nuk don të thotë ajo se mjetet, duhet të jetë vetëm të llojit të ndihmave materiale, por edhe në aspekte të tjera nga sfera e përfshirjes sociale.

Theksohet edhe nevoja për qëndrueshmërinë e shërbimeve të decentralizuara sociale. Duhet seriozisht të mendohet gjatë miratimit të buxheteve të komunave dhe është e nevojshme që procesi të jetë transparent. Ekziston nevoja për diskutime publike për alinetë të cilat nga buxheti ndahen për sektorin qytetarë. Komisionit që punon në vetë buxhetin duhet t'i dorëzohen parashtesa dhe kjo duhet të jetë praktikë në të gjitha komunat. Pasiqë, mjetet vijnë nga vetë qytetarët, është më se e nevojshme që vetë qytetarët me një numër më të madh, të marrin pjesë në krijimin e buxhetit sepse edhe vetë ai buxhet do të jetë për ata. Apelohe për një zgjueshmëri më të madhe të sektorit joqeveritar atëherë kur miratohen buxhetet që edhe ato të marrin një pjesë të kulaçit për realizimin e aktiviteteve të tyre programike. Mirëpo apelohe edhe për

vetëdijësim më të madh të pushtetit lokal, deri tek kryetarët e komunave, deri tek këshilltarët të cilët do ta votojnë buxhetin, që ato të përkrahin diçka e cila është prioritare dhe e nevojshme për komunën (Zlataeva, kryetare e Shoqatës për përkrahje të personave me paralizë celebrale, Qendra ditore për persona me invaliditet, Çashka).⁹⁵

Komuna duhet të dijë se cilat grupe i ka në rrezik, se a ka në vendbanimet e saja, persona të moshuar për të cilët askush nuk kujdeset, a ka persona me invaliditet të cilët askush nuk i ka përfshirë në ndonjë proces, a ka fëmijë pa prindër të cilëve në çfarë do mënyrë duhet t'u ndihmohet. Jo gjithmonë janë të nevojshme shërbimet të llojit të ndonjë institucioni siç është shtëpia për persona të moshuar, çerdhja fëminore etj. Kjo nuk është proces. Shteti më nuk e bën këtë, komunat duhet ta bëjnë. Është i nevojshëm participim aktiv dhe bashkëpunim, dhe të gjithë këtë ta bëjmë në interes dhe për të mirën e qytetarëve (Spasovska, ndihmës udhëheqës i Sektorit për mbrojtje sociale në MPPS).⁹⁶

Si rekomandim kryesor lidhur me procesin e decentralizimit është ai i orientuar kah participimi aktiv i qytetarëve në zbatimin e aktiviteteve nga fusha e mbrojtjes sociale, si dhe vlerësimi dhe investimi në ndërtimet e kapitalit njerëzor dhe shfrytëzimin e fuqive sociale. Në këtë kontekst, profesoresha Maria Donevska nga Instituti për punë sociale dhe politikë sociale e thekson domethënien e 41 maksimës së Platonit “të dishë nuk do të thotë edhe të mundesh”. Kështu që ajo thekson se “në nivel lokal mund të kemi njëqind strategji, t'i shkruajmë, t'i përgatisim, mirëpo nëse nuk e dimë pulsën e popullatës me të cilën punojmë, nëse nuk dimë në cilën mënyrë dhe me cilat shkathtësi duhe t'i mobilizojmë që ato të fillojnë të bashkëpunojnë me ne, nëse nuk i dimë sekretet e disa teknikave të caktuara të bashkëpunimit me popullatën, nëse nuk dimë se rezultatet arrihen vetëm përmes përfshirjes së njerëzve të cilët jetojnë në bashkësinë lokale, nuk do të arrijmë asgjë.”⁹⁷

Prandaj edhe ajo llogarit se “në trajnimin e njerëzve të cilët janë të quajtur fuqi sociale, në të cilën bëjnë pjesë organizatat joqeveritare, duhet të vendoset theks i veçantë mbi shkathtësitë për

⁹⁵ Po aty, faqe 39 – 40

⁹⁶ Po aty, faqe 40

⁹⁷ Po aty, faqe 40 – 41

të punuar me popullatën lokale. Duhet paraprakisht të dihet se popullata lokale pjesërisht din për proceset të cilat duam t'i ndryshojmë në zhvillimin lokal të bashkësisë. Duhet të dijmë se njerëzit në bashkësinë lokale në të cilën jetojmë kanë prioritetet e tyre të caktuara për aktivitetet sociale në bashkësinë lokale. Duhet t'i marrim parasysh edhe fuqitë sociale dhe ato jo gjithmonë janë kështilltarë, aktivistë të institucioneve të caktuara, por mund të jetë edhe ndonjë person më i moshuar i cili ka autoritet të madh në bashkësi. E gjithë kjo është e nevojshme kur punojmë në bashkësinë lokale. Rekomandojmë që më tepër të punojmë në zhvillimin e shkathtësive për atë se si punohet për shkak se pa këto nuk do të arrijmë asgjë edhe pse disa punë duken shumë mirë në letër, mirëpo në praktikë kjo ka të bëjë me sekretin në zanatin dhe profesionin tonë.”

Sa i takon *pjesëmarrjes së biznes sektorit* mund të thuhet se është pika e dobët në këtë proces për shkak se fitohet besimi se tek ato mungon ndjenja e përgjegjësisë shoqërore. Ndoshta ende janë në periudhën e tranzicionit që të mendojnë për diçka më tepër veç profiteve të tyre, të ndajnë diçka edhe për qytetarët. Mirëpo që kjo të ndryshohet, sektori joqeveritar duhet shumë më tepër të punojë në animimin e tyre, që t'u ndihmohet të mendojnë në mënyrë të përgjegjshme shoqërore, gjegjësisht se edhe ato mund të kontribuojnë. Nëse mendohet për disa grupe, biznes sektori nuk është edhe aq i keq, mirëpo kemi nevojë për qasje, komunikim me ta për t'u realizuar njëfëar ndihme e përhershme në para brenda buxhetit në nivel të komunës dhe kjo është e mundshme, mirëpo ato duhet të senzibilizohen për këtë. Jam e mendimit se duhet më tepër të punojmë në këtë aspekt (Simovska, Organizata e grave Pehçevë “OGP”).⁹⁸

Jam e mendimit se në këtë mënyrë duhet të ndërtohet procesi decentralizimit të përfshirjes sociale në komunat dhe se mbrojtja sociale jo gjithmonë kërkon shpenzime të larta. Shpesh i harrojmë kapacitetet bazike të cilat i kemi në disponim në vetë komunat, të cilat janë të vendosura dhe nuk shfrytëzohen në funksion të mbrojtjes ose sigurimit të nevojave bazike të qytetarëve. Ndonjëherë është e mjaftueshme që të animohet një grup i vullnetarve i cili do të ndihmojë në sigurimin e asaj që është nevojë ekzistenciale e nje grupi të caktuar të prekshëm.

⁹⁸ Po aty, faqe 41

6.1.2 Deinstitutionalizimi i shërbimeve sociale

Maqedonia është e obliguar dhe përkushtuar për realizimin e deinstitutionalizimit për shkak se i ka nënshkruar dhe ratifikuar konventat në fjalë të KB dhe Konventën evropiane për të drejtat e njeriut.⁹⁹ Maqedonia është e përkushtuar për aderim në BE dhe ndërmerr masa aktive në përputhje me parimet dhe praktikën e Unionit. Përveç *Strategjisë nacionale për deinstitutionalizimin e Republikës së Maqedonisë, Timjanik, 2018–2027*, Maqedonia ka miratuar edhe strategji tjera relevante dhe në mbështetje të deinstitutionalizimit, siç janë: *Strategjia nacionale për barazimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara 2010-2018 (e reviduar)*, *Strategjia nacionale për barazi dhe mos-diskriminim 2016-2020*, *Strategjia për politikë demografike 2015-2024*, *Strategjia nacionale për punësim 2016-2020*, *Strategjia nacionale për persona të moshuar 2010-2020*, *Strategjia nacionale për uljen e varfërisë,¹⁰⁰ dhe përfshirjen sociale në Republikën e Maqedonisë 2010-2020 (e reviduar) si dhe Programin 2020 për punësim dhe reformë sociale.*

Përvojat nga vendet ku është zbatuar deinstitutionalizimi tregojnë se duhet kohë që të transformohen të gjitha institucionet, por edhe se procesi duhet të zbatohet shpejtë dhe me vendosmëri. E cila punë nënkupton jo vetëm vendosje të shërbimeve në bashkësi por edhe transformim efikas dhe aktiv si dhe mbyllje të institucioneve.

Për deinstitutionalizim të shpejtë, efikas dhe të suksesshëm, nevojitet vullnet i fortë politik afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë si dhe udhëheqje aktiv, inkluziv dhe demokratik i institucioneve. Nevojiten edhe:

- (ri)trajnim për aplikuesit e shërbimeve dhe të kuadrit në përgjithësi;
- metoda moderne, të reja dhe organizuese;
- pjesëmarrje e shoqërisë civile dhe koalicion të fortë në favor të deinstitutionalizimit¹⁰¹ edhe atë nga të gjithë faktorët;
- përfshirje të shfrytëzuesve;

⁹⁹ “Strategji nacionale për deinstitutionalizimin e Republikës së Maqedonisë, Timjanik”, 2018- 2027

¹⁰⁰ Po aty.

¹⁰¹ Po aty.

- përkushtim ndaj të drejtave të shfrytëzuesve dhe përforsimin e shfrytëzuesve të shërbimeve;
- koordinim të aktiviteteve;
- sisteme të mira për vëzhgim (mbikëqyrje) dhe procese vendimmarrëse të bazuara në vlerësim dhe hulumtim.

Si rrjedhojë, nga aspekti i të drejtave, kujdesi në bashkësi nuk do të thotë vetëm qasje në shërbimet e ofruara në bashkësi dhe siguri, që duhet të thuhet se kujdesi në bashkësi, para se gjithash nënkupton edhe qasje dhe mbështetje për pjesëmarrje në të gjitha çështjet sociale dhe aktivitetet e rëndësishme për vetë jetën e njeriut, pra me një fjalë jetë të plotë sociale.

Jeta e pavarur është koncept kyç dhe synimi kryesor i deinstitutionalizimit. “Jetesa e pavarur apo jeta e pavarur do të thotë se personave me aftësi të kufizuara u sigurohen të gjitha mjetet e nevojshme që u mundësojnë të realizojnë përzgjedhjen e tyre dhe kontrollin ndaj jetës së tyre, si dhe t’i marrin vendimet lidhur me jetën e tyre. Pavarësia personale dhe vendimmarrja e pavarur është thelbësore për jetesë të pavarur, përfshirë qasje deri tek transporti, informacionet, komunikimin dhe asistencën personale, vendin e jetesës, rutinë ditore, shprehitë, punësim me dinjitet, lidhje personale, veshje, ushqim, higjienë dhe kujdes shëndetësorë, të drejta riprodhuese fetare, kulturore dhe seksuale. Këto aktiviteteve lidhen me zhvillimin e identitetit personal dhe personit: ku jetojmë, me kë, çfarë hamë, a duam të flemë deri në orët e vona apo të shtrihemi vonë në mbrëmje, të jemi brenda apo jashtë, të kemi çarçaf dhe qiri në tavolinë, të kemi kafshë përkëdhelëse apo të dëgjojmë muzikë. Veprimet e këtilla e bëjnë atë që jemi”.

Jetesa e pavarur nuk duhet të kuptohet gabimisht si mungesë e varësisë nga mbështetja e tjetrit; kjo nënkupton krejtësisht të kundërtën- nevoja për mbështetje për jetesë të vetme dhe për kontroll ndaj mbështetjes së nevojshme. Edhe pse ka të bëjë me të jetuarit në bashkësi një jetë të pavarur, kjo nënkupton “jetesë e pavarur me mbështetje”.

Kujdes më me rëndësi të veçantë ndaj personit – është mënyra më e kapshme dhe e nevojshme për të arritur jetesën e pavarur. Një prej synimeve kryesore të deinstitutionalizimit është që të vendosen shërbime sipas nevojave të çdo individi, që me to të ndërrohet përgjigjja totale dhe e standardizuar e institucioneve: „*Tradicionalisht, mënyra për t’iu dhënë mbështetje*

dikujt, kjo bëhet duke u fokusuar shërbimet ekzistuese. Në vend të kësaj, në qendër duhet të jenë personi dhe fëmija ndërsa mbështetja duhet të bëhet sipas situatës së tyre individuale dhe të ofroj përzgjedhje personale. E cila nënkupton se përfituesit e shërbimeve që do t'iu ofrohen, patjetër të përfshihen në mënyrë aktive në përzgjedhjen dhe formimin e atyre shërbimeve që do t'iu ofrohen.”

Shtëpitë në grupe – kanë një rol të veçantë në procesin e deinstitutionalizimit dhe janë të domosdoshme. Megjithatë , shtëpitë në grupe nuk duhet të shifen si “zgjdhje standarde që i respekton të gjitha dispozitat e të drejtës për jetesë në bashkësi”. Është e nevojshme që të bëhet një përpjekje e duhur me qëllim të tejkalimit dhe menjanimin të pengesave që mund të shkaktohen në rrethin ku do të jenë shtëpitë në grupe, gjithashtu të sigurohet dhe të zhvillohet banim i duhur, i kapshëm dhe një jetesë më mbështetje si dhe mundësi të tjera për kujdes të ngrohtë familjarë për fëmijët.

Qendrat ditore për përkujdesje të personave të moshuar – vende të cilat kanë rëndësi të madhe për moshën e disa individëve, të cilëve iu ofrojnë jetë më të lirë dhe më optimiste duke iu ofruar përkrahje, këshilla, trajnime interesante për t'i zhvilluar shkathtësitë e tyre për një jetë të pavarur, aktivitete të ndryshme kulturore dhe sociale, kujdes shëndetësorë, kujdes personal dhe ushqime. Qendrat ditore të këtilla, janë zgjidhje efikase në luftën kundër vetmisë dhe izolimit.

Kujdesi afatgjatë është pikëpamje relativisht e re e organizimit dhe shërbime financiare për persona të cilët kanë nevojë për kujdes të vazhdueshëm, gjithëpërfshirës, të organizuar dhe të koordinuar.¹⁰² Kjo nxjerr në pah të drejtën për jetesë në bashkësi, promovon qasjen e jetesës së pavarur dhe siguron dinjitetin e njerëzve me nevoja afatgjate për mbështetje dhe asistim. Kujdesi afatgjatë nxjerr në plan të parë prioritetet personale të shfrytëzuesve dhe paraqet bazë për sigurim të integruar, të përhershëm dhe të koordinuar të shërbimeve sociale, shëndetësore dhe arsimore.

6.1.3 Veçoritë elementare të procesit të deinstitutionalizimit

¹⁰² “Strategji nacionale për deinstitutionalizimin e Republikës së Maqedonisë, Timjanik”, 2018- 2027

Është e nevojshme që procesi i deinstitutionalizimit i udhëhequr nga Qeveria të zbatohet me një përkushtim të madhë. Do të nevojitet dialog me të gjithë faktorët e përfshirë, por shfrytëzuesi patjetër të jetë në plan të parë. Prosesi duhet ta ketë parasysh realitetin në terren dhe të bazohet në të dhëna empirike dhe përvoja lokale.

Pika fillestare është që të vërtetohen edhe resurset e kapshme dhe njëkohësisht të punohet në transformimin dhe mbylljen e institucioneve rezidenciale të vendosjes së shërbimeve të reja në bashkësi. Patjetër duhet të vendoset baza e domosdoshme drejtuese (menaxhuese), ligjore dhe materiale për zbatimin e deinstitutionalizimit. Duke e pasur parasysh mundësimin e arritjes së fleksibilitetit, korrigjimet e aktiviteteve dhe mënyrën se si do të arrihen synimet është e nevojshme që të krijohen mekanizma vëzhgues për revizionet sistemore periodike.

Deinstitutionalizimi i shtëpive për persona të moshuar nuk mundet kryesisht të bazohet në shpërngulje; nevojitet të sigurohen shërbime cilësore sociale në bashkësi edhe për personat e moshuar.¹⁰³ Sidomos është e domosdoshme të krijohen shërbime të reja që do t'u mundësojnë të qëndrojnë në shtëpi dhe të jetojnë jetë dinjitoze dhe jetë të integruar sociale (si për shembull, banim të mbrojtur, kujdes intensiv mjekësorë në kushte shtëpiake, kujdes “online” dhe me komandë, aktivitete mes gjeneratave, ndihmë e përbashkët dhe joformale, projekte në bashkësi etj).

Institucionet rezidenciale për fëmijë dhe të rinj - është më e përshtatshme të zëvendësohen me akomodime në familje me qëllim të mbështetjes më të madhe dhe intensive të fëmijëve dhe të rinjëve. Duhet të vendosen mekanizma të mbështetjes intensive profesionale dhe ndihmë për përfshirjen e fëmijëve dhe të rinjve në to. Sidomos duhet t'u mundësohet fëmijëve të jetojnë me moshatarët e tyre, të shkojnë rregullisht në shkollë dhe të marrin pjesë në aktivitete rekreative në bashkësi.

6.1.4 Synimet kryesore të deinstitutionalizimit

¹⁰³ Po aty.

Shtyllat elementare-synimet kryesore	1) transformimi dhe mbyllja e institucioneve	2) lëvizja dhe bartja e përfituesve në bashkësi	3) shërbime të sigurta në bashkësi	4) pengim dhe moslejtim të institucionalizimit
Masat e marra nga politikat që e mbështesin dhe e ndihmojnë transformimin	1) politika të koordinuara, të vendosura, 2) ndryshime në legjisllacion, 3) ndryshime në financim: ridestinin të mjeteve nga institucionet drejt shërbimeve/detyrave në bashkësi, 4) inkluzion social dhe mundësim të sistemeve të kujdesit social, kujdesit shëndetësorë dhe arsimorë, 5) banim i siguar social, 6) metoda të reja dhe qasje të reja, 7) zhvillim dhe standarde të reja të cilësisë së shërbimeve në bashkësi, 8) përforsim dhe trajnime të kuadrit, 9) rritje të vetëdijes dhe përfaqësimit, 10) shërbime që udhëhiqen nga shfrytëzuesit, 11) pilotim të nismave dhe metodologjive të reja			

Si shtylla kryesore të transformimit të institucioneve dhe masat e politikave që e mundësojnë më lehtë procesin e deinstitutionalizimit, janë:

- Duhet të krijohet kornizë e reformuar ligjvënëse dhe sistem, të lehtësohet riorganizimi si dhe të ridestinohen resurset. Do të nevojiten qasje dhe metodologji të reja për sigurimin e shërbimeve ndërsa do të duhet të vendosen edhe shërbime të reja. Sistemi dhe shërbimet duhet t'i përmbushin nevojat dhe dëshirat e shfrytëzuesve dhe të sigurojnë përgjigje përkatëse ndaj nevojave të tyre personale dhe individuale si dhe t'ua lehtësojnë dhe t'i mbështesin shfrytëzuesit individual që në realizimin e synimeve të tyre të jetës.
- Pas realizimit të këtij procesi, do të sigurohet akomodim me mbështetje dhe kujdes (I kombinuar), do të sigurohet inkuadrim në bashkësi nëpërmjet aktiviteteve të duhura dhe të nevojshme që do të jenë pjesë e shërbimeve ditore dhe shërbime personale që sigurojnë kujdes të personalizuar sipas nevojave të shfrytëzuesve të shërbimit, e gjithë kjo si shërbime rezidenciale. Mënyra kryesore e sigurimit të akomodimit do të jetë banimi i mbrojtur (me jetesë individuale) dhe kujdes në suazat e familjes- kryefamiljar (kujdes për fëmijë) dhe në dimensione më të vogla, banim dhe ushqim me elemente të kujdesit për të moshuarit. Do të nevojitet kapacitet i caktuar për akomodim afatshkurtër në shtëpi grupore kur bëhet fjalë për situata krizash si dhe për kujdes tranzicioni për shkak të shpërnguljes nga institucionet dhe, më vonë, për trajnim dhe rehabilitim, si dhe numër i

vogël i shtëpive grupore (për shembull qindra vende, përafërsisht aq sa është numri aktual). Klubet sociale dhe qendrat ditore do të jenë për aktivitetet ditore të cilat do të mundësojnë shërbime për fëmijë dhe për të moshuar, por do të bëhet e mundëshme edhe angazhimi punues i përfituesve, nëpërmjet ndërrmarjeve të punës sociale dhe bashkëpunuese. Shërbimet personale do të sigurohen në formë të asistencës personale, asistencë familjare (të mbështetura nga profesionist), përmes pakove të personalizuara për kujdes dhe kujdes të koordinuar, kujdes në shtëpi i kombinuar me kujdes nga një distancë apo largësi, punësim me përkrahje osë të mbështetur dhe shërbime tjera me intensitet të ulët (shoqërimi si formë e mbështetjes e njohur si asistencë personale, etj). Shërbime këto të cilat do të shoqërohen dhe përmbushen me out reach – qendra për punë në bashkësi, me projekte makro në bashkësi, me përfaqësim, këshillim dhe me aktivitete tjera që nxisin dhe fuqizojnë solidaritetin dhe inkluzionin në bashkësi.

Tabela 2. Vlerësimi i numrit të personave me nevojë për mbështetje dhe shërbime

Grupi	Numri i shfrytëzuesve në kujdes institucional	Numri i shfrytëzuesve të regjistruar	Vlerësimi i numri të njerëzve me vështirësi, pa kontakt me shërbimet	Vlerësimi i numri të njerëzve me nevoja
Fëmijë me aftësi të kufizuara	42	7.346	700	8.000
Fëmijë me vështirësi sociale	200	8.176	800	9.000
Fëmijë pa kujdes prindëror	146	1.034		
Fëmijë me vështirësi sociale dhe arsimore	54	5.132		
Fëmijë në konflikt me ligjin		2.010		
Të moshuar me aftësi të kufizuara	356+122	19.202	6.400-9.600	21.000
Të moshuar me vështirësi shumëvjeçare me shëndet mendor	650	2.000-3.000	1.000	4.000
Persona të shtyrë në moshë	988	11.544	42.600	54.400

Gjithsej	2.358	57.202	-	96.400
----------	-------	--------	---	--------

Nga tabela më lartë mund të shihet qartë kontakti i fëmijëve me aftësi të kufizuara me shërbimet sociale është përafërsisht 10% nga numri i përgjithshëm i fëmijëve që janë përfitues apo shfrytëzues të shërbimeve të regjistruara.

Vlerësohet se rreth 6400 deri 9600 persona me aftësi të kufizuara të moshës 18-65 nuk kanë kontakt me shërbimet sociale (më saktë, mes 1/3 dhe 1/2 nga numri i personave të regjistruar).

Nuk ka të dhëna të kapshme për shfrytëzuesit me probleme afatgjate në shëndetin mendor. Vlerësimi i përafërt është se janë rreth 3000 persona me probleme afatgjate në shëndetin mendor në kontakt me shërbimet sociale.¹⁰⁴ Të paktën një çerek nuk është në kontakt me shërbimet, por kanë nevojë për ndihmë më ndryshe dhe mbështetje sesa thjesht trajtim mjekësor.

Nga hulumtimet e bëra, vihet re se mesatarisht 17 % e personave mbi moshën 65 vjeç kanë më shumë nevojë për shërbime dhe mbështetje. Pra nga e cila rrjedh se në Republikën e Maqedonisë së Veriut, nevoja për shërbime sociale nga personat mbi moshën 65 vjeç arrin në 54.400, nga gjithsej 271.986 persona të moshës mbi 65 vjeçe.

6.1.5 Shërbimet sociale në bashkësi: efektet dhe mungesat

Deinstitucionalizimi është udhërefyës që shpjen në politika të kapshme dhe relevante në shumë fusha, si ajo e banimit, arsimit, shëndetësisë, kujdesit social etj. Dispozitat ekzistuese ligjore sigurojnë bazë juridike për zhvillimin e më shumë shërbimeve të reja në bashkësi. Si mekanizma kryesorë që paraqesin problem në zbatimin e ligjeve dhe të politikave janë: mjetet të përshkruara si harduer dhe procedurat, metodat, shkathtësitë dhe njohuritë të përshkruara si softuer, të cilat janë të mangëta dhe jo mjaftueshëm të zhvilluara në mënyrë që të kalojnë drejt shërbimeve në bashkësi.

¹⁰⁴ “Strategji nacionale për deinstitucionalizimin e Republikës së Maqedonisë, Timjanik”, 2018- 2027

Sistemi aktual i financimit të shërbimeve është i centralizuar dhe bazohet në sigurimin e sigurisë financiare të dhënësve të shërbimeve. Nëpërmjet këtij sistemi të financimit të shërbimeve, shfrytëzuesve nuk u mundësohet që nëpërmjet financimit public direkt ose të drejtëpërdrejtë të jenë blerës të shërbimeve, apo nëpërmjet ndonjë mënyre tjetër që do të mundësonte “paratë t’i ndjekin shfrytëzuesit e shërbimeve”. Për këtë shkak, sistemi aktual kultivon përgjigje të prerë, i kufizon të drejtat dhe mundësitë e shfrytëzuesve dhe vështirëson zbatimin dhe reformën e sistemit.

Në menaxhimin dhe organizimin me shërbimet ekzistojnë mangësi të vogla në shkathtësitë e shërbimeve institucionale, por edhe që ofrohen në bashkësi, ku ju mungon sipermarrësi në inovacion dhe vendimarrja autonome, kjo si rrjedhojë e kufizimeve politike ose për shkak të shprehive të tanishme.

Sipas hulumtimeve rreth deinstitutionalizimit, vijnë në shprehje disa njohuri konceptuale dhe disa shkathtësi për këtë proces. Ka mungesa të caktuara në arsimin akademik në trajnimin praktik lidhur me rëndësinë e shfrytëzuesve, përforcimin e tyre, metodat dhe teknikat për personalizimin e sigurimit të shërbimeve (menaxhim me kujdes personal, jetesë të pavarur, asistencë personale, përfaqësim etj). Mbështetja ekzistuese dhe vëzhgimi nuk janë mjaftueshëm proaktiv dhe nxitës. Ekziston monitorim, por ai ndonjëherë realizohet në mënyrë shumë formale dhe nuk ka ndonjë efekt zhvillimor.

Spektori civil në shumë gjëra është bartësi dhe fuqia kryesore e ndryshimeve. Megjithatë, roli i OQ në masë të madhe varet nga mbështetja e agjencive ndërkombëtare si dhe nga vendimet qeveritare. Nga ana tjetër, mes faktorëve dhe palëve të përfshira ekziston optimizëm, entuziazëm dhe vullnet i mirë që të realizohet deinstitutionalizimi.

Ekziston rrjet i renditur i barabartë i qendrave për punë sociale në botë, që paraqet resurs të rëndësishëm të shërbimeve në bashkësi. Në këtë drejtim, duhet të tejkalohet orientimi byrokratik dhe i kujdestarisë i qendrave, ku shkathtësitë dhe mënyra e punës së punonjësve mund të zhvillohen dhe modernizohen që të aftësohen për të koordinuar (menaxhuar) me shërbime të personalizuar në të ardhmen.

Disa nga shërbimet e reja në bashkësi tani më funksionojnë dhe janë të zhvilluara mirë, pra duke i pasur parasysh qendrat ditore dhe shtëpitë në grupe si ndër shërbimet më me funksion në bashkësi. Ato janë të shpërndara në mënyrë të barabartë nëpër vend. Disa kanë vendosur prag shumë të lartë (kërkojnë plotësimin e kushteve për t'u bërë shfrytëzues ose sigurojnë shërbime vetëm për individë me nivel më të lartë të kapacitetit) ndërsa u mungojnë shkathtësi dhe resurse që të mbështesin persona me aftësi të kufizuara me mbështetje të lartë intensive.¹⁰⁵

Qendrat ditore deri më tani kanë pasur rol të rëndësishëm në procesin e deinstitucionalizimit ndërsa do të kenë rol të rëndësishëm edhe në të ardhmen. Në kombinim me familjet përkujdesëse dhe shtëpitë grupore, ato në shumë raste sigurojnë mundësi për shpërngulje përkatëse nga institucioni dhe janë mbështetje e domosdoshme për shumë shfrytëzues në bashkësi, duke parandaluar institucionalizimin e tyre.

Në vend janë gjithsej 61 qendra ditore, përfshirë edhe klubet sociale dhe qendrat në bashkësi për shëndet mendor. Më shumë se gjysma (34) u dedikohen fëmijëve; tetë janë për persona në moshë të shtyrë ndërsa 19 për të moshuar. Ku, shumica e qendrave ditore publike për fëmijë në fakt janë në shërbim edhe për personat e moshuar, dhe mund të konsiderohen si qendra ditore edhe për fëmijë edhe për të moshuar. Një pjesë e madhe e qendrave ditore përfshijnë njerëz me pengesa intelektuale (46), prej të cilave dy dedikohen për persona me autizëm ndërsa dy vetëm për këtë grup. Katër qendra dedikohen për persona me vështirësi afatgjate në shëndetin mendor ndërsa një qendër ditore është për fëmijët nga rruga. Shumica e qendrave ditore janë publike (40). Shumica e qendrave publike ditore që dedikohen për fëmijë (29) janë përgjegjësi e MPPS, shtatë qendra ditore për persona të moshuar janë përgjegjësi e autoriteteve lokale ndërsa katër qendra për shëndet mendor janë përgjegjësi e Ministrisë së Shëndetësisë. Qendra nën kompetencë të MPPS-së zakonisht janë njësi organizative të qendrave lokale për punë sociale, me disa përjashtime (si për shembull, qendra ditore në institucionin rezidencial Fushë Topanë). Përgjegjësi e përbashkët e OQ-së dhe autoriteteve lokale janë që të dy qendrat ditore, ajo për fëmijë dhe ajo tjetra për personat e moshuar.

¹⁰⁵ Po aty.

Qendrat tjera ditore (20), përfshirë edhe gjashtë klube sociale, i udhëheqin OQ. Ato kryesisht janë për të moshuar ndërsa në pesë raste për fëmijë, por që punojnë me grupe të veçantë të fëmijëve (katër për autizëm, një për fëmijë nga rruga).

Shtëpitë grupore janë të vendosura në procesin e shpërnguljes së shfrytëzuesve nga institucionet. Në të përfshihen ish shfrytëzues të institucioneve, por edhe disa persona që kanë jetuar në familjen e tyre ndërsa kanë qenë në rrezik për akomodim në institucion. Terminologjia për këtë formë të banimit në legjislacionin e Maqedonisë është “shërbim për jetesë të organizuar me mbështetje”.

Shtëpitë në grupe apo grupore kanë qenë shumë efikase për shpërngulje në të kaluarën. Ato ofrojnë mundësi për veprim të shpejtë dhe më lehtë organizohen për dallim nga shërbimet personale. Por, ekzistojnë ngjashmëri të caktuara në kujdesin institucional lidhur me përgjegjësinë dhe modelin e organizimit, lidhur me atë se të gjitha nevojat e shfrytëzuesve sigurohen nga një dhënës i shërbimeve, në të njëjtën mënyrë, nën një kulm. Dhënësi i shërbimit, edhe pse nuk është i vetëm, është subjekti kryesor përgjegjës për mirëqenien dhe sigurinë e shfrytëzuesve ndërsa struktura e shpenzimeve është e ngjashme. Nga ana tjetër, për dallim nga institucioneve, ato sigurojnë shërbime në bashkësi, në ambient më të mirë dhe në atmosferë familjare, me më shumë personalizim dhe përzgjedhje. Menaxhimi i mirë me këto shërbime sjell deri në përforcimin e shfrytëzuesve. Nëse resurset mjaftojnë, shtëpitë grupore janë zgjidhje e mirë për *tranzicion* në bashkësi. Në Maqedoni, përvojat me shtëpi grupore në metodat e punës dhe menaxhimit, në krahasim me objekte të ngjashme në vendet tjera, janë të mira. Por, resurset për shtëpi grupore deri më tani nuk mjaftojnë për shpërnguljen e njerëzve me nevojë për mbështetje të lartë intensive.

Janë dy OQ që paraqiten si dhënës të këtyre llojeve të shërbimeve- SOS “Detsko Selo”, për fëmijë pa kujdes prindëror dhe “Poraka Negotino” për të moshuar me pengesë intelektuale. Qendrat për punë sociale kanë dy grupe të vogla të shtëpive për fëmijë ndërsa ka edhe shtëpi grupore që janë vendosur gjatë reformës për shëndetin mendor për ish shfrytëzues të spitaleve psikiatrike. Shtëpitë grupore kujdesen për 105 fëmijë dhe 80 të moshuar (pa ata me probleme me shëndetin mendor).

Në shtëpitë grupore për punën me shfrytëzuesit angazhohen nga tre punonjës socialtë cilët punojnë në mënyrë të drejtëpërdrejt me shfrytëzuesit me proporcion për një punonjës social mes dy dhe tre shfrytëzues, të cilët punonjës zakonisht janë të arsimuar mirë kurse për sa i përket në SOS “Detsko Selo” aty më shumë punojnë psikologë dhe punonjës social. Proporcioni i cili është shumë më i ulët sesa në institucionet tregon dy gjëra: e para, se promovohet më shumë pavarësi, por njëkohësisht sugjerohet edhe se dhënësit e shërbimeve nuk kanë siguruar kujdes për njerëzit me nevoja intensive, apo siç zakonisht thonë organizatat “shfrytëzuesit me nevoja intensive nuk përshtaten në programin e tyre”.¹⁰⁶

Kujdesi është gurëthemel i “modelit maqedonas” për sigurimin e shërbimeve në bashkësi. Mirëpo, ky model i kujdesit sipas të dhënave nuk është mirë i zhvilluar dhe është i fokusuar vetëm në një fushë të kufizuar sipërfaqësore duke mos përmbledhur dhe përfaqësuar shërbime të nevojshme terreni dhe duke mos i mbështetur dhe akomoduar ashtu sic duhet personat e moshuar.

Kujdesi siguron akomodim dhe shkallë të caktuar të kujdesit dhe mbështetjes. Kujdes ofrojnë familje individuale, zakonisht me mbështetjen e qendrave për punë sociale. Familjet perkujdesëse janë kujdesur për gjithsej 214 fëmijë, edhe atë numër të njëjtë të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe fëmijë pa aftësi të kufizuara (nga 107). Gjysma e shfrytëzuesve qëndrojnë në familjen perkujdesëse më shumë se pesë vite ndërsa një çerek më shumë se 19 vite, kështu që familjet perkujdesëse në fakt sigurojnë akomodim të vazhduar ndërsa për dikë edhe akomodim të përhershëm.

Kujdesi, edhe pse fillimisht është i paramenduar për fëmijë, për shkak të nevojës përdoret edhe për të moshuar, ndonjëherë për shkak se fëmijët rriten dhe mbesin në familje ndërsa ndonjëherë duket zgjidhje përkatëse dhe për të moshuarit. Pra edhe për të moshuarit, kujdesi në familje tjetër ose kujdesi familjarë mund të jetë një përgjigje positive dhe shpresuese për këtë kategori të personave, duke iu mundësuar të paktën vetëm akomodim dhe ushqim në një familje.

¹⁰⁶ “Strategji nacionale për deinstitucionalizimin e Republikës së Maqedonisë, Timjanik”, 2018- 2027

Edhe pse deinstitutionalizimi është proces ndërkombëtarë që i kalon dallimet kulturore dhe kontekstuale, parasysh duhet të merren konteksti vendor dhe kushtet shoqërore. Duke e marrë parasysh shkallën e ulët të institucionalizimit, në RM së Veriut kjo, luan një rëndësi të madhe: në një tërësi anë përpjekja më e madhe për avancimin e mbështetjes dhe kujdesit joformal do të jetë më e nevojshme kurse në anën tjetër përpjekje më të vogël do të ketë në procesin e shpërnguljes. *Modeli maqedonas* duhet të përfshijë, për shkak të rolit të gjerë dhe të rëndësishëm të sektorit joformal, edhe veprim në bashkësi që dukshëm do ta promovojë, ruaj dhe thellojë solidaritetin në bashkësi. Gjithashtu, për këtë shkak është e nevojshme hulumtim më i gjërë i formave të mbështetjes dhe të kujdesit që qëndrojnë në mes të kujdesit formal dhe kujdesit joformal, siç janë për shembull: mbështetje për kujdestarët, kujdes për familjet etj. që paraqet një argument të rëndësishëm për zhvillimin e shërbimeve të personalizuar dhe kontekstuale dhe mënyra të financimit të individualizuar dhe të drejtpërdrejtë.

Tabela 3. Rreziqet dhe mundësitë për uljen e rrezikut ose dëmit

Rrezik	Mënyra të mundshme për uljen e rrezikut dhe dëmit
Mungesë e vullnetit politik ose interes tek vendimmarrësit	Vendosje të koalicionit për deinstitutionalizim, që përfshin faktorë të ndryshëm dhe të shumtë nga sektori publik dhe civil, nga komuniteti akademik, ekspertë etj.
Zbatim jo të përpiktë të procesit	Vëzhgim i jashtëm i zbatimit, përfshirje të faktorëve të ndryshëm
Rezistencë e institucioneve	Dialog, mbështetje dhe bashkëpunim me institucionet dhe kuadrin, inkurajim, vendosmëri në zbatimin e Strategjisë dhe Planit të veprimit
Rezistencë ndaj ndryshimeve	Miratim të ndryshimeve përmes dialogut, lidhjes dhe bashkëpunimit të faktorëve, edukim dhe përforsim të vetëdijes
Varësi nga financimi i BE-së apo donatorëve tjerë	Buxhetim efikas nacional të procesit të deinstitutionalizimit me zbatim ekspeditiv dhe konzistent
Vlerësim jo përkatës të nevojave	Ndjekje, trajnim të dhënësve të shërbimeve dhe mbështetje në vendngjarje
Rezistencë nga bashkësia	Dialog dhe rritje të vetëdijes së bashkësive lokale

Sistem i pasigurt i qëndrueshmërisë	Shërbime synuese dhe me qëllim të mirë, Mbështetje, përforsim të sistemit për kujdes joformal dhe vëzhgim të vetë sistemit, si dhe buxhet të duhur nacional për procesin e deinstitutionalizimit
Shfrytëzim jo të duhur të financave të dedikuara për deinstitutionalizim	Informacione relevante për rrjedhat financiare, ndjekje të kujdesshme të procesit
Riprodhim të kulturës institucionale gjatë dhënies së shërbimeve në bashkësi	Trajnime efikase edukative dhe përfaqësuese për institutionalizimin dhe rreziqet e ri- institutionalizimit, dhe vëzhgim për ushtruesit (dhënësit) e shërbimeve sociale në bashkësi.
Vonesë me reformën ligjvënëse	Promovim dhe ngritje të vetëdijes tek ligjvënësit, vendimmarrësit dhe opinionit për leverdinë e deinstitutionalizimit, konfirmimin e masave prioritare për reformën ligjvënëse që do ta lehtësojnë deinstitutionalizimin
Prag i lartë, mbledhje të kajmakut (apo shpërngulje të shfrytëzuesve me nevoja më të vogla për mbështetje)	Për një lloj të mbështetjes efikase dhe në nivel të lartë për personat në nevojë, është mirë të mundësohen trajnime, koordinim dhe financim të shërbimeve në bashkësi.
Ri-institutionalizimi dhe trans-institutionalizimi	Moratorium të pranimit në institucionet rezidenciale, ndryshim të pakthyeshmë të statusit të shfrytëzuesve, përforsim të kapaciteteve të dhënësve të shërbimeve në bashkësi me qëllim që shfrytëzuesve t'u ofrohet mbështetje efikase, ¹⁰⁷ ndryshim të shpërndarjeve buxhetore dhe financiare në favor të shërbimeve në bashkësi

Zbatimi i ndryshimeve nënkupton bashkëpunim intensiv dhe mobilizim të faktorëve në të gjitha nivelet. Është e domosdoshme që të aktivizohen faktorët relevant në nivel të *shfrytëzuesit* dhe të *bashkësisë*, me qëllim që të vendosen *planet për shërbime të reja dhe projektet në nivel të bashkësisë*. Dhënësit e shërbimeve që të kenë dialog të vazhdueshëm me anëtarët e bashkësisë, patjetër të realizojnë kontakte më të fuqishme dhe lidhje në bashkësi.

Në procesin e deinstitutionalizimit, rol kryesor luajnë: *institucionet ekzistuese, qendrat për punë sociale, qendrat ditore (e nevojës është të jenë më depoërtuese dhe të orientuara më shumë drejtë bashkësisë) dhe OQ në nivel lokal dhe rajonal*. Këto faktorë duhet të drejtohen drejt bashkësisë dhe ta ndryshojnë mënyrën e tyre të punës, që në mënyrë më efektive dhe efikase të përgjigjen ndaj nevojave të shfrytëzuesve.

¹⁰⁷ Po aty.

MPPS do ta udhëheq procesin me bashkëpunim intensiv mes resorëve dhe koordinim, që të sigurojë zbatim të ndryshimeve, por edhe edukim të personave të caktuar profesionist që nuk janë drejtpërdrejtë të përfshirë, por të cilët mund të luajnë rol të rëndësishëm në zbatimin e deinstitutionalizimit (për shembull gjykatës, mjekë, profesionistë shëndetësor etj).

Me politikat për avancimin e rritit social, MPPS dhe strukturat e përfshira në nivel lokal në mënyrë aktive duhet të mbajnë nivel të mjaftueshëm të *fuqisë politike të ndryshimeve*, me mbështetjen e organizatave vendore dhe ndërkombëtare, rritave dhe institucioneve. Në mënyrë që të ketë një menaxhim të mirë të procesit të deinstitutionalizimit dhe me qëllim që të ndiqen ndikimet në këtë proces, duhet patjetër të sigurohet një vëzhgim i treguesve matës duke përfshirë këtu: numrin e institucioneve që janë transformuar, numrine shfrytëzuesve që janë shpërngulur, numrin e personave që tani më jetojnë të pavarur, kushtet që janë krijuar gjatë këtij procesi etj.

6.1.6 Krijimi i mundësisë për shërbime të duhura dhe të rregullta dhe përfshirja sociale

Shqyrtim i situatës dhe arritjet e deritanishme – Për nxitjen dhe inicimin e përfshirjes sociale procesi i deinstitutionalizimit është çelësi apo instrumenti kryesorë. Masat e paraqitura nga deinstitutionalizimi bazohen në përfshirjen sociale të përdoruesve të institucioneve, si dhe të personave të tjerë që kanë nevojë për shërbimet.¹⁰⁸

Jeta në institucion në vetvete është një shkyçje. Personat me aftësi të kufizuara dhe personat që janë me një zhvillim të vonuar zakonisht janë të përjashtuar nga shumë shkaqe e sidomos ato të stereotipeve shoqërore, pengesave fizike për të qenë në qasje, kushtet e jetesës jo të mjaftueshme apo varfëria, statusi që kanë në shoqëri etj. Ata janë pamjaftueshëm të përfshirë në aktivitetet arsimore, të kufizuar në fushën e punësimit, të neglignuar në qasjen e shërbimeve shëndetësore, shërbimeve të transportit public, të marginalizuar në aktivitetet pjesëmarrëse në bashkësi, e shpesh janë keqkuptuar dhe stigmatizuar.

¹⁰⁸ “Strategji nacionale për deinstitutionalizimin e Republikës së Maqedonisë, Timjanik”, 2018- 2027

Sfidat

- Qasja në të gjitha shërbimet e rregullta duhet të përmirësohet. Të gjithë profesionistët në aktivitetet e shërbimit publik (mësuesit, mjekët, infermierët, punëtorët kulturorë, etj.) kanë nevojë për trajnim në vendin e punës për përfshirjen e përdoruesve. Përfituesit e shërbimit të kujdesit në bashkësi kanë një nevojë të vetme dhe të duhur e të mjaftueshme për ata, e ajo nevojë është të kenë profesionistë të duhur dhe në punën që do ta bëjnë ta bëjnë pa diskriminime, pra nuk kanë nevojë për profesionist të veçantë dhe për shërbime të specializuara.
- Stigmatizimi dhe turpi duhet të tejkalohen. Proçesi i deinstitutionalizimit do të nxjerrë të afërmit nga barra e stigmatizimit dhe fajit që ata përjetojnë, si dhe nga turpi për shkak të vendosjes të anëtarit familjar në institucion.¹⁰⁹ Duke ngritur vetëdijën e personave me aftësi të kufizuara, duke zhvilluar mundësitë për punë dhe punësim të tyre në ndonjë ndërmarrje sociale, duke i përfshirë gjithashtu edhe fëmijët me aftësi të kufizuara në proçeset arsimore, në shkolla të rregullta si dhe duke promovuar për të gjithë një qasje të plotë në jetën shoqërore dhe kulturore, qëndrimet e bashkësisë dalengadalë do të ndryshojnë.
- Sikleti, keqkuptimi, etiketimi dhe shqetësimi në ndërveprimin e përditshme mund të tejkalohen duke inkurajuar respektin dhe “perspektivën e anëve të forta” dhe forcimin e përdoruesit për t’u kuptuar, vlerësuar dhe pranuar si anëtarë të bashkësisë në mikro-nivel. Kjo do të mbështetet nga masat për përfshirje në arsimin e rregullt, tregun e punës, jetën kulturore.
- Qendrat për punë sociale janë ato që duhet të ofrojnë një model të shërbimeve për ofruesit e tjerë, formë kjo e nevojshme për përfshirjen sociale. Kjo nënkupton një ndryshim në qasjen e tyre dhe rolin e tyre. Veprimet e tyre duhet të jenë absolutisht gjithëpërfshirëse, të bazuara në respekt dhe të shmangin kategorizimin. Roli i tyre do të jetë më shumë se koordinimi, ata do të rriten në kontraktorë të shërbimeve dhe mbrojtës proaktivë, të cilët do të sigurojnë qasje në to. Prania e tyre në bashkësi duhet të rritet - në

¹⁰⁹ Po aty.

vend të punës në zyrë, do të ketë më shumë punë në terren për mbështetje reale për përdoruesit dhe bashkësisë.

6.1.7 Sigurimi i vendeve të banimit

Shqyrtimi i situatës dhe arritjet e deritanishme - Për disa banorë dhe shfrytëzues të shërbimeve, çështja e pazgjidhur e strehimit është shkaku kryesor që rrit vështirësitë e tyre, duke rritur varësinë e tyre nga të tjerët dhe duke çuar në pranimin e tyre në një institucion. Ofruesit e shërbimeve të bashkësisë ose kujdesi institucional kanë resurse të kufizuara për të siguruar strehim të mirë dhe mbeten vetëm për të menaxhuar veten. Agjencitë e përgjithshme të strehimit publik ofrojnë strehim për ata në nevojë. Sidoqoftë, përparësi pak ose aspak i është dhënë përfituesve të mëparshëm të institucioneve dhe përdoruesve të tjerë të shërbimeve mbështetëse dhe të kujdesit. Këto agjenci nuk kanë ndjeshmërinë dhe përvojën e nevojshme për të punuar me grupet e synuara të deinstitutionalizimit.

Sfidat

- Strehimi paraqet një nga parakushtet me rol të veçant dhe të rëndësishëm për procesin e tranzicionit dhe rol luan edhe përpjekja dhe vëmendja nga ofruesit e shërbimeve sociale dhe të strehimit. Për zbatimin e suksesshëm të shpërnguljes, do të kërkohet një numër i madh njësisish banimi. Duhet të kryhet një vlerësim i plotë i nevojave të strehimit të përdoruesve të institucioneve dhe përdoruesit e tjerë (të mundshëm) të shërbimeve në bashkësi dhe për të zhvilluar një plan veprimi specifik për strehim, duke përfshirë edhe modelin e biznesit si për ta siguruar strehim të përshtatshëm, të qëndrueshëm dhe në dispozicion.¹¹⁰
- Një orientim strategjik është që personave me aftësi të kufizuara iu duhet strehim i zakonshëm apo më mirë të themi nevojë për një strehim në bashkësi. Duhet të shmanget

¹¹⁰ Po aty.

krijimi i getove, si dhe rrethanat e tjera që do të izolojnë përdoruesit e shërbimit nga pjesa tjetër e popullsisë. Megjithatë, shpesh kërkohet përshtatje fizike dhe sociale në mjediset e dhëna.

- Agjencitë publike të strehimit fillimisht do të sigurojnë strehim (për grupet e para të njerëzve që do të shpërngulen). Që të jenë të vetëdijëshme për të mbështetur, dhe për të sensibilizuar rastet e tilla të shpërnguljes, këto agjenci duhet të jenë të pajisura mirë. Mund të krijohet një agjenci e veçantë për njësitë e banimit publik, të cilat mund të shërbejnë për këtë qëllim.
- Është e nevojshme për të krijuar një fond për strehim nga kapacitetet ekzistuese për strehim social dhe duke i transformuar mjetet ekzistuese të institucioneve në banesa për banim të zakonshëm social, dhe duke futur një sistem të kuotave në investime të reja në kontratat e ndërtimit. Të dytat kërkojnë ndryshime legislative në legjisllacionin e ndërtimit.
- Duhet të zhvillohet model i strehimit, që do të përfshinë partneritet publik dhe privat, kooperativa rezidenciale, përdoruesit si pronarë (të pjesshëm) ose qiramarrës. Në të ardhmen, bazuar në rezultatet e hulumtimit të nevojave, duhet të konsiderohet mundësia e krijimit të “ombrella” organizimit nga ofrues të ndryshme të shërbimeve të akomodimit që mund të gjenerojnë burime dhe potenciale të mjaftueshme për të krijuar kapacitet për të akomoduar grupet vulnerabël në përgjithësi. Ajo duhet të funksionojë sipas parimeve të menaxhimit të mirë dhe transparent, si dhe parimeve të përfshirjes dhe aktivizimit të përdoruesve. Ku për një ndërlidhje apo rrjet të fuqishëm e të integruar të shërbimeve, funksioni i tij mund të jetë më i gjerë dhe më i përhapur.

6.1.8 Pjesëmarrje e përdoruesve dhe shërbime të udhëhequra nga përdoruesit

Arritjet e tanishme dhe shqyrtimi i gjendjes aktuale – tradicionalisht në vendin tonë, pra në RM së Veriut ekzistojnë organizata formale të personave me aftësi të kufizuara duke I numëruar ato me paaftësi fizike, mendore, organizata formale të prindërve të këtyrë kategorive të personave, e të personave të moshuar. Në përgjithësi, përfshirja e të gjithë pjesëmarrësve në sigurimin dhe organizimin e shërbimeve nuk është zhvilluar. Shumica besojnë se njerëzit që

jetojnë në institucion nuk duhet të marrin vendime ose të marrin pjesë në vendimmarrje, sepse ata kanë aftësi të dobët ose fare nuk janë në gjendje dhe nuk kanë kapacitet nga shkak i aftësisë së kufizuar që kanë për të vlerësuar sfidat dhe për të marrë vendime.

Besohet që në interesin e tyre më të mirë të vendosin më mirë profesionistët se sa ata vetë.

Sfidat

- Sipas Udhëzimeve të Përbashkëta Evropiane, përdoruesit duhet të përfshihen dhe të kenë kontroll në çdo hap të procesit të deinstitucionalizimit; planifikimin, zbatimin dhe monitorimin. Dy sfidat kryesore në Maqedoni në lidhje me përfshirjen e përdoruesve janë kyqja e përdoruesit si krijuesit i rëndësishëm dhe vendimmarrës, në shërbimet ekzistuese dhe futjen e një gamë të shërbimeve të udhëhequra nga përdoruesit.
- Është e nevojshme që të krijohen edhe borde të përdoruesve/përfituesve, duke i pasur parasysh IT ekzistuese, objektet e banimit dhe qendrat e shërbimeve sociale, me mundësinë që edhe në vendimmarrje të jenë partner të barabartë, përveç asaj që të mund nevojat e tyre, kërkesat, të drejtat e tyre t'i shprehin në bordet e përdoruesve duke e lehtësuar shprehjen e tyre, duke i mbështetur dhe duke i përfshirë në jetën sociale. Në funksionimin e përditshëm të organizatës, duhet të formohet asambleja si instrumenti kryesor për vendimmarrje demokratike.
- Mënyrë tjetër për përfshirjen e përdoruesve në shërbimet ekzistuese është në një masë më të madhe të përdoret si kontribues. Disa mund të bëhen punëtorë mbështetës të bashkëmoshatarëve. Disa mund të jenë të trajnuar, disa tashmë kanë trajnim të përshtatshëm për punë si infermierë, kujdestarë, punëtorë socialë, edukatorë etj.
- Gjatë zhvillimit të shërbimeve të reja të tilla si strehimi, qendrat ditore, njësitë e punës për të siguruar grupet e punësimit, avokimit dhe vetë-ndihmës duhet të testohen disa pilot-projekte të drejtuara nga përdoruesit (të tilla si pronësia e përbashkët ose kooperativave strehim) dhe pjesëmarrjen e përdoruesit në procesin e ndërtimit ose

rinovimit.¹¹¹ Qendrat dhe iniciativat për përfaqësim dhe vetëpërfaqësim duhet të mbështeten në një kuptim organizativ dhe financiar.

- Punëtorët mbështetës të bashkëmoshatarëve (peer support ëorkers) janë një profil i rëndësishëm i profesionistëve dhe në procesin e tranzicionit në bashkësi dhe shërbimet e bashkësisë. Përparësia e tyre është se ata kanë përvojë të përjetshme dhe kështu më shumë ndjeshmëri. Ata zakonisht janë shumë të përkushtuar dhe të arritshëm për përdoruesit, sepse ata dinë si është të jesh në pozitën e tyre.
- Përdoruesit – për të pasur vetëpërfaqësim, mbështetje nga kolegët, menaxhim dhe shërbime tjera, ata për punën e tyre dhe për të zhvilluar njohuri në lidhje me vetë përdoruesit duhet të jenë të trajnuar mirë.

Bibliografia

1. “Национална програма за развој на социјална заштита 2011-2021”, службен весник на РМ, бр.121/2010
2. “Како до подобар систем на социјалната заштита во Република Македонија”, Скопје, 2017
3. <https://shtetiweb.org/2013/10/07/mbrojttja-sociale/>

¹¹¹ Përshkrim nga “Strategji nationale për deinstitutionalizimin e Republikës së Maqedonisë, Timjanik”, 2018- 2027

4. <https://dejure.mk/zakon/nacionalna-programa-za-razvoj-na-socijalnata-zashtita-2011-2021>
5. “Projekte për Inkurajimin e Përfshirjes sociale”, Shkup, 2017
6. <https://www.mtsp.gov.mk/proekti-od-oblasta-na-socijalnata-zashtita.nspх>
7. Закон за социјална заштита на Република Северна Македонија, мај, 2019
8. <https://vlada.mk/node/18231?ln=sq>
9. Закон за социјална сигурност за старите лица, мај, 2019
10. “Оперативниот план за програмите и активните мерки за вработување и услугите во пазарот на труд за 2021”, Скопје, март, 2021
11. “Програмот за остварување на социјалната заштита за 2021 година”, службен весник на РСМ, бр. 3/2021
12. Закон за заштита на деца, 2019
13. “Социјалната заштита во Македонија: Регулатива и практика”, Скопје, 2019
14. https://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstenie_al.aspx?rbtxt=98
15. “Decentralizimi i mbrojtjes sociale në Republikën e Maqedonisë” - gjendja faktike, sfidat dhe mundësitë në nivel lokal. - Shkup : Instituti për te drejtat njerezore Ljudvig Bolltman, 2012
16. https://mk.wikipedia.org/wiki/Социјална_заштита#Историја
17. “Нурје në Punë Sociale”, Edmond Dragoti, Tiranë, 2007
18. “Sociologjia”, Anthony Giddens, 2007
19. Етички кодекс за стручните работници во дејноста социјална заштита, Скопје, 2020
20. “Shoqëria e shëndoshë”, Erich From, Tiranë, 2012
21. “Edhe politika do moral”, Servet Pëllumbi, Tiranë, 2005
22. “Historia për shtetin e mirëqenies sociale”, Llambro Filo, Tiranë, 1999
23. “Punonjësit social”, Margaret Gibelman, Tiranë, 2003
24. “Социјалните услуги во општините во Северна Македонија, Капацитет, Ризици, Потребности”, Скопје, Јуни, 2020

25. “Strategji nacionale për deinstitutionalizimin e Republikës së Maqedonisë, Timjanik”,
2018- 2027